



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 8/2021 regjistër (JR)
Datë 24.02.2021

Nr. 19 i vendimit
Datë 26.04.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupit gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 26.04.2023, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, nr. 8/2021, datë 24.02.2021, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Arjan Qafa, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 298, datë 17.09.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 e 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Kodi i Procedurave Administrative; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit Arjan Qafa të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili, përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 298, datë 17.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Arjan Qafa ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë. Për shkak të funksionit, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016”), iu nënshtrua procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Arjan Qafa (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe (c) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), sipas të cilave ka rezultuar:

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin², në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i rishikuar në vijimësi, ku ka konstatuar *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Arjan Qafa*.

2.3 KLGj-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 298, datë 17.09.2020.

¹ Raporti i ILDKPKI-së është përcjellë në Komision, me shkresë nr. {***} prot., datë 06.03.2018.

² Raporti nr. {***} prot., datë 09.03.2020, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZh-së nr. {***}, datë 14.04.2020, përcjellë në Komision, me shkresë nr. {***} prot., datë 17.04.2020.

³ Raporti i KLGj-së për analizimin e aftësisë profesionale nr. {***} prot., datë 04.03.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 298, datë 17.09.2020, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arjan Qafa, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pikat 3 dhe 5 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për secilin prej kritereve të rivlerësimit, si më poshtë.

- Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, të rremë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, parashikuar në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

- Për kriterin e kontrollit të figurës:

Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të jetë në kushtet e pikës 2 apo 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, vlerëson se ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, porse konstatimet e gjetura gjatë hetimit mund të vlerësohen në tërësi të çështjes lidhur me rivlerësimin e subjektit Arjan Qafa, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

- Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

- Nga vlerësimi në tërësi i rezultateve të hetimit, konkluzionet e arritura gjatë hetimit të pastërtisë së figurës për z. Arjan Qafa, të ndërthurura me hetimin dhe vlerësimin e rasteve gjatë hetimit të të ardhurave/pasurive dhe vlerësimit profesional, rëndojnë pozitën e tij si gjyqtar. Këto veprime, të vlerësuara në tërësinë e tyre, cenojnë rëndë besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit, më datë 22.01.2021, ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 298, datë 17.09.2020, të Komisionit, duke i kërkuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë si gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe procedurale dhe shkaqe të tjera në lidhje me themelin e çështjes, të cilat në tërësinë e tyre kanë të bëjnë me interpretim të gabuar të ligjit material dhe mosvlerësimin siç duhet të provave të administruara nga Komisioni.

6. Shkaqet e ankimit, që i përkasin natyrës procedurale dhe parimeve të cenuara të procesit të rregullt ligjor, janë si vijon.

6.1 Vendimi i Komisionit nr. 298, datë 17.09.2020, i është njoftuar në datën 11.01.2021, pas 4 muajsh nga shpallja e tij, në kundërshtim të plotë me parashikimin e nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016.

6.2 Trupi gjykues nuk është krijuar sipas ligjit, duke u shkelur parimi i ligjshmërisë, pasi trupat gjykuese të Komisionit jo vetëm nuk janë trupa të përhershme, por kanë ndryshuar sa herë është hedhur short për vlerësim subjektësh, duke u krijuar sipas interesave të caktuara me qëllime të pritshme për rastet selektive.

6.3 Veprimtaria e Komisionit është realizuar nëpërmjet veprimeve arbitrare, në shkelje të parimit të paanësisë dhe objektivitetit, të parimit të procesit të rregullt dhe vendimmarrja është marrë në cenim të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative, për pasojë është e paligjshme dhe e pavlefshme, pasi relatorja Pamela Qirko ka pasur konflikt interesi.

6.4 Drejtimi i hetimit administrativ nga relatorja e Komisionit ka qenë arbitrar dhe diskriminues, duke krijuar situata fiktive të paqena, me qëllim shtrembërimin e realitetit, çka jo vetëm cenon parimin e ligjshmërisë dhe sigurinë juridike, por përbën shkak për procedim disiplinor të anëtarëve të Komisionit, sipas nenit 16, pika 12 e ligjit nr. 84/2016. Procesverbali i seancës dëgjimore nuk i është vënë në dispozicion së bashku me vendimin, por i është dashur të bëjë kërkesë të re për t'u pajisur me të.

6.5 Komisioni nuk ka vlerësuar provat e paraqitura prej tij, pasi nga relatorja e çështjes, në seancë dëgjimore, u kërkua paraqitja e tyre në formën e kërkuar nga ligji edhe pse ato ishin paraqitur prej tij në formën e kërkuar përpara zhvillimit të seancës, çka cenon parimin e ligjshmërisë, por edhe përbën shkelje disiplinore për anëtarët e trupës gjyquese të Komisionit, sipas nenit 16, pika 12 e ligjit nr. 84/2016.

6.6 Çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit për subjektin e rivlerësimit po nga e njëjta trupë cenon haptazi parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, duke e bërë Komisionin një organ me natyrë të dyfishtë edhe organ “akuzator” edhe vlerësues.

6.7 Komisioni ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

6.8 Komisioni ka vendosur në kundërshtim edhe me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kritereve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë.

7. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

7.1 Konkluzioni i Komisionit, mbi pasurinë e llojit “tokë bujqësore” me sipërfaqe 1639 m², në Fushë-Arrëz, është i gabuar dhe kontradiktor, pasi nuk janë analizuar dhe vlerësuar drejt provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, deklaratimet sqaruese të tij sipas pyetësorëve dhe në seancë dëgjimore publike.

7.2 Komisioni ka treguar njëanshmëri dhe paragjykim në vlerësimin e provave për 1/10 pjesë e pasurisë së llojit “tokë bujqësore” me sipërfaqe totale 1955 m², në Fushë-Arrëz, pasi e ka bazuar arsyetimin duke paraqitur fakte të pavërteta si të gabuara.

7.3 Arsyetimi dhe konkluzioni i Komisionit, për pasurinë tokë bujqësore, me sipërfaqe totale 6000 m², në fshatin {***}, Kurbin, mbështetet në fakte të pavërteta, të paplota dhe të deformuara, në shkelje të detyrimit kushtetues të përcaktuar në nenin C, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

7.4 Arsyetimi dhe konkluzioni i Komisionit, për pasurinë pyll me sipërfaqe 1000 m², në malin Shëngjin, janë jo të drejta.

7.5 Ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka provuar se dhuratat e dhëna nga të afërmit e tij dhe të personit të lidhur janë të ligjshme dhe të deklaruara në momentin e dhurimit.

7.6 Konkluzionet e Komisionit, për pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 107,16 m², në Tiranë, nuk janë të mbështetura në prova dhe janë të paarsyetuara dhe se Komisioni në vendim ka treguar njëanshmëri dhe paragjykim në vlerësimin e provave dhe në marrjen e vendimit.

7.7 Konkluzionet e Komisionit, për gjendjen e likuiditeteve *cash* në datën 29.01.2017, nuk janë të mbështetura në prova dhe janë të paarsyetuara dhe se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit janë paragjykuar e janë transformuar faktet në mënyrë diskriminuese.

7.8 Komisioni nuk ka pasqyruar drejt situatën faktike dhe nuk ka bërë vlerësim të drejtë të provave, lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga punësimi në shoqërinë “{***}” ShPK.

7.9 Komisioni nuk ka pasqyruar drejt situatën faktike, nuk ka bërë vlerësim të drejtë të provave, lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga punësimi të personi fizik “{***}”, vëllai i saj, si dhe ka pasqyruar të dhëna jo të vërteta, duke aluduar se subjekti ka paraqitur prova jo të sakta.

7.10 Komisioni ka treguar njëanshmëri dhe paragjykim në vlerësimin e provave dhe marrjen e vendimit, lidhur me dhurimin e shumës 10.000 euro nga të afërmit ndaj bashkëshortes së tij me rastin e martesës.

7.11 Komisioni ka treguar njëanshmëri dhe paragjykim në vlerësimin e provave dhe në marrjen e vendimit, lidhur me zbatimin e Kodit të Familjes, pasi pasuritë paramartësore të personit të lidhur duhet t’i veçonte nga pasuritë e subjektit të rivlerësimit.

7.12 Konkluzioni i Komisionit, lidhur me të ardhurat e personit të lidhur të deklaruara të përfituara nga interesat e huave, është i gabuar, pasi nuk mbështetet në ligj dhe duhet ndryshuar nga Kolegji, duke bërë vlerësimin e duhur të provave të paraqitura gjatë hetimit administrativ.

7.13 Konkluzionet e Komisionit, për pasurinë tokë bujqësore në fshatin {***}, pasuri veçmas e personit të lidhur, nuk janë të mbështetura në prova dhe janë të paarsyetuara dhe se të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit janë paragjykuar e janë transformuar faktet në mënyrë diskriminuese.

7.14 Konkluzionet e Komisionit, për pasurinë apartament banimi në Kashar, Tiranë, pasuri veçmas e personit të lidhur, nuk janë të mbështetura në prova dhe vendimi është i paarsyetuar, i pakuptueshëm dhe diskriminues e në shkelje të të drejtave për një proces të rregullt ligjor.

7.15 Situata financiare e paraqitur nga Komisioni nuk i përgjigjet realitetit, pasi: nuk janë përlllogaritur saktë të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe ato të personit të lidhur; nuk janë përlllogaritur saktë shpenzimet e jetesës; si dhe nuk janë përlllogaritur drejt dhuratat e dhëna nga të afërmit e tij emigrantë.

8. Shkaqet e ankimit, për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, janë si vijon.

8.1 Veprimet e Komisionit, gjatë hetimit administrativ, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, kanë qenë diskriminuese, të nxitura me qëllim arritjen e vendimmarrjes, duke mos analizuar drejt provat e paraqitura nga DSIK-ja, të cilat kanë qenë kontradiktore.

8.2 Raporti i DSIK-së, nr. {***} prot., datë 02.11.2017, i cili ka konstatuar përshtatshmërinë e tij për vazhdimin e detyrës, në unison me shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme, sipas së cilës nuk ka indicie që subjekti të ketë cenim të figurës, qëllimisht nuk

i është bashkëngjitur dosjes së rivlerësimit nga Komisioni, në vijim të formave të presionit politik që përfaqëson trupa gjykuese, i cila ka vepruar në konflikt interesi.

8.3 Komisioni, në kundërshtim me kriteret ligjore të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 49 e vijues të ligjit nr. 84/2016, ka dhënë një vendim të padrejtë, të pabazuar, të njëanshëm, në kundërshtim me provat, i cili duhet të ndryshohet, sepse arsyetimi në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës vjen në kundërshtim të plotë me disponimin e vendimit, pasi vetëm për subjektin që ka kontakte të papërshtatshme zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Ankimi i subjektit të rivlerësimit, ndaj vendimit nr. 298, datë 17.09.2020, të Komisionit, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”), në dhomë këshillimi, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), pasi nuk u konstatuan raste apo rrethana që të plotësonin kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve.
10. Në vlerësim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, për marrjen në cilësinë e provës të shkresës nr. {***} prot., datë 15.01.2021, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Dega Pukë, e paraqitur nga ai bashkëlidhur ankimit, trupi gjykues çmoi ta trajtojë në raport me parashikimet ligjore që normojnë paraqitjen e provës së re në gjykimin administrativ në apel, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon: *“Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”*, si edhe nenit 49, pika 6, shkronjat “a” e “b” të ligjit nr. 84/2016, në të cilin parashikohet se: *“Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit”*. Në mbështetje të kësaj baze ligjore, trupi gjykues vlerësoi se shkresa nr. {***} prot., datë 15.01.2021, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Dega Pukë, nuk plotëson kriteret e parashikuara për t’u kualifikuar si provë që mund të merret në gjykimin në apel të çështjes, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë asnjë arsye për të provuar mungesën e fajit, lidhur me mosparaqitjen e saj gjatë hetimit administrativ të zhvilluar në Komision. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se shkresa nr. {***} prot., datë 15.01.2021, e sipërcituar, në raport me faktet që subjekti synon të provojë, është e parëndësishme për zgjidhjen e çështjes, pasi në dosjen e rivlerësimit gjendet shkresa nr. {***} prot., datë 03.08.2020, e ASHK Zyra Vendore Pukë e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, e cila ka të njëjtën përmbajtje me shkresën e kërkuar për t’u marrë si provë në gjykimin në apel.
11. Me parashtrimet e paraqitura pesë ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore në Kolegj⁴, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur akte⁵ për të cilat trupi gjykues vlerësoi se nuk plotësojnë kërkesat e

⁴ Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur parashtrime në datën 06.02.2023, regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., gjithsej 64 fletë; në datën 15.03.2023, regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., gjithsej 13 fletë; në datën 20.04.2023, regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., gjithsej 22 fletë.

⁵ Bashkëlidhur parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet:

parashikuara prej neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, sipas së cilave deri pesë ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim, por jo prova të reja, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe, për këto arsye, i përjashtoi nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre provuese në zgjidhjen e çështjes. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues çmoi të theksojë se nga një vështrim *prima facie* i përmbajtjes së vendimit nr. {***}, datë 19.12.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me palë paditëse znj. K. Q. dhe palë të paditur shoqëria “{***}” ShPK dhe persona të tretë Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër dhe vendimit nr. {***}, datë 16.12.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me palë paditëse znj. K. P. dhe palë të paditur z. E. P. dhe persona të tretë Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Lezhë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet para zhvillimit të seancës gjyqësore në Kolegj, rezultoi se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka paraqitur paditë në gjykatat përkatëse në datat 06.10.2022 dhe 12.10.2022. Nga aktet e hetimit administrativ të Komisionit, siç do të analizohen në vijim në këtë vendim, ka rezultuar se personi i lidhur, znj. K. Q. (P.), ka qenë e vetëdijshme se për të ardhurat e saj të përfituara nga punësimi në shoqërinë “{***}” ShPK nuk janë paguar detyrimet tatimore, pasi kjo ka qenë një marrëveshje e saj me punëdhënësin. E njëjta situatë vlen edhe për sa i përket të ardhurave të përfituara nga punësimi i personit të lidhur pranë personit fizik

-
- vendim nr. {***}, datë 19.12.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me palë paditëse znj. K. Q. dhe palë të paditur shoqëria “{***}” ShPK dhe persona të tretë Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, vërtetuar njësisht me origjinalin me nr. {***} rep., datë 02.02.2023;
 - vendim nr. {***}, datë 16.12.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me palë paditëse znj. K. P. dhe palë të paditur z. E. P. dhe persona të tretë Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Lezhë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë;
 - deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.12.2022, e deklaruës z. S. V.;
 - deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.12.2022, e deklaruës znj. Gj. Q.;
 - deklaratë noteriale e shtetasit italian E. G., e datës 22.02.2023, e përkthyer në shqip me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 01.03.2023, e palegalizuar me vulë apostille, vërtetuar njësisht me origjinalin me nr. {***} rep., datë 01.03.2023;
 - shkresë e Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave Vendore në Bashkinë Kurbin, me nr. {***} prot., datë 12.01.2023, drejtuar z. Arjan Qafa, me lëndë “Kthim përgjigje”, bashkëlidhur kërkesa, datë 06.01.2023, drejtuar kësaj drejtorie nga z. Arjan Qafa;
 - shkresë e Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Shkodër, Sektori i Ekstensionit Bujqësor Lezhë, me nr. {***} prot., datë 16.11.2022, drejtuar znj. Gj. Q., me lëndë “Kthim përgjigje”, bashkëlidhur akti “Vlerësim Agronomik” i datë 16.11.2022;
 - Raport Ekspertize Financiare, hartuar nga ekspert kontabël i miratuar znj. V. K., datë 22.11.2022;
 - akt ekspertimi Grafik Nënshkrimi nr. {***}, datë 24.09.2022, i hartuar nga ekspert kriminalist Xh. Ç.;
 - shkresë nr. {***} prot., datë 19.10.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, e cila ka bashkëlidhur - vendimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, datë 18.10.2022, “Për ndreqjen e gabimit në urdhrin e datës 10.05.2022”;
 - shkresë nr. {***} prot., datë 30.06.2022, e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër, “Vërtetim për vjetërsinë në punë për efekt pensioni për znj. F. Q.”;
 - shkresë nr. {***} prot., datë 24.05.2022, e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër, “Vërtetim për vjetërsinë në punë për efekt pensioni për znj. V. Ll.”;
 - shkresë nr. {***} prot., datë 03.02.2023, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, drejtuar z. K. R. me lëndë “Kthim përgjigje”;
 - vendim nr. {***}, datë 02.12.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë paditëse z. F. Sh. dhe palë e paditur shoqëria “{***}” ShPK, me persona të tretë Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë;
 - vendim nr. {***}, datë 28.03.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë paditëse z. K. O. dhe palë e paditur shoqëria “{***}” ShPK, me persona të tretë Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë;
 - vendim nr. {***}, datë 29.09.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me palë paditëse z. F. Sh. dhe palë e paditur shoqëria “{***}” ShPK, me persona të tretë Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës.

“{***}”, për të cilat ajo ka qenë në dijeni që gjatë periudhës së punësimit se nuk po paguheshin detyrimet tatimore nga punëdhënësi. Në këto kushte, ngritja e padisë, për më tepër rreth dy vjet më vonë nga dhënia e vendimit të Komisionit për subjektin e rivlerësimit dhe, pikërisht atëherë kur jurisprudenca e Kolegjit njohu pagesën me vonesë të detyrimeve tatimore të njohura me vendime gjyqësore, dëshmon se proceset gjyqësore janë iniciuar nga personi i lidhur për efekt të procesit të rivlerësimit të bashkëshortit të saj, me qëllim përmbysjen e asaj që ka rezultuar e provuar nga procesi i zhvilluar në Komision, se personi i lidhur ka qenë në keqbesim në raport me sjelljen e palës punëdhënëse.

12. Parashtrimet e paraqitura para zhvillimit të seancës gjyqësore në Kolegj janë shoqëruar me prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.01.2023, nëpërmjet së cilës subjekti i rivlerësimit autorizon si përfaqësues të posaçëm av. Daniel Ndreka⁶.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni dhe çështje të zbatimit të legjislacionit

13. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimi i Komisionit nr. 298, datë 17.09.2020, i është njoftuar në datën 11.01.2021, pas 4 muajsh nga shpallja e tij, në kundërshtim të plotë me parashikimin e nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016.*

Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, nga verifikimi i procedurës së ndjekur nga Komisioni, lidhur me njoftimin e vendimit subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

Vendimi i Komisionit, nr. 298, datë 17.09.2020, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 08.01.2021 dhe ai ka marrë njoftimin më datë 11.01.2021, sipas nënshkrimit të kartelës postare “Lajmërim marrje” nga bashkëshortja e tij.

Referuar legjislacionit të zbatueshëm, nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, vendimi i arsyetuar me shkrim i Komisionit, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore. Pavarësisht se referuar dispozitës së sipërcituar njoftimi është kryer tej afatit 30-ditor, trupi gjykues nuk konstatoi problematika në drejtim të marrjes dijeni nga ana e subjektit të rivlerësimit të përmbajtjes së vendimit të Komisionit, referuar “Lajmërim marrjes” së shërbimit postar.

Në përfundim të sa më sipër, pavarësisht se njoftimi i vendimit të Komisionit nuk ka respektuar afatin e përcaktuar në nenin 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi se kjo vonesë nuk ka cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për akses në gjykatë, sa kohë ky i fundit ka ushtruar ankim brenda afatit ligjor dhe ankimi i tij është marrë në shqyrtim nga Kolegji në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.

14. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se trupi gjykues nuk është krijuar sipas ligjit, duke u shkelur parimi i ligjshmërisë, pasi trupat gjyqësore të Komisionit jo vetëm nuk janë trupa të përhershme, por kanë ndryshuar sa herë është hedhur short për vlerësim subjektsh, duke u krijuar sipas interesave të caktuara me qëllime të pritshme për rastet selektive.*

Në shqyrtim të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vëren se referuar nenit C, pika 1 e Kushtetutës dhe nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni organizohet dhe shqyrton çështjet e rivlerësimit në katër trupa gjyqësore të përhershëm me nga tre anëtarë secili. Fillimisht përcaktohen trupat gjyqësore, më pas hidhet shorti për ndarjen e çështjeve sipas këtyre trupave gjyqësore dhe në

⁶ Nga prokura rezulton se subjekti i rivlerësimit ka autorizuar përfaqësuesin e tij të kryejë në mungesë dhe në prezencë të tij të gjitha procedurat e nevojshme për ankimin ndaj vendimit të Komisionit, si dhe përfaqësimin në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

fund përcaktohet nëpërmjet shortit se cili anëtar i trupit gjykues, të cilit i është shortuar më parë çështja, do të caktohet si relator i saj⁷.

Nga shqyrtimi i akteve të krijuara nga Komisioni, për efekt të shqyrtimit të çështjes objekt gjykimi, rezultoi se trupa gjykuese e Komisionit, e ngarkuar me kryerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Arjan Qafa, është caktuar nëpërmjet procedurës së shortit në datën 15.11.2018 dhe cilësohej si trupa gjykuese nr. 04. Referuar vendimit nr. 1 të trupës gjykuese nr. 04, të datës 21.11.2018, sipas së cilit, ndër të tjera, rezultoi të jetë zgjedhur kryesuesi i trupës gjykuese dhe është vendosur fillimi i procedurës së hetimit administrativ, trupa gjykuese nr. 04 është shortuar në mbledhjen e Komisionit për hedhjen e shortit të listës së subjekteve të rivlerësimit të zhvilluar më datë 15.11.2018. Në vlerësim të trupit gjykues të Kolegjit, procedura e analizuar si më sipër, rezultoi në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

15. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *veprimtaria e Komisionit është realizuar nëpërmjet veprimeve arbitrare, në shkelje të parimit të paanësisë dhe objektivitetit, të parimit të procesit të rregullt dhe vendimmarrja është marrë në cenim të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative, për pasojë është e paligjshme dhe e pavlefshme, pasi relatorja Pamela Qirko ka pasur konflikt interesi*, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se sipas një njoftimi në median e shkruar, lidhur me një tjetër subjekt rivlerësimi, më datë 18.09.2020, është vënë në dijeni të faktit se relatorja e çështjes në Komision, znj. Pamela Qirko është motra e ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë znj. B. B.. Sipas subjektit të rivlerësimit, relatorja, në referim të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të parandalonte konfliktin e interesit, pasi subjekti ka gjykuar një sërë çështjesh administrative në të cilat drejtuese e institucionit palë në gjykime ka qenë motra e saj. Sipas subjektit, mosreflektimi i relatores për t'u tërhequr ka cenuar parimet kushtetuese *ne bis in idem*, si dhe parimin e sigurisë juridike. Për pasojë, gjithë veprimtaria e Komisionit duhet të konsiderohet absolutisht e pavlefshme, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

15.1 Në analizë të këtij pretendimi konstatohet se referuar përmbajtjes së vendimit të Komisionit nr. 1, datë 21.11.2018, në datën 15.11.2018 është hedhur shorti për caktimin e trupit gjykues që do të shqyrtonte procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Arjan Qafa, i cili përbëhej nga Pamela Qirko (relatore), Valbona Sanxhaktari (kryesuese) dhe Lulzim Hamitaj (anëtar). Në pikën 2 të tij, ky vendim përcakton se *të gjithë anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk kanë konflikt interesi me subjektin e rivlerësimit për trupin gjykues, ku ata bëjnë pjesë*. Bashkëlidhur vendimit të sipërcituar gjendet akti “Deklaratë për konfliktin e interesit”, i nënshkruar nga secili prej anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit. Nëpërmjet postës elektronike, me e-mail-in e datës 18.11.2020, Komisioni, nëpërmjet “Njoftim për njohjen me përbërjen e trupit gjykues”, i ka bërë të njohur subjektit përbërjen e trupës gjykuese dhe të drejtën e tij për të deklaruar konfliktin e interesit. Rezulton se në deklaratat e bëra pas kësaj date, subjekti i rivlerësimit nuk ka shprehur asnjë pretendim për konflikt interesi me relatoren e çështjes as në përmbajtjen e shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe as në seancë dëgjimore publike.

15.2 Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se relatorja e çështjes së tij në Komision duhet të ishte tërhequr nga trupi gjykues e, në këto kushte, duhet të parandalonte konfliktin e interesit, pasi subjekti ka gjykuar një sërë çështjesh administrative në të cilat

⁷ Sipas parashikimeve të rregullores së Komisionit “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

drejtuese e institucionit palë në gjykime ka qenë motra e relatores, vërehet se ligji nr. 84/2016, në nenin 27 të tij, garanton të drejtat e palëve për një proces të paanshëm, duke parashikuar mundësinë e përjashtimit të një anëtari të trupit gjykues kur ekzistojnë shkaqe papajtueshmërie, sipas nenit 30 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Fakti që Komisioni ia ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit trupën gjykuese në datën 18.11.2020 nëpërmjet postës elektronike, në përfundim të procedurës hetimore, në njoftimin e dërguar për datën e zhvillimit të seancës dëgjimore më 30.07.2020 dhe përsëri në seancën dëgjimore të datës 11.09.2020, dëshmon përmbushjen e detyrimit ligjor për t’i garantuar subjektit të drejtën për të ngritur çdo pretendim në raport me shkeljen e parimit të paanësisë në procesin e rivlerësimit, pretendime që subjekti nuk i ka ngritur në asnjë moment të procesit, por i ngre vetëm në ankimin e tij.

15.3 Nga sa parashtron vetë subjekti i rivlerësimit, verifikimi i pretendimeve të tij nuk varej nga momenti i komunikimit të përbërjes së trupës gjykuese, pasi për faktin se relatorja është motra e ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë është njohur nga një njoftim në median e shkruar, pas marrjes së vendimit nga Komisioni. Në argumentimin e situatës së konfliktit të interesit për faktet e sipërcituara, subjekti bazohet në parashikimin e nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative⁸, pa cituar dhe argumentuar rastin konkret në të cilin ai pretendon se gjendej relatorja e çështjes. Në raport me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se faktet e deklaruara prej tij nuk përbëjnë shkaqe serioze njëanshmërie, pasi vetëm fakti i qenies së relatores së çështjes motra e ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe gjykimi prej subjektit i çështjeve me palë këtë institucion nuk mund të konsiderohet marrëdhënie interesi në kuptim të normës së cituar më sipër. Neni 3, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, përkufizon konfliktin e interesit si gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë

⁸ Neni 30 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon:

Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur: a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim; b) bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim; c) nëpunësi publik, ose anëtari i organit kolegjial ose edhe personat e parashikuar në shkronjën “b”, të këtij neni, kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në një çështje objektivisht të njëjtë dhe me të njëjtat rrethana ligjore me çështjen në shqyrtim; ç) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial ka marrë pjesë si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim; 24 25 d) personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni, kanë marrë pjesë si ekspertë përfaqësues, këshilltarë apo avokatë në çështjen në shqyrtim; dh) ndaj nëpunësit publik ose personave të parashikuar në shkronjën “b”, të këtij neni, ka nisur një proces gjyqësor nga palët në procedurën administrative në shqyrtim; e) çështja në shqyrtim është një ankim kundër një vendimi të marrë nga nëpunësi publik ose nga personat e parashikuar në shkronjën “b” të këtij neni; ë) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni, janë debitorë ose kreditorë të palëve të interesuara në procedurën administrative në shqyrtim; f) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni, kanë marrë dhurata nga palët përpara ose pas fillimit të procedurës administrative shqyrtim; g) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim; gj) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni, janë përfshirë në çdo lloj mënyre në: i) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e nëpunësit apo personave të përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni, gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat, pas lënies së detyrës, të kryera nga ai gjatë ushtrimit të detyrës; ii) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër; h) në çdo rast kur parashikohet nga legjislati në fuqi.

të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike. Ndërsa neni 5, pika 1, shkronja “dh” e të njëjtit ligj, si interesa privatë të zyrtarit përkufizon ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: “dh) marrëdhënie: i) familjare apo të bashkëjetesës; ii) të komunitetit; iii) etnike; iv) fetare; v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë”.

Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova për të vërtetuar pretendimin e tij, por thjesht ka cituar disa vendime gjyqësore, në të cilat, sipas tij, palë ka qenë institucioni i drejtuar nga znj. B. B.. Por vetëm ky fakt, pra, ushtrimi i funksionit, pa u arritur të provohet interesi privat i zyrtarit në këndvështrim të parashikimeve të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, të sipërcituara, nuk mund të përbëjnë shkak njëanshmërie për komisioneren znj. Pamela Qirko, motra e ministres në fjalë. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë të dhënë tjetër që të tregojë natyrën e marrëdhënies së tij në cilësinë e gjyqtarit me znj. B., si drejtuese e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila të mund të ndikonte vullnetin e komisioneres znj. Qirko në shqyrtimin e çështjes. Sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbetet i pabazuar.

16. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas së cilit *drejtimi i hetimit administrativ nga relatorja e Komisionit ka qenë arbitrar dhe diskriminues, duke krijuar situata fiktive të paqena, me qëllim shtrembërimin e realitetit, çka jo vetëm cenon parimin e ligjshmërisë dhe sigurinë juridike, por përbën shkak për procedim disiplinor të anëtarëve të Komisionit, sipas nenit 16, pika 12 e ligjit nr. 84/2016*, trupi gjykues vërehet se subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se:

a) në pyetësoin e dërguar më datë 13.04.2020, Komisioni e ka pyetur nëse në sipërfaqen e tokës të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (në vijim “ZVRPP”) Pukë, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (në vijim “AMTP”) nr. {***}, datë 02.10.1992, a ndodhet ndërtesë, nisur nga shënimi në kartelën e pasurisë “LN gusht 2003”, i supozuar se nënkuptonte “leje ndërtimi”. Ky është një shtrembërim i faktit prej Komisionit, me qëllim dezinformimin deri në trajtim termash të pakuptimtë me qëllim diskriminimi, pasi shënimi “LN” nënkupton “libri i ngastrave”;

b) Komisioni i ka cenuar të drejtën e ushtrimit lirshëm të besimit fetar, duke i dërguar pyetësoin në datën 13.04.2020, kur ishte festa zyrtare e Pashkëve Katolike, me qëllim që ai dhe familja e tij të mos i ushtronin këto të drejta kushtetuese;

c) qëndrimi diskriminues i relatores është reflektuar gjatë hetimit administrativ, duke e urdhëruar subjektin e rivlerësimit për të shkelur aktet normative “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, pasi në përmbajtjen e pyetësoit nr. 4 është urdhëruar për të shkruar në vend për të bërë fotografime të pronave, të cilat i nënshtroheshin kontrollit gjatë këtij procesi;

d) veprimet administrative të Komisionit kanë qenë rezultat i mosveprimit dhe mosshqyrtimit të kërkesave të subjektit të rivlerësimit, për të cilat nuk ka një vendim të ndërmjetëm të arsyetuar dhe të komunikuar me qëllim kundërshtimin e tyre, në shkelje të nenit 6 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit Komisioni duhet të shprehet për të gjitha kërkimet e paraqitura në proces, si dhe në shkelje të nenit 10 të Kodit të Procedurave Administrative, duke cenuar parimin e ligjshmërisë, parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, si dhe parimin e barazisë para ligjit e mosdiskriminimit, pasi subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar komisionerit të kontaktit një kopje të raportit të ILDKPKI-së, si dhe çdo provë të bashkëngjitur këtij raporti dhe, për këtë kërkesë, deri më sot nuk ka asnjë përgjigje administrative;

e) Komisioni, për raste me problematika të ngjashme me ato të konstatuara për subjektin e rivlerësimit, ka mbajtur qëndrime të ndryshme.

16.1 Në analizë të pretendimeve të mësipërme, trupi gjykues vëren se në pyetësoin e dërguar më datë 13.04.2020, Komisioni i ka drejtuar subjektin të rivlerësimit pyetjen: “A ndodhet ndërtesë në këtë sipërfaqe toke regjistruar në ZVRPP-në Pukë në pronësinë tuaj me

origjinë sipas AMTP-së nr. {***}, datë 02.10.1992, nisur nga shënimi “LN GUSHT 2013” (supozuar leje ndërtimi)? Nëse po, depozitoni dokumentacion justifikues ligjor për ndërtimin dhe burimin e krijimit”. Në përgjigje të kësaj pyetje, subjekti ka shpjeguar [...] sqaroj se akronimi “LN” nuk përfaqëson ndonjë leje ndërtimi të dhënë faktin se regjistrimi është kryer kryesisht nga autoritetet kompetente të ngarkuara me menaxhimin e regjistrimit të ZVRPP-së nga të dhënat e Librit të Ngastrave dhe jo mbi kërkesën për regjistrim të pronarit të supozuar [...]. Sa më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur gjatë procesit në Komision asnjë pretendim për shtrembërime të qëllimshme të fakteve prej këtij të fundit, me qëllim diskriminimi. Një pretendim të tillë, subjekti nuk e ka paraqitur as në vijim të zhvillimit të procesit gjatë shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ e as në qëndrimin e mbajtur në seancë dëgjimore publike. Konstatimin mbi shënimin “LN” në kartelën e pasurisë objekt kontrolli, Komisioni nuk e ka përsëritur më tej në rezultatet e hetimit administrativ e as në vendim, duke mos sjellë asnjë pasojë për arsyetimin e vendimit dhe arritjen e konkluzioneve mbi bazën e të cilave është marrë masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit.

16.2 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni i ka cenuar të drejtën e ushtrimit lirshëm të besimit fetar, duke i dërguar pyetësorin në datën 13.04.2020, kur ishte festa zyrtare e Pashkëve Katolike, nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, me e-mail të datës 13.04.2020, ora 12:15, i ka dërguar subjektit të rivlerësimit pyetësorin nr. 3, duke i lënë afat për kthimin e përgjigjeve ndaj pyetjeve të drejtuara, brenda datës 25.04.2020. Përpos faktit që Komisioni i ka lënë një afat 12-ditor për kthimin e përgjigjeve, nga verifikimi i kalendarit të festave zyrtare për vitin 2020, rezultoi se festa zyrtare e pashkëve katolike për atë vit ka qenë në datën 12.04.2020. Sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se dërgimi i pyetësorit nr. 3 prej Komisionit në datën 13.04.2020, nuk duket se ka cenuar lirinë e ushtrimit të besimit fetar nga subjekti i rivlerësimit.

16.3 Lidhur me pretendimin se qëndrimi diskriminues i relatores së trupës gjykuese të Komisionit është reflektuar gjatë hetimit administrativ, duke e urdhëruar subjektin për të shkelur aktet normative “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, pasi në përmbajtjen e pyetësorit nr. 4 është urdhëruar për të shkuar në vend për të bërë fotografime të pronave, të cilat i nënshtroheshin këtij procesi, konstatohet se në pyetësorin drejtuar subjektit me e-mail të datës 27.04.2020, Komisioni, për pasurinë “tokë bujqësore me sipërfaqe 3843.5 m², në fshatin {***}”, i ka kërkuar: “Sa më sipër kërkojmë të deklaroni nëse e keni/keni pasur në shfrytëzim/e keni shfrytëzuar pasurinë e sipërcituar dhe a keni kryer investime në të? Gjithashtu, kërkojmë të depozitoni fotografi ku të paraqiten pamje të kësaj pasurie dhe investimeve të mundshme të kryera mbi të”. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e tij, ka sqaruar se: “Nga komunikimi me bashkëshorten time më konfirmoi se këtë pronë nuk e ka shfrytëzuar asnjëherë dhe nuk ka bërë asnjë investim në të (fakt që vërtetohet nga vërtetimi i zyrës së regjistrimit të pasurive të paraqitur pranë këtij institucioni, por edhe nga paraqitja elektronike aktuale në google e kësaj prone). Lidhur me paraqitjen e fotografive me pamje të kësaj pasurie, për shkak të situatës së “Covid 19” dhe gjendjes së pandemisë, e kam pasur të pamundur të realizoj një filmim të pronës. Sapo të hiqet kjo gjendje menjëherë do të mundësoj realizimin e kësaj pyetje”.

Trupi gjykues vëren se në kohën e dërgimit të pyetësorit të sipërcituar ishte në fuqi Akti Normativ nr. 3, datë 15.03.2020, i Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19” dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.03.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, akte të cilat kufizonin lëvizjen e lirë të shtetasve brenda vendit. Subjekti i rivlerësimit, pamundësinë e tij për të përmbushur kërkesën e drejtuar nga Komisioni, e ka përlligjur me gjendjen e fatkeqësisë natyrore për shkak të përhapjes së “COVID 19”. Mosplotësimi nga subjekti i rivlerësimit të kërkesës së drejtuar nga Komisioni nuk ka sjellë

asnjë pasojë, në drejtim të vlerësimit të pasurisë objekt kontrolli, pasi gjetjet e Komisionit në rezultatet paraprake të hetimit administrativ⁹, për pasojë dhe konkluzionet e arritura në vendim, nuk mbështeteshin në rrethana të cilat lidheshin me kërkesën e bërë në pyetësin nr. 4, të sipërcituar.

16.4 Për sa i përket pretendimit se subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Komisionit një kopje të raportit të ILDKPKI-së, si dhe çdo provë të bashkëngjitur këtij raporti dhe për këtë kërkesë deri më sot nuk ka asnjë përgjigje administrative, nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ, rezulton se me përgjigjet e pyetjeve të pyetësin nr. 4, subjekti i rivlerësimit i ka drejtuar Komisionit kërkesën e pretenduar në datën 08.05.2020. Megjithëse Komisioni nuk i ka kthyer një përgjigje të dedikuar kërkesës së mësipërme të drejtuar nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se në datën 30.07.2020, Komisioni i ka drejtuar “Njoftim për njohjen me dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit”. Në datën 03.08.2020, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar një deklaratë, në të cilën ka deklaruar se është njohur dhe ka marrë të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej tij, në format elektronik CD dhe në formë shkresore, duke mos pasur asnjë vërejtje për të. Kopje e formatit elektronik CD gjendet edhe në dosjen e përcjellë nga Komisioni në Kolegj, nga verifikimi i së cilës rezultoi se brenda saj gjendet edhe dosja e hetimit të zhvilluar nga ILDKPKI-ja, si dhe deklaratat e pasurisë të dorëzuara në vite nga subjekti i rivlerësimit pranë këtij institucioni. Në këto rrethana, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkuar nuk është i bazuar.

16.5 Sa i përket pretendimit se Komisioni, për raste me problematika të ngjashme me ato të konstatuara për subjektin e rivlerësimit, ka mbajtur qëndrime të ndryshme duke i konfirmuar në detyrë, si në rastin e subjekteve të rivlerësimit A. Nasufi, E. Kaçkini, E. Xhengo, trupi gjykues vlerësoi se një pretendim i tillë i subjektit të rivlerësimit nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e rrethanave faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për këtë situatë konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Një qëndrim i tillë është tashmë i konsoliduar nga jurisprudenca e Kolegjit.

16.6 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar, gjithashtu, se në seancë dëgjimore ai ka relatuar se trupi gjykues ka mbajtur qëndrime të ndryshme për raste të njëjta, por në përgjigje të kërtimeve të tij është shprehur anëtarja e trupit gjykues znj. Sanxhaktari, e cila, me pohimin se nuk janë raste të njëjta, ka shprehur hapur njëanshmërinë në marrjen e vendimit dhe paragjykimin e çështjes pa shpallur vendimin, një veprim ky arbitrar dhe që cenon parimin e procesit të rregullt ligjor. Në analizë të këtij pretendimi, nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore publike të zhvilluar në datën 11.09.2020, trupi gjykues konstatoi se kryesuesja e çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari është shprehur *se sigurisht që sqarimet do të jepen në vendimin përfundimtar të Komisionit, por krahasimi i rasteve nuk duket identik, pasi në të dy rastet që ju i referoheni, pasuria e personave të tjerë të lidhur, pra e bashkëshortëve për të cilën Komisioni është shprehur në ato vendime, i referohet pasurive të krijuara përpara martesë dhe të ekzekutuara, pra bëhet fjalë për pasuri shtëpi, të blera përpara martesë, ndërsa*

⁹ Në rezultatet e hetimit administrativ, për këtë pasuri, Komisioni i ka ngarkuar subjektin barrën e provës: “Sa më sipër duket se subjekti/personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri. Por, nisur nga analiza e kryer sa më sipër, sipas së cilës personi i lidhur nuk disponon dokumentacion justifikues ligjor për: (i) pasuritë e deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë (likuiditet cash); dhe (ii) dhurimet e deklaruar, ndër vite, që ka sjellë si pasojë mospërfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të pretenduara nga interesat e huave, si edhe në konsideratë të analizës financiare, sipas së cilës disa vite rezultojnë me balancë negative të fondeve (përfshirë këtu dhe vitin 2015), duket se nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

në rastin e bashkëshortes tuaj, shqetësimi i Komisionit ka qenë lidhur me faktin që bashkëshortja juaj ka sjellë pasuri cash, përpara martesë të cilat janë zbatuar dhe janë shtuar prej saj gjatë martesës me subjektin e rivlerësimit. [...] Pra, kontratat që ju referoni që kanë përqindje interesi në çdo rast legjitimojnë interesin, jo principalin dhe e gjithë shuma në total është përdorur për të shtuar pasuri gjatë martesë, kështu që ky ka qenë shqetësimi dhe këmbëngulja e Komisionit gjatë hetimit të tij, pra ka qenë ashtu si në gjithë rastet e tjera, nuk ka qenë veçanërisht, megjithatë besoj që detajet do t'i shihni në vendimin përfundimtar”.

Nga përmbajtja e citimit të mësipërm, trupi gjykues vëren se kryesuesja znj. Sanxhaktari ka shpjeguar qëllimin e hetimit të kryer nga Komisioni në rastin konkret, pa paragjykuar çështjen dhe pa dhënë zgjidhjen e saj. Subjekti i rivlerësimit, në vijim të seancës dëgjimore, nuk ka shprehur asnjë kundërshtim apo pretendim për paragjykim të çështjes nga kryesuesja.

Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se shkaku i ankimit të subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

17. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *procesverbali i seancës dëgjimore nuk i është vënë në dispozicion së bashku me vendimin, por i është dashur të bëjë kërkesë të re për t'u pajisur me të*, trupi gjykues vëren se neni 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016 parashikon njoftimin e subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, për vendimin me shkrim dhe jo për procesverbalin e seancës dëgjimore publike. Edhe ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, në nenin 36, parashikon të drejtën e palëve për t'u njohur e për të marrë kopje të akteve që gjenden në dosjen gjyqësore. Me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 15.01.2021, Komisioni i ka vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit audion e seancave dëgjimore të zhvilluara ndaj tij, në përgjigje të kërkesës së drejtuar prej tij. Sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore për njoftimin e vendimit me shkrim, për pasojë shkaku i ankimit të subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

18. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni nuk ka vlerësuar provat e paraqitura prej tij, pasi nga relatorja e çështjes, në seancë dëgjimore u kërkua paraqitja e tyre në formën e kërkuar nga ligji edhe pse ato ishin paraqitur prej tij në formën e kërkuar përpara zhvillimit të seancës, çka cenon parimin e ligjshmërisë, por edhe përbën shkelje disiplinore për anëtarët e trupës gjyqësore të Komisionit, sipas nenit 16, pika 12 e ligjit nr. 84/2016.*

Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues konstatoi se në vendimin e Komisionit janë pasqyruar të gjitha provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, së bashku me prapësimet për rezultatet e hetimit, provat e tjera të paraqitura përpara zhvillimit të seancës dëgjimore publike, më datë 24.08.2020 dhe është kryer analizimi dhe vlerësimi i tyre në përputhje me përcaktimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sa i përket vlerës provuesë të tyre në raport me provat dhe aktet e tjera të administruara gjatë hetimit, si dhe për ndikimin e tyre në konkluzionet dhe në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

18.1 Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, i cili lidhet me dokumentacionin e dorëzuar prej tij përpara seancës dëgjimore publike, për të provuar mundësinë e të afërmeve, për të krijuar me burime të ligjshme dhuratat monetare të dhëna atij, nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 11.09.2020, trupi gjykues vëren se relatorja e çështjes ka referuar rezultatet e hetimit administrativ. për të cilat subjektit i ka kaluar barra e provës e, më tej, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit se *nëse keni mundësi të na depozitoni në formën e kërkuar nga ligji gjithë dokumentacionin për sa i përket personave të tjerë të lidhur që ju i keni deklaruar se kanë bërë dhurime përkatëse*. Subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur se këtë dokumentacion e kishte dorëzuar në Komision, në datën 24.08.2020.

Në vendim, Komisioni ka arsyetuar se *pas kalimit të barrës së provës, Komisioni vëren se subjekti ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor (të legalizuar dhe të përkthyer në*

gjuhën shqipe) për të ardhurat e realizuara në shtetin italian nga z. A. P. bashkëshorti i znj. A. P (motrës së subjektit) dhe për të ardhurat e realizuara në shtetin grek nga znj. V. K. (motra e subjektit) dhe z. A. K. (bashkëshorti i motrës së subjektit). Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar dhe nga analiza e të ardhurave të evidentuara si të realizuara ndër vite nga shtetasit e sipërcituar, bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni vlerëson se ata kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar dhurimet e kryera, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore të pasurisë.

Nga sa më sipër, trupi gjykues çmoi se subjektit të rivlerësimit i është garantuar e drejta për të paraqitur prova dhe se Komisioni ka kryer procesin e shqyrtimit dhe të vlerësimit të provave në të gjitha fazat e procesit të rivlerësimit, si dhe ka argumentuar vlerën e tyre provuese në vendimin përfundimtar. Për rrjedhojë, gjenden të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim.

19. Lidhur me shkakun e ankimit se çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit për subjektin e rivlerësimit, po nga e njëjta trupë, cenon haptazi parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, duke e bërë Komisionin një organ me natyrë të dyfishtë edhe organ “akuzator” edhe vlerësues, trupi gjykues nënvizon qëndrimin e mbajtur në vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit, sipas së cilave pretendime të tilla janë gjetur të pabazuara në ligj, me arsyetimin se veprimtaria e trupit gjykues të Komisionit, kompetencat e tij në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar edhe nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017. Në të njëjtin konkluzion, për moscenim të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, ka arritur edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen gjyqësore *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*¹⁰, në drejtim të vlerësimit të pretendimeve të ngjashme të kërkuases lidhur me cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.
20. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se deklarimi vlerësohet i pamjaftueshëm, nëse përmban një nga situatat e përcaktuara në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, të cilat, për sa kohë sjellin të njëjtën pasojë, atë të parashikuar në nenin 61, pika 3 e të njëjtit ligj, që përbën shkak për shkarkimin e subjektit nga detyra, duhet të jenë në të njëjtin nivel rëndësie dhe provueshmërie, si dhe të përbëjnë sjellje të rëndë të subjektit të rivlerësimit të një niveli të njëjtë ose të përafërt. Subjekti i rivlerësimit argumentoi se sa më sipër parashtruar, mungesa e burimeve financiare për të justifikuar pasuritë mund të përbëjë deklarim të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit, vetëm nëse është në atë nivel të rëndë shkeljeje, të krahasueshëm ose të barabartë me fshehjen e pasurisë, deklarimin e rremë ose situatën e konfliktit të interesit të parashikuara nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
Sa i përket këtij shkak ankimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tilla të subjekteve të rivlerësimit si të pabazuara në ligj, për sa kohë konstatimet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si situata të cilat mund ta vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, nuk vlerësohen në raport apo të ndërlidhura me njëra-tjetrën, por shihen si situata të pavarura, në kuadër të prodhimit të pasojave të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, gjenden të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim.
21. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni ka vendosur në kundërshtim edhe me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon

¹⁰ Paragrafët 294-317 të vendimit të GjEDNj-së *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, 9 shkurt 2021.

plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kritereve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë.

Edhe lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues i drejtohet jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me raportin e pavarur që kanë këto dy dispozita në prodhimin e pasojës juridike të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Sikundër dhe sa i takon mënyrës së vlerësimit të secilit kriter rivlerësimi të pasurisë dhe kontrollit të figurës, e cila është e pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit për secilin kriter objekt shqyrtimi vlerësohet i pamjaftueshëm. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se ky pretendim është i pabazuar në ligj dhe nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit.

C. Vlerësimi lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

22. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas së cilit konkluzioni i Komisionit mbi pasurinë e llojit “tokë bujqësore” me sipërfaqe 1639 m², në Fushë-Arrëz, është i gabuar dhe kontradiktor, pasi nuk janë analizuar dhe vlerësuar drejt provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, deklaratimet sqaruese të tij sipas pyetësorëve dhe në seancë dëgjimore publike, trupi gjykues vëren se në lidhje me pasurinë objekt ankimi, Komisioni, në vendim¹¹, ka arritur në përfundimin se [...] Si konkluzion, në vlerësim të provave të administruara në dosje, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se z. Arjan Qafa ka vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës, pasi, megjithëse ka pasur dijeni të plotë se e ka përfutur këtë pasuri në kundërshtim me dispozitat ligjore të kohës, e ka fshehur këtë rrethanë në deklaratën vetting, si edhe nuk ka ndërmarrë në kohë veprimet e duhura ligjore për të rregulluar situatën faktike-juridike lidhur me këtë pasuri, çka cenon figurën e gjyqtarit të Republikës së Shqipërisë.
23. Nga shqyrtimi i akteve të administruara nga hetimi i kryer nga Komisioni, rezulton se situata faktike, lidhur me marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me pasurinë objekt kontrolli, paraqitet si vijon.

23.1 Pasuria “tokë bujqësore”, me sipërfaqe 1639 m², në fshatin Fushë-Arrëz, me nr. pasurie {***}, vol. {***}, f. {***}, ZK {***}, është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, në datën 30.10.2003, bazuar në Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (në vijim “AMTP”) me nr. {***}, datë 02.10.1992. Referuar këtij Akti, në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 17.07.1991, “Për tokën”, rezulton se familjes së A. Ll. Q., në fshatin Fushë-Arrëz, i është dhënë në pronësi tokë gjithsej 1716 m², nga të cilat 1566 m² tokë arë dhe 150 m² tokë truall¹². Ky akt është depozituar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pukë me procesverbal nga punonjësi i zyrës së Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës (në vijim “AMT”) Pukë më datë 15.11.2007, së bashku me kopje të procesverbalit dhe formularit nr. {***}, në të cilin figuron emri i subjektit të rivlerësimit, me të dhënat e regjistruara për sipërfaqen e marrë në pronësi, sipas AMTP-së nr. {***}¹³. Sipas informacionit të përcjellë në

¹¹ Paragrafi {***} i vendimit.

¹² Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pukë, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.04.2020.

¹³ Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Vendore Pukë, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.05.2020.

Komision nga Këshilli i Qarkut Shkodër¹⁴, në zbatim të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, i ndryshuar, plotësimi i dokumentacionit AMTP dhe dhënia e këtij dokumentacioni subjekteve të ligjit është detyrim ligjor i Komisionit të Ndarjes së Tokës në Fshat. Zyra e AMT-së Pukë ka vendosur në dispozicion të këtij Komisioni dokumentacionin kadastral të vitit 1985-1990, libër ngastre “LN”, si dhe hartë kadastrale, të cilët përcaktojnë llojin e tokës “zërin kadastral objekt i ligjit 7501”, si dhe pozicionin gjeografik të sipërfaqes objekt plotësimi. Dokumentacioni ligjor AMTP është plotësuar nga Komisioni në dy kopje: për poseduesin e tokës, si edhe për zyrën e AMT Pukë, kopje e së cilës i është përcjellë ZVRPP-së Pukë për të vijuar procesin e regjistrimit.

23.2 Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për herë të parë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit¹⁵, bashkëlidhur së cilës ka paraqitur edhe shkresën nr. {***} prot., datë 21.10.2016, të ZVRPP-së Pukë, drejtuar subjektit të rivlerësimit, e cila e informon mbi të dhënat e pasurisë së regjistruar në pronësi të tij.

24. Në shpjegimet e dhëna, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni¹⁶, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se [...] nuk është i vërtetë fakti se sipërfaqja e pronës prej 1639 m² është fituar me ligjin nr. 7501/1991 prej meje dhe se unë zotëroj 100% të pronësisë mbi këtë pronë. Nga vërtetimi i datës 05.08.2020 i Kryetarit të fshatit Fushë-Arrëz rezulton se unë nuk kam qenë përfitues i ligjit nr. 7501, të vitit 1991, në këtë fshat. Në këto rrethana, duke qenë se unë nuk kam pasur dijeni në lidhje me ekzistencën e AMTP-së nr. {***}, datë 02.10.1992, të cilën unë nuk e kam marrë ndonjëherë në dorëzim, nuk kam pasur shkak për deklarin e kësaj prone në vitin të parë të deklaramit të pasurisë. Deklarimi në deklaratën vetting është bërë për korrektësi, vetëm pasi unë kam marrë dijeni se prona ishte e regjistruar në ZVRPP-në Pukë në emrin tim. [...] Përpyqjet e mija kanë qenë të vazhdueshme për të verifikuar ligjshmërinë e aktit edhe me kërkesën time pranë Komisionit, për të bërë ekspertimin grafik të shkrimit të marrësit në dorëzim të AMTP-së nr. {***}, datë 02.10.1992, duke deklaruar se ky akt nuk është i ligjshëm, se në datën e lëshimit të këtij akti unë kam qenë student dhe nuk kam qenë i pranishëm dhe nuk jam vënë në dijeni asnjëherë për këtë akt. [...].

Bashkëlidhur shpjegimeve si më sipër, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin si vijon.

a) Shkresën nr. {***} prot., datë 05.08.2020, e Kryetarit të fshatit Fushë-Arrëz, z. A. T., drejtuar subjektit të rivlerësimit, në të cilën sqaron se [...] kërkesa e paraqitur në muajin tetor të vitit 2016 i ka kaluar për trajtim sektorit të menaxhimit të tokave bujqësore, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, nga kryesia e fshatit Fushë-Arrëz. Në vijim sqarojmë se procesi i regjistrimit të pasurive në të gjithë territorin e fshatit Fushë-Arrëz është bërë nga zbatimi i projektit të azhornimit dhe regjistrimit të pronave dhe jo me aplikim fillestar nëpërmjet pronarëve të pronësisë. Kjo strukturë komunitare në fshatin Fushë-Arrëz, bazuar në nenet 70 dhe 71 të ligjit nr. 139, të vitit 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ka marrë të gjitha masat ligjore lidhur me ankesën tuaj, për verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. {***}, datë 02.10.1992 dhe AMTP-së

¹⁴ Informacion i përcjellë me shkresë nr. {***} prot., datë 07.05.2020.

¹⁵ Pasuria nuk është deklaruar më parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara, ndër vite, në ILDKPKI.

¹⁶ Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, barrën e provës për: (i) Subjekti e ka fituar këtë pasuri në kundërshtim me dispozitat ligjore të kohës dhe se, Komisioni ngre dyshimin e arsyeshëm se kjo pasuri është fituar me dokumentin AMTP të lëshuar nga komisionet e ndarjes së tokës në fshat, i cili nuk ka formën që kishin/janë paraqitur AMTP-të e kohës; (ii) Subjekti ka vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës, pasi megjithëse pretendon se është njohur me ekzistencën e kësaj pasurie në momentin e mbledhjes së dokumentacionit për plotësimin e deklaratës vetting, nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura ligjore për të rregulluar situatën juridike lidhur me këtë pasuri, të regjistruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në emrin e tij.

me nr. {***}, datë 02.10.1992, pasi kërkuesi Arjan Qafa nuk është përfitues në asnjërin nga këto akte.

b) Shkresë nr. {***} prot., datë 05.08.2020, e Kryetarit të fshatit Fushë-Arrëz, z. A. T., drejtuar subjektit të rivlerësimit, i cili sqaron se [...] zbatimi i ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, në ish-kooperativën bujqësore të fshatit Fushë-Arrëz, për shkak të sipërfaqes së vogël të tokës bujqësore në dispozicion për t'u shpërndarë, është bazuar në kufijtë e vjetër të kontribuuesve të krijimit të ish-kooperativave bujqësore dhe gjendjes civile në kohën e lëshimit të AMTP-së. [...] Sa më sipër, kërkuesi Arjan Qafa nuk ka qenë përfitues në zbatim të ligjit 7501, datë 19.07.1991, sepse nuk ka qenë kontribuues në krijimin e ish-kooperativave bujqësore.

c) Shkresë nr. {***} prot., datë 03.08.2020, e ASHK Zyra Vendore Pukë, drejtuar subjektit të rivlerësimit, në të cilën institucioni në fjalë, sqaron subjektin se regjistrimi fillestar i pasurisë është bërë sipas Aktit nr. {***}, datë 02.10.1992, nga Njësia e Menaxhimit të Projektit, më datë 20.08.2004, në bazë të kreut IV, pika 1 e rregullores 184, datë 08.04.1999 dhe jo me kërkesën tuaj.

25. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerësoi si vijon.

25.1 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka gabuar kur e vlerëson aktin e pronësisë në emër të tij, pasi ai në përgjigjet e të gjithë pyetësorëve dhe parashtrimet e paraqitura para Komisionit ka shpjeguar se nuk ka pasur dijeni për AMTP-në, nuk ka bërë kërkesë për regjistrim të pronës dhe nuk ka dalë një certifikatë pronësie për këtë pronë nga institucioni përkatës, vërehet se Komisioni, në vendim¹⁷, ka arsyetuar se Komisioni vëren se shkresa informuese e ZVRPP-së Pukë drejtuar subjektit (depozituar si dokument justifikues i vërtetësisë së deklaramit të kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit), referon se kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, por nuk pasqyron mënyrën e fitimit të saj.

Nga sa më sipër, trupi gjykues vëren se në ndryshim nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, Komisioni, në vendim, nuk ka bërë ndonjë vlerësim për sa i përket AMTP-së nr. {***}, datë 02.10.1992, në bazë të të cilit subjektit të rivlerësimit i është dhënë në pronësi pasuria objekt kontrolli.

25.2 Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni gabon kur aludon për simulime me qëllim justifikimin e vendimmarrjes, duke krahasuar formatin e AMTP-së nr. {***}, në emër të subjektit me atë në emër të babait të tij pa e krahasuar atë me listën e AMTP-ve të disa familjeve të fshatit, të cilat kanë edhe ato dy lloje formatesh word dhe excel të AMTP-ve, trupi gjykues vëren se Komisioni, në pjesën arsyetuese në vendim, nuk ka arritur në ndonjë konkluzion në drejtim të krahasimit të formateve të AMTP-ve, sipas së cilave subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij janë bërë pronar të sipërfaqeve përkatëse të tokës bujqësore në fshatin Fushë-Arrëz. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, janë përsëritje e shpjegimeve të dhëna prej tij në Komision, në kundërshtim të rezultateve të hetimit dhe, për rrjedhojë, u referohen gjetjeve paraprake për të cilat Komisioni në vendim nuk ka mbajtur qëndrim dhe, për pasojë, nuk ka arritur në konkluzione lidhur me to. Në këto kushte, pretendimi i sipërcituar nuk është relevant në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit lidhur me cenimin e rregullave të etikës së gjyqtarit nga subjekti i rivlerësimit.

25.3 Në kundërshtim të arsyetimit të Komisionit në vendim¹⁸ se [...] me deklaramin e kësaj pasurie subjekti nuk ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në pikën 1, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka depozituar dokumente justifikues për vërtetësinë e deklaramive të tij. Pra,

¹⁷ Paragrafi 27.3 i vendimit të Komisionit.

¹⁸ Paragrafi 27.5 i vendimit të Komisionit.

*nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, megjithëse ka deklaruar se është fituar me ligjin nr. 7501, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se në deklaratën e rivlerësimit ka sqaruar situatën faktike të AMTP-së, pa konfirmuar ligjshmërinë e tij, pasi deklarimi është bërë i tillë për të mos pasur penalizim për mosdeklarim të saktë. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se parashikimet e nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe pikës 8 të Udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016”, kërkojnë që deklarimi i pasurive të paluajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor, kontratë shitblerje, kontratë sipërmarrje, aktmarrëveshje, kontratë paraprake, kontratë porosie etj., si dhe certifikatën e pronësisë në rastet kur prona është e regjistruar në ZVRPP. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë të rivlerësimit, subjekti ka paraqitur si dokumentacion justifikues të pronësisë mbi tokën bujqësore, vetëm shkresën nr. {***} prot., datë 21.10.2016, të ZVRPP-së Pukë, që konfirmon regjistrimin e pasurisë objekt kontrolli në sistemin e pasurive të paluajtshme, e cila rezulton të jetë një nga dokumentet justifikuese të kërkuara nga kuadri ligjor për procesin e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nuk ka qenë në dijeni të ekzistencës së AMTP-së, prandaj nuk e ka paraqitur këtë akt bashkë me deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, duke pretenduar se dokumentacioni nga i cili mori dijeni për ekzistencën e pronës ishte shkresa e sipërcituar, por nga përmbajtja e deklarimit të tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit vërehet se në të janë paraqitur të dhënat *fituar me ligjin nr. 7501, e regjistruar pranë ZVRPP-në Pukë, sipas procesit të azhornimit të kësaj zyre*, të cilat nuk rezultojnë të jenë pasqyruar si informacion në shkresën nr. {***} prot., datë 21.10.2016, e ZVRPP-së Pukë. Këto elemente e kanë orientuar Komisionin drejt konkluzionit se subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni për ekzistencën e AMTP-së nr. {***}, datë 02.10.1992, e megjithatë nuk e ka paraqitur atë si dokumentacion justifikues, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, konkluzion i cili vlerësohet i drejtë edhe nga trupi gjykues.*

25.4 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni nga njëra anë pranon pretendimet se AMTP-ja nr. {***}, datë 02.10.1992, është një akt që nuk është marrë në dorëzim prej tij, ndërkohë që ngre pikëpyetje mbi sjelljen etike të tij pas marrjes dijeni të ekzistencës së këtij akti. Komisioni ka keqinterpretuar ligjin me qëllim, pasi megjithëse pranon faktin se subjekti nuk ka pasur dijeni për aktin dhe pronën, pasi ka qenë student, mohon faktin se ai u është drejtuar organeve të pushtetit lokal për rregullimin e paligjshmërisë, kjo e vërtetuar me vërtetimin e kryetarit të fshatit Fushë-Arrëz, të datës 05.08.2020. Subjekti i rivlerësimit mohon kategorikisht të ketë sjellje jo etike.*

Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se Komisioni në vendim, ka arsyetuar se *Komisioni vëren se, megjithëse kjo shkresë citon se subjekti ka paraqitur kërkesë në muajin tetor të vitit 2016 lidhur me ligjshmërinë e AMTP-së mbi bazën e së cilës është fituar pronësia e pasurisë objekt vlerësimi, subjekti nuk e ka depozituar këtë kërkesë, e cila do të provonte përpjekjen e tij për verifikimin në kohë të ligjshmërisë së këtij akti. Për më tepër, sikurse u evidentua më sipër në deklaratën vetting, subjekti nuk ka pasqyruar një rrethanë të tillë, e cila do mbështeste pretendimet e tij për situatën faktike mbi bazën e së cilës është fituar kjo pasuri. Si konkluzion, [...] z. Arjan Qafa ka vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës, pasi, megjithëse ka pasur dijeni të plotë se e ka përfitur këtë pasuri në kundërshtim me dispozitat ligjore të kohës, e ka fshehur këtë rrethanë në deklaratën vetting, si edhe nuk ka ndërmarrë në kohë veprimet e duhura ligjore për të rregulluar situatën faktike-juridike lidhur me këtë pasuri, çka cenon figurën e gjyqtarit të Republikës së Shqipërisë.*

Në raport me arsyetimin e vendimit, vërehet se disa prej argumenteve të subjektit të rivlerësimit në funksion të pretendimeve të tij janë të lidhura me konstatimet e Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ se *referuar të dhënave dhe dokumentacionit të administruar në dosje, nuk provohet që subjekti i rivlerësimit të ketë marrë pjesë me veprime aktive në regjistrimin e kësaj pasurie në emrin e tij. Gjithashtu, megjithëse ky akt (AMPT-ja) përpilohej në dy kopje dhe njëra prej kopjeve i jepej në dorëzim pronarit, nuk u provua, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se një kopje e këtij akti t'i jetë dorëzuar subjektit në momentin e përpilimit të tij.*

Trupi gjykues vëren se në shkresën drejtuar subjektit të rivlerësimit, me nr. {***} prot., datë 05.08.2020, kryetari i fshatit Fushë-Arrëz, z. A. T., ka sqaruar se *kërkesa e paraqitur në muajin tetor të vitit 2016 i ka kaluar për trajtim sektorit të menaxhimit të tokave bujqësore, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, nga kryesia e fshatit Fushë-Arrëz, por nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision rezultoi se ai nuk ka paraqitur kërkesën e muajit tetor 2016 e madje as nuk rezultoi të ketë ndërmarrë hapa mbi ndjekjen e kësaj kërkesë, e cila sipas kryetarit të fshatit rezultoi të jetë përcjellë në Bashkinë Fushë-Arrëz dhe kjo kërkesë as nuk është paraqitur nga subjekti si dokumentacion i justifikues që shoqëron deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Mosparaqitja prej subjektit e kërkesës së tij drejtuar kryetarit të fshatit Fushë-Arrëz, në tetor të vitit 2016, ka orientuar Komisionin drejt konkluzionit se subjekti nuk ka ndërmarrë në kohë veprimet e duhura ligjore për të rregulluar situatën faktike-juridike lidhur me këtë pasuri, çka cenon figurën e gjyqtarit. Trupi gjykues vëren se edhe në ankim, subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur asnjë argument dhe nuk ka paraqitur asnjë provë në drejtim të kohës se kur janë ndërmarrë prej tij veprimet për verifikimin e ligjshmërisë së titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore apo mbi arsyet e mosparaqitjes së kërkesës së tij lidhur me sa më sipër, e cila do të faktonte se kur janë ndërmarrë realisht këto veprime prej tij. Edhe shkresa e kryetarit të fshatit Fushë-Arrëz nuk paraqet të dhëna lidhur me ekstremitetet e regjistrimit të kërkesës së subjektit të rivlerësimit në kryesinë e fshatit Fushë-Arrëz, si dhe të shkresës me të cilën kjo kërkesë pretendohet se ishte përcjellë në Bashkinë Fushë-Arrëz. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë në kohë veprimet e duhura ligjore për të rregulluar situatën faktike-juridike lidhur me pasurinë “tokë bujqësore”, me sipërfaqe 1639 m², në Fushë Arrëz, konkluzion i cili do t'i shërbejë vlerësimit tërësor të çështjes, në përputhje me parashikimin e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*

25.5 Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kërkuar nga Kolegji që të çelë hetimin gjyqësor të çështjes dhe të pranojë kërkesën e tij për ekzaminimin e shkrimit në përmbajtje të AMTP-së me nr. {***}, datë 02.10.1992, të analizojë në tërësi të gjitha aktet e provat dhe të dalë në konkluzionin se AMTP-ja në fjalë nuk i përket subjektit dhe se ai nuk është sjellë asnjëherë si pronar i kësaj prone. Trupi gjykues vëren se ky pretendim është përsëritje e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në Komision, në kundërshtim të rezultateve të hetimit dhe, për rrjedhojë, u referohet gjetjeve paraprake nga hetimi administrativ, gjetje këto për të cilat Komisioni, në vendim, nuk ka arritur në konkluzione, në disfavor të subjektit. Për këtë arsye, kërkesa e subjektit për ekzaminimin e shkrimit në përmbajtje të AMTP-së nr. {***}, datë 02.10.1992, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, është një mjet prove tërësisht i papërshtatshëm, për shkak se nuk është relevant në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit, lidhur me vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli dhe, si i tillë, nuk mund të ndikojë në shqyrtimin e shkakut të ngritur në ankim.

- 26.** Lidhur me shkakun e ankimit sipas të cilit Komisioni ka treguar njëanshmëri dhe paragjykim në vlerësimin e provave për 1/10 pjesë e pasurisë së llojit “tokë bujqësore” me sipërfaqe totale 1955 m², në Fushë-Arrëz, pasi e ka bazuar arsyetimin duke paraqitur fakte të pavërteta si të gabuara, trupi gjykues konstatoi si vijon.

26.1 Subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar në bashkëpronësi në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme pasuritë, si vijon: pasurinë arë me sip. 600 m², në ZK {***}, nr. {***} pasurie, vol. {***}, f. {***}; pasurinë arë me sip. 428 m², në ZK {***}, nr. {***} pasurie, vol. {***}, f. {***}; pasurinë arë me sip. 927 m², në ZK {***}, nr. {***} pasurie, vol. {***}, f. {***}, të ndodhura në fshatin Fushë-Arrëz. Këto tre pasuri janë të regjistruara në sistemin e pasurive referuar AMTP-së nr. {***}, datë 02.10.1992, sipas regjistrimit të dëshmisë së trashëgimisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.10.2016, në emër të të ndjerit Ll. D. Q., babai i subjektit të rivlerësimit. Referuar AMTP-së nr. {***}, datë 02.10.1992, në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 17.07.1991, “Për tokën”, rezulton se familjes së Ll. D. Q., në fshatin Fushë-Arrëz, i është dhënë në pronësi tokë gjithsej 2562 m², nga të cilat 2262 m² tokë arë dhe 300 m² tokë truall¹⁹.

26.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron 1/10 e pasurisë së sipërcituar, për herë të parë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

26.3 Komisioni, në vendim²⁰, ka arsyetuar se duke qenë se rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit në datën 01.08.1991 ka qenë në përbërje familjare me babain e tij, në emër të të cilit është lëshuar AMTP-ja nr. {***}, datë 02.10.1992, si kryetar i familjes bujqësore, Komisioni çmon se rrjedhimisht subjekti zotëron pjesën e tij takuese nga toka që i është dhënë familjes bujqësore ku bënte pjesë.

27. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se AMTP-ja nr. {***}, datë 02.10.1992, i është dhënë babait të tij, në interpretim të dispozitave ligjore në fuqi, sipas VKM-së nr. 161, datë 08.04.1993, si kontribuues i ish-kooperativave bujqësore dhe jo si anëtar i familjes bujqësore. Sipas subjektit të rivlerësimit, edhe vërtetimi nr. {***} prot., datë 05.08.2020, i lëshuar nga kryetari i Fshatit Fushë-Arrëz, sqaron këtë situatë.

27.1 Në kuadër të shqyrtimit të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se vendimi i Këshillit të Ministrave i referuar nga subjekti i rivlerësimit është vendimi nr. 161, datë 08.04.1993 “Për disa shtesa e ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e Ndërmarrjeve Bujqësore”. Referuar datës së miratimit të këtij akti, ajo është më e vonë se data e dhënies së AMTP-së nr. {***}, datë 02.10.1992, babait të subjektit të rivlerësimit, për pasojë në ndryshim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, ky vendim [qoftë vendimi bazë, qoftë akti ndryshues] nuk mund të jetë dispozita ligjore në bazë të së cilës është dhënë AMTP-ja në fjalë. Për pasojë, Komisioni me të drejtë i është referuar dispozitave të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar, të cilat parashikojnë kalimin në pronësi të tokës bujqësore te anëtarët e kooperativës bujqësore.

Gjatë procedurës së hetimit administrativ në vijim të kërkesës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe certifikatën e gjendjes familjare nr. {***}, datë 17.04.2020, me anë të së cilës vërtetohet përbërja e familjes së z. Ll. Q. më datë 01.08.1991, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ishte pjesë e kësaj familje dhe, për rrjedhojë, bashkëpronar i pasurisë së llojit “tokë bujqësore”, të përfituar me AMTP-në nr. {***}, datë 02.10.1993, në cilësinë e anëtarit të familjes bujqësore, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”. Trupi gjykues vlerësoi se deklarimi i kryetarit të fshatit Fushë-Arrëz, i cili referon se kryesia e fshatit Fushë-Arrëz sqaron se zbatimi i ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 në ish kooperativën bujqësore të fshatit Fushë-Arrëz, për shkak të sipërfaqes së vogël të tokës bujqësore në dispozicion për t’u shpërndarë, është bazuar në kufijtë e vjetër të kontribuuesve të krijimit të ish-kooperativave bujqësore dhe gjendjes civile në kohën e lëshimit të AMTP-së,

¹⁹ Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga ZVRPP-ja Pukë, me shkresën nr. {***} prot., datë 08.02.2019 dhe shkresën nr. {***} prot., datë 16.04.2020.

²⁰ Paragrafi 31.5 i vendimit të Komisionit.

nuk mund të shërbejë si argument, për të përligjur devijimin nga zbatimi i parashikimeve ligjore.

27.2 Për sa i përket pretendimit të subjektit se në deklaratën e rivlerësimit ka deklaruar pjesën takuese që përkon me 1/10 e pasurisë, për këtë arsye nuk gjendet para deklaramit të pasaktë, pasi me provat e paraqitura gjatë hetimit administrativ ka provuar se në kohën kur është lëshuar AMTP-ja nr. {***}, datë 02.10.1992, ai ka qenë student, me gjendje civile të ndarë nga trangu familjar dhe nuk ka pasur dijeni të lëshimit të këtij akti dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të fituar të drejta reale mbi këtë pronë të trashëguar, trupi gjykues vëren se Komisioni në vendim²¹, ka arsyetuar se gjithsesi, Komisioni vëren se kjo pasuri është fituar me ligj dhe nuk mund të ketë dyshime për krijimin e saj. Në këtë këndvështrim, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se në atë kohë subjekti ka qenë student, mund të konsiderohen bindëse shpjegimet e tij për mospasjen dijeni asokohe të lëshimit të aktit të shpërndarjes së tokës bujqësore, mbi bazën e të cilit edhe ai ka fituar të drejta mbi pasurinë objekt vlerësimi. Si konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se pasaktësitë në deklaram lidhur me këtë pasuri janë pa pasoja konkrete dhe, si të tilla, ato nuk kanë prodhuar efekte rënduese gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar. Nga sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se Komisioni nuk ka konkluduar në disfavor të subjektit të rivlerësimit, për pasojë ky pretendim nuk është relevant në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli.

28. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas së cilit arsyetimi dhe konkluzioni i Komisionit për pasurinë tokë bujqësore, me sipërfaqe totale 6000 m², në fshatin {***}, Kurbin, mbështetet në fakte të pavërteta, të paplota dhe të deformatuara, në shkelje të detyrimit kushtetues të përcaktuar në nenin C, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues konstatoi si vijon.

28.1 Komisioni, në vendim²², në lidhje me këtë pasuri ka arritur në konkluzionin se referuar kontratës së shitblerjes kjo pasuri është blerë vetëm nga subjekti i rivlerësimit dhe se nuk qëndrojnë pretendimet se nëna e tij ka kontribuar në vitin 2000 me shumën prej 200.000 lekësh për blerjen e saj. [...] Pretendimet e subjektit lidhur me reduktimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën deri në datën 07.04.2000 (datë në të cilën është blerë pasuria), mbeten të karakterit deklarativ. [...] Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2000.

28.2 Pasuria “tokë bujqësore, me sipërfaqe totale 6000 m², në fshatin {***}, Kurbin” është regjistruar në ZVRPP-në Kurbin²³, në datën 07.04.2000, në emër të subjektit të rivlerësimit, në bazë të kontratës shitje toke, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.04.2000, me palë shitëse I. e S. K. dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit, me objekt shitblerjen e tokës bujqësore me sipërfaqe 6000 m², që ndodhet në fshatin {***}, Kurbin, kundrejt çmimit 600.000 lekë. Në datën 22.10.2009, ZVRPP-ja Kurbin ka bërë ndarjen e pasurisë në dy pasuri të veçanta dhe konkretisht: pasurinë e llojit “tokë arë” me sipërfaqe 4000 m² në emër të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasurinë e llojit “tokë arë” me sipërfaqe 2000 m² në emër të znj. Gj. N. Q., nënës së subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktin deklaratë noteriale “bashkëpronësie”, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.2009. Në këtë akt, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se pasurinë prej 6000 m² të llojit “tokë arë” nuk e ka blerë vetëm me kontributin e tij financiar,

²¹ Paragrafi 31.6 i vendimit të Komisionit.

²² Shih paragrafët 36.4-36.8 të vendimit të Komisionit.

²³ Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga ZVRPP-ja Kurbin, me shkresën nr. {***} prot., datë 08.02.2019.

por edhe me kontributin e nënës së tij, znj. Gj. Q., kontribut i cili është bërë në 1/3 pjesë të kësaj pasurie dhe, si rrjedhim, ai është pronar vetëm i 2/3 pjesë.

28.3 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar *1/3 e tokës bujqësore me sipërfaqe 6000 m² me nr. pasurie {***}, në fshatin {***} të rrethit Kurbin, e blerë me kontratën e datës 07.04.2000, me nr. {***} rep., nr. {***} kol. 1/3 e kësaj prone është blerë me kontributin e nënës sime, Gj. Q., e cila është shkëputur në vitin 2009, konfirmuar me deklaratën noteriale të datës 25.09.2009, me nr. {***} rep., nr. {***} kol. dhe deklaratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.01.2017, çmimi 600.000 lekë. Nga kjo shumë, 400.000 lekë janë marrë nga të ardhurat e mia nga paga, pjesa prej 200.000 lekësh është kontribut i nënës sime Gj. Q.. Pronë e konfirmuar me shkresën.. Vlera e pronës: 400.000 lekë. Pjesa në %: 100%.*

28.4 Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, ka deklaruar *tokë bujqësore 6000 m², fshati {***}, Kurbin, nr. pasurie {***}, datë regjistrimi në hipotekë 07.04.2000. Blerë me të ardhurat e familjes. Vlera: 600.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

28.5 Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2009, ka deklaruar *pakësuar pasuria e përbashkët me nënën para vitit 2004, nga 6000 m² bie në 4000 m², sipas deklaratës noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.05.2009. Kjo pasuri e paluajtshme “tokë bujqësore arë” me nr. {***}. Nëna ime Gj. Q. merr 2000 m² nga kjo pronë. 4000 m² tokë bujqësore arë. Pjesa në %: 100%.*

28.6 Në përgjigjen e përcjellë, më datë 23.04.2020, mbi pyetësonin e drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar *se [...] Burimi i krijimit të kësaj pasurie prej 6000 m² tokë arë, të blerë nga ana ime në vitin 2000, janë të ardhurat nga paga, të kursyera në vitet nga 1996 deri në vitin 2000, si dhe shuma prej 200.000 lekësh, të cilat ia kam marrë nënës time. Ndërkohë në vitin 2009, vendosa që detyrimin prej 200.000 lekësh që kisha ndaj nënës time për blerjen e sipërfaqes prej 6000 m² ta konvertoja duke i kaluar asaj pronësinë për sipërfaqen prej 2000 m², që korrespondonte me vlerën e kësaj sipërfaqeje në kohën e blerjes së pronës.*

28.7 Në shpjegimet e dhëna, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *se [...] Ndërkohë për pjesën tjetër të sipërfaqes së pronës prej 2000 m², të cilën nuk e disponoj që nga viti 2009, ia kam kaluar nënës time, kundrejt borxhit të marrë prej 200.000 lekësh në vitin 2000, të cilin nuk ia kisha likuiduar. Kjo shumë e borxhit të marrë nënës time ishte e barabartë me sipërfaqen e tokës prej 2000 m² (pra, kam sqaruar se unë nuk do të bëja tregti me nënën time). Kontributi i nënës sime në blerjen e të gjithë pasurisë së përshkruar në kontratën nr. {***}, datë 07.04.2000, nuk është specifikuar në kohën e kryerjes së veprimit juridik për vetë marrëdhënien e ngushtë familjare që ekzistonte mes nesh dhe mungesës së legjislacionit që impononte qartësimin e këtyre situatave, (në vitin 2000 nuk kisha detyrim ligjor për të deklaruar pasurinë dhe burimin e saj).*

28.8 Të njëjtin qëndrim, subjekti e ka mbajtur edhe në seancën dëgjimore publike në Komision, në datën 11.09.2020, si edhe në ankim.

29. Në shqyrtim të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerësoi si vijon.

29.1 Lidhur me pretendimin se hartimi i deklaratës noteriale në datën 25.09.2009 është bërë me qëllim kalimin e pronësisë së pjesës takuese prej 2000 m² te nëna e tij, në përputhje me kontributin e saj prej 200.000 lekësh kursime, megjithëse kontrata e shitblerjes është firmosur në mirëbesim vetëm nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, në çmimin në harmoni të deklarimeve në deklaratat e pasurisë, në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe në faktin se redaktimi i deklaratës noteriale të bashkëpronësisë nr. {***} rep.,

nr. {***} kol., datë 25.09.2009, nuk është hartuar nga subjekti i rivlerësimit duke qenë i kushtëzuar nga ndonjë verifikim apo kontroll i pasurive nga organi i kontrollit, ILDKPKI-ja, vlerësoi se në ndryshim nga sa konkluduar Komisioni, burimet e krijimit të pasurisë arë me sipërfaqe 6000 m², në {***}, Kurbin, rezultojnë të jenë: 400.000 lekë nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit në periudhën 1996-07.04.2000 [datë e blerjes së pasurisë objekt kontrolli] dhe 200.000 lekë kontribut nga nëna e tij. Për pasojë, nëna e subjektit të rivlerësimit nuk mund të cilësohet si person tjetër i lidhur, pasi nuk përmbushen kriteret e parashikuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, kontributi i dhënë prej saj në shumën prej 200.000 lekësh në blerjen e kësaj pasurie nuk mund të jetë objekt kontrolli nga organet e rivlerësimit. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim se ka pasur aftësi që me të ardhura të ligjshme nga paga e tij, të blinte pasurinë tokë bujqësore, në datën 07.04.2000, në kontroll të analizës financiare të kryer nga Komisioni, si dhe duke reflektuar në të qëndrimin e mësipërm, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka shpenzuar nga të ardhurat e tij vlerën prej 400.000 lekësh, nga analiza financiare e kryer në Kolegj rezultoi se ky pretendim është i bazuar, pasi rezultati i analizës financiare ishte një bilanc pozitiv i të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

30. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas të cilit *arsyetimi dhe konkluzioni i Komisionit për pasurinë pyll me sipërfaqe 1000 m², në malin Shëngjin, janë jo të drejta*, trupi gjykues konstatoi si vijon.

30.1 Në lidhje me pasurinë objekt kontrolli “pyll me sipërfaqe 1000 m² në malin Shëngjin, Lezhë”, subjekti, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ka deklaruar *1000 m² pyll e ndodhur në malin Shëngjin, konfirmuar me shkresën nr. {***} prot., datë 27.10.201, të ZVRPP-së Lezhë, fituar me kontratën e shitjes, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.01.2008. Kjo shumë e marrë nga të ardhurat dhe.. Vlera e pronës: 200.000 lekë. Pjesa në %: 100%.*

30.2 Në deklaratën e interesave të vitit 2008, subjekti ka deklaruar *shtesë të pasurisë së paluajtshme më datë 16.01.2008, blerë me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., 1000 m² tokë pyll të ndodhur në malin Shëngjin, Lezhë. Vlera: 200.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

30.3 Në përgjigjen e përcjellë më datë 23.04.2020, mbi pyetjet e drejtuara nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se *kjo pasuri është blerë me të ardhurat e pagës time të kursyera gjatë vitit 2008.*

30.4 Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i kërkuar subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, *deklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie.* Në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit nuk i është përgjigjur barrës së provës së kaluar nga Komisioni.

30.5 Komisioni, në vendim²⁴, ka arritur në përfundimin se *Komisioni i vlerëson bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti, lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie, por subjekti ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me këtë pasuri, pasi nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për blerjen e saj.*

31. Në kundërshtim të konkluzionit të arritur në vendim lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar se Komisioni është kontradiktor, pasi gjatë arsyetimit në vendim shprehet se deklarimi është i saktë, ndërsa në përmbyllje arsyeton se nuk është plotësisht i qartë burimi i krijimit të kësaj pasurie. Përpyjekjet e Komisionit për të shmangur realitetin e për t’i ndryshuar numrin zonës kadastrale, për të ndryshuar vendndodhjen e pasurisë së llojit “pyll”, në Malin Shëngjin, janë bërë me qëllim krijimin e të dhënave të pavërteta, që të pasqyrohen vlera më të larta të pasurisë, për të mos u justifikuar me burime të ligjshme prej

²⁴ Paragrafi 37.9 i vendimit të Komisionit.

subjektit të rivlerësimit, por ndryshe nga argumentet jologjike të Komisionit, ai ka pasur aftësi paguese, që me të ardhura të ligjshme nga pagat e tij, të blinte pasurinë e llojit “pyll”, në Malin Shëngjin, në vlerën 200.000 lekë.

32. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga kontrolli i vendimit të Komisionit, trupi gjykues konstaton se ky i fundit nuk ka arritur në ndonjë konkluzion në drejtim të vlerës së blerjes së pasurisë, pasoja këto të cilat të lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me çmimin e blerjes së saj për metër katror krahasuar me vlerën referuese sipas legjislacionit në fuqi për çmimin e trojeve në bashkitë e vendit. Trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim janë përsëritje e shpjegimeve të dhëna në Komision, në kundërshtim të rezultateve të hetimit dhe, për rrjedhojë, u referohen gjetjeve paraprake nga hetimi administrativ i Komisionit, gjetje këto për të cilat Komisioni në vendim ka konkluduar se *i vlerëson bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie*²⁵. Në këto kushte, vlerësohet se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk është relevant në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli dhe, si i tillë, nuk mund të ndikojë në shqyrtimin e shkakut të ngritur në ankim për kundërshtimin si të gabuar të konkluzionit të Komisionit për deklaram të pasaktë të burimit të krijimit të pasurisë objekt kontrolli. Në të njëjtin përfundim, trupi gjykues arrin edhe për sa i përket pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se ndryshe nga argumentet jologjike të Komisionit, ai ka pasur aftësi paguese, që me të ardhura të ligjshme nga pagat e tij, të blinte pasurinë e llojit “pyll”, në Malin Shëngjin, pasi nga kontrolli i rezultateve të hetimit dhe i vendimit të Komisionit rezultoi se ky i fundit nuk ka arritur në konkluzione lidhur me mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin me burime të ligjshme të pasurisë objekt kontrolli.
33. Në vijim të analizës, trupi gjykues vëren se gjatë arsyetimit lidhur me kontrollin e pasurisë “pyll”, me sipërfaqe 1000 m², në Malin Shëngjin, Lezhë, Komisioni ka konstatuar se *subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat mbi këtë pasuri, por nga verifikimi i deklaratës vetting nuk është plotësisht i qartë burimi i krijimit të kësaj pasurie*. Më tej, Komisioni ka arsyetuar se *rezulton se me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e saj, për të arritur në përfundimin se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me këtë pasuri, pasi nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për blerjen e saj*. Për sa më sipër, në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk ka qenë kontradiktor në arsyetim dhe në përfundimin e arritur në vendim, në vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli, pasi ka referuar si deklaram të saktë vetëm atë lidhur me të dhënat e pasurisë, por jo deklarimin për burimin e krijimit të saj.
34. Nga situata faktike e pasqyruar në paragrafin 30 më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të interesave të vitit 2008 nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë objekt kontrolli, në kundërshtim me kërkesat e formularit dhe ligjit nr. 9049/2003. Deklarimi i subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, *kjo shumë e marrë nga të ardhurat dhe, i cili duket i papërfunduar, është shpjeguar prej tij vetëm pas kërkesës së Komisionit në përgjigjen e përcjellë më datë 23.04.2020, e në vijim, megjithëse i është kaluar barra e provës për të njëjtën kërkesë, subjekti nuk ka dhënë deklarime lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie*. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se qëndron konkluzioni i Komisionit në vendim, se deklarimi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit *i të ardhurave, por jo burimit se nga vijnë, e bën deklarimin e subjektit të rivlerësimit të paplotë*. Në këtë kuptim, për pasurinë *pyll me sipërfaqe 1000 m²*

²⁵ *Ibid.*

në malin Shëngjin, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

35. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas të cilit, *ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka provuar se dhuratat e dhëna nga të afërmit e tij dhe të personit të lidhur, janë të ligjshme dhe të deklaruara në momentin e dhurimit*, trupi gjykues, nga verifikimi i deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhurime nga familjarët e tij në vlera monetare, si vijon.

*Në vitin 2005, dhuratë nga vëllai D. Q., datë 25.08.2005, në shumën 2.000 euro, pa dokument noterial. Dhuratë nga motra V. K., datë 05.09.2005, në shumën 1.500 euro, e vërtetuar në tërësi me deklaratë noteriale, datë 18.10.2012, me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol.*

Në vitin 2006, dhuratë nga motra V. K., në shumën 1.000 euro, pa dokument noterial.

Në vitin 2007, dhuratë nga dy motrat A. Q. P. dhe M. Q. P., prej 2.500 eurosh secila dhe vëllai emigrant K. P. Q. në shumën 3.000 euro, gjithsej në shumën 8.000 euro. Kursyer.

*Në vitin 2008, dhuratë nga motrat dhe vëllezërit emigrantë me rastin e martesës, në shumën 16.000 euro, kursyer 13.000 euro (D. Q. 5.000 euro; A. P. 4.000 euro; V. Q. 4.000 euro; M. Q. 3.000 euro), vërtetuar në tërësi me deklaratën noteriale, datë 18.10.2012, me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol.*

Në vitin 2009, dhurata të bëra me rastin e lindjes së vajzës 4.000 euro (nga vëllezërit dhe motrat e mia 2.500 euro. Prindërit dhe motra e bashkëshortes 1.500 euro).

Në vitin 2010, dhurata me rastin e ditëlindjes së vajzës 3.000 euro (D. Q., P. Q., A. P., M. P. Q. dhe V. K.). Kursyer dhe përdorur për pronetim apartamenti.

Në vitin 2011, dhurata me rastin e lindjes së vajzës 1.000 euro nga vëllai dhe motrat e mija P. Q., A. P. dhe V. K., si dhe 500 euro nga vëllai dhe motra e bashkëshortes. Kursyer.

Në të njëjtën deklaratë, personi i lidhur nuk ka deklaruar dhurime nga të afërmit, ndër vite.

36. Në analizë të këtij shkakun ankimi, në raport me konkluzionet e arritura nga Komisioni dhe situatën faktike të rezultuar nga hetimi administrativ, trupi gjykues vlerësoi si më poshtë.

36.1 Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka pretenduar se *ka provuar se dhuratat e dhëna nga të afërmit e tij dhe të personit të lidhur janë të deklaruara saktë në të gjitha deklaratat periodike, por sipas vlerësimit të Komisionit dhuratat e dhëna nga motrat A. P. dhe V. K. janë reflektuar në arsyetimin e vendimit si shumë e plotë pa përcaktuar sasinë e dhuratave të njohura.*

36.1.1 Komisioni, në vendim²⁶, ka arsyetuar se *Komisioni vëren se në deklaramin e disa dhurimeve në vite, subjekti ka deklaruar shumën e dhuruar në total nga disa familjarë, pa bërë evidentimin të pjesës përkatëse të dhuruar nga secili familjar më vete. Ky arsyetim është reflektuar më tej në konkluzionin e arritur se në analizën përfundimtare financiare do të reflektohen si të ardhura vetëm dhurimet e deklaruara nga motrat e subjektit, A. P., dhe V. K., për vitet ku janë përcaktuar qartë këta persona të tjerë të lidhur si dhurues dhe shuma përkatëse e deklaruar si e dhuruar.*

Në vendim, në aneksin 1, Komisioni ka paraqitur analizën financiare përmbledhëse, në të cilën rezulton të jenë reflektuar: në zërin “Të ardhura të dhuruara nga motra V. K.”, për vitin 2005, vlera 183.810 lekë; për vitin 2006, vlera 123.703 lekë; për vitin 2008, vlera 492.730 lekë; dhe në zërin “Të ardhura të dhuruara nga motra A. P.”, për vitin 2007, vlera 302.275 lekë; për vitin 2008, vlera 492.730 lekë.

²⁶ Paragrafët 81.3 dhe 81.4 të vendimit të Komisionit.

36.1.2 Në lidhje me këtë pretendim, nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave, trupi gjykues vëren se në rubrikat përkatëse të deklaratave të vitit 2009, 2010 dhe 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën totale të dhuruar nga të afërmit e tij me rastin e lindjes së vajzës dhe ditëlindjes së saj, pa evidentuar saktësisht shumat e dhuruara nga secili prej tyre. E njëjta mënyrë deklarimi vërehet edhe në deklaratën e rivlerësimit, për të njëjtat vite. Ndërsa, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka provuar nëpërmjet deklaratimeve të bëra prej të afërmit të tij se sa kanë qenë shumat e sakta të dhuruara prej tyre. Në lidhje me dhurimet e kryera nga znj. V. K., trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike të vitit 2005, 2006 e 2008 shumat konkrete të dhuruara prej saj, ndërsa në deklaratat e vitit 2009, 2010 e 2011 ka cituar emrin e saj ndër dhuruesit, por pa përcaktuar shumën konkrete të dhurimit të kryer prej saj. Në lidhje me dhurimet e kryera nga motra e tij A. P., konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike të vitit 2007 e 2008 shumat konkrete të dhuruara prej saj, ndërsa në deklaratat e vitit 2009 e 2010 ka cituar emrin e saj ndër dhuruesit, por pa përcaktuar shumën e saktë të dhuruar prej saj. Në kushtet kur Komisioni ka konsideruar në vendim²⁷ se *nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar dhe nga analiza e të ardhurave të evidentuara si të realizuara ndër vite nga shtetasit e sipërcituar, bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni vlerëson se ata kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar dhurimet e kryera, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore të pasurisë dhe subjekti i rivlerësimit, mungesat e evidentimit në deklaratat periodike të shumave të sakta të dhuruara nga motrat e tij, znj. A. P. dhe znj. V. K., i ka plotësuar me deklaratat e tyre gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues arrin në konkluzionin se Komisioni, në raport me të gjitha rrethanat e faktit të cituara më sipër, si dhe në përputhje me kriterin e vendosur nga neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, do të duhet të kishte konsideruar në analizën financiare përmbledhëse për periudhën 2003-2016, shumat e deklaruara nga motrat e subjektit të rivlerësimit nëpërmjet deklaratimeve të tyre edhe për vitet 2009, 2010 e 2011.*

36.2 Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se *për dhurimet e bëra nga vëllai z. P. (K.) Q., ai është në pamundësi për të paraqitur dokumentacion, për shkak se vëllai ka qenë emigrant i paligjshëm dhe dokumentacioni nuk mund të sigurohet zyrtarisht, por Komisioni ka anashkalluar deklaratën e bërë nga vëllai i tij, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim²⁸, ka konkluduar se lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave të familjarëve të tjerë, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, pasi nuk depozitoi dokumentacion justifikues ligjor për të provuar mundësinë e krijimit të të ardhurave të tyre, të pretenduara si burim për shumat e dhuruara në favor të tij dhe personit të lidhur. Komisioni vëren se prapësimet e subjektit janë kryesisht të karakterit deklarativ dhe nuk mbështeten në dokumentacionin ligjor provues.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi se në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.10.2012, z. P. (K.) Q. ka deklaruar vetëm shumat e dhuruara ndaj subjektit të rivlerësimit dhe kohën se kur ia ka dhuruar ato, por nuk ka deklaruar asnjë të dhënë në lidhje me burimin e krijimit të tyre dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të provuar krijimin e tyre, në përputhje me kërkesat e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë se vëllai i tij kishte siguruar të ardhura nga puna si emigrant, për të cilat të ishin paguar detyrimet tatimore dhe kontributet për sigurimet shoqërore, madje, në përgjigjet e pyetësorëve, në seancën dëgjimore dhe në ankim, e ka përjashtuar këtë mundësi, duke pohuar se nuk mund të provonte pagesën e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, pasi vëllai i tij kishte punuar si emigrant i paligjshëm. Konsiderimi i remitancave nga emigracioni

²⁷ Paragrafi 81.1 i vendimit të Komisionit.

²⁸ Paragrafi 81.2 i vendimit të Komisionit.

si të ardhura që nuk rrjedhin nga një burim i ligjshëm, nëse për to nuk arrihet të vërtetohet se janë paguar detyrimet tatimore, është një qëndrim i konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Kolegjit.

36.3 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se *për dhurimet e vëllait z. D. Q. dhe motrës znj. M. Q., ai ka ndërmarrë veprime dhe ka paraqitur akte se këta të fundit kanë pasur të ardhura dhe mundësi financiare për të bërë dhurimet, por koha e dhënë nga Komisioni ka qenë shumë e shkurtër, në cenim të nenit 10 të Kodit të Procedurave Administrative, duke cenuar të drejtat e tij për një proces të rregullt ligjor, për mosdhënien e ndihmës administrative për të paraqitur provat në formën e kërkuar, trupi gjykues vëren fillimisht se referuar parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar, barrën e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të rezultuara nga hetimi i kryer nga Komisioni e ka subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, mosangazhimi i Komisionit në komunikim të drejtpërdrejtë me institucionet italiane për të kërkuar të dhëna në lidhje punësimin dhe të ardhurat e realizuara nga motra dhe vëllai i tij, nuk mund të përbëjë justifikim për mospërmbushje të barrës së provës në drejtim të gjetjeve të Komisionit dhe, për rrjedhojë, as shkak për kundërshtimin si të padrejtë të konkluzionit të arritur nga ana e këtij të fundit. Për më tepër, trupi gjykues konstatoi se në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit nuk ka kërkuar kohë shtesë për paraqitjen e dokumentacionit të pretenduar në ankim.*

36.3.1 Në prapësimet e paraqitura para seancës dëgjimore publike, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratimet nga të afërmit e tij, të dërguara prej tyre nëpërmjet postës elektronike, nga të cilat, trupi gjykues konstatoi si në vijim.

(i) Z. D. Q. ka deklaruar se në periudhën 2005-2008 ka qenë i punësuar pa dokumente sipërmarrës ndërtimi, pasi ishte e vështirë gjetja e punëve me letra dhe siguracion. Në këtë deklaratë, vëllai i subjektit ka evidentuar se ka dërguar raportin e të ardhurave, duke mos deklaruar pamundësi apo nevojë për më tepër kohë për gjetje të ndonjë dokumentacioni shtesë. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentin me titull “Raport për kontratën e energjisë elektrike për, z. D. Q.”, në të cilin pasqyrohen të ardhurat e përfituara prej tij për periudhën 2003-2019, të përkthyer nga gjuha italiane, me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 15.06.2020. Nga të dhënat e pasqyruara në këtë dokument, trupi gjykues nuk arriti të evidentonte se cili është institucioni që e ka lëshuar raportin dhe nëse janë paguar apo jo detyrimet tatimore për të ardhurat e referuara në të për z. D. Q.

(ii) Znj. M. P. ka deklaruar se është rezidente në Itali dhe se ka dërguar raportin e të ardhurave, duke mos deklaruar ndonjë pamundësi apo nevojë për më tepër kohë për gjetje të ndonjë dokumentacion shtesë. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentin me titull “Raport për kontratën e energjisë elektrike për z. F. P.”, në të cilin pasqyrohen të ardhurat e përfituara prej këtij të fundit për periudhën 2003-2010 dhe periudhën 2018-2019, të përkthyer nga gjuha italiane, me vërtetim përkthimi nr. 3758 rep., datë 15.06.2020. Nga të dhënat e pasqyruara në këtë dokument, trupi gjykues nuk arriti të evidentonte se cili është institucioni që e ka lëshuar raportin dhe nëse janë paguar apo jo detyrimet tatimore për të ardhurat e referuara në të për z. F. P..

Edhe në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk ka kërkuar kohë shtesë për të paraqitur dokumentacion në lidhje me të ardhurat e të afërmeve të tij apo të evidentonte se cili ishte dokumentacioni i pritshëm prej tij në funksion të vërtetimit të të ardhurave të ligjshme të përfituara prej tyre. Edhe në ankimin e paraqitur në Kolegji, subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur asnjë argument dhe nuk ka paraqitur asnjë provë, të cilën jo për faj të tij nuk kishte pasur mundësi ta paraqiste në Komision, në drejtim të sa më sipër pretenduar për vendimmarrje të padrejtë të Komisionit.

Për sa më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të provuar mundësinë e krijimit të të ardhurave të të afërmeve të tij, konkretisht z. D. Q, z. P. Q. dhe znj. M. P., të pretenduara si burim krijimi për shumat e dhuruara në favor të tij, duke mos përmbushur kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

36.3.2 Për sa i përket dhurimeve të kryera nga të afërmit e personit të lidhur, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar ato në deklaratat periodike të interesave, përkatësisht: në vitin 2009 - dhuruar prindërit, vëllai dhe motra e bashkëshortes shumë 1.500 euro; në vitin 2010 - dhuruar vëllai dhe motra e bashkëshortes shumë 1.000 euro; në vitin 2011 - dhuruar vëllai dhe motra e bashkëshortes shumë 500 euro; në total shuma e dhuruar prej 3.000 eurosh. Të njëjtin deklaram, subjekti i rivlerësimit ka bërë edhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.10.2012, z. A. (E.) P. nuk ka konfirmuar dhurimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si më sipërcituar. Po ashtu, edhe znj. M. P. dhe znj. D. L., në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2017, nuk kanë konfirmuar të kenë dhuruar shumat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit, megjithëse është pyetur nga Komisioni, nuk ka detajuar shumat e dhuruara nga secili prej të afërmeve të bashkëshortes së tij. Në këto kushte, në mungesë të konfirmimit prej të afërmeve të veprimit të dhurimit, si dhe të shumave të dhuruara nga secili prej tyre, në përmbushje të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi se gjendet në pamundësi për të verifikuar nëse ato janë krijuar nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke gjetur të drejtë konkluzionin e Komisionit se këto shuma nuk duhen konsideruar të krijuara nga burime të ligjshme, për rrjedhojë këto shuma nuk duhen konsideruar si të tilla as në analizën financiare përmbledhëse për periudhën e rivlerësimit 2003-2016.

36.4 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *Komisioni nuk i ka njohur provat e paraqitura prej tij, pa u shprehur mbi rëndësinë e tyre*. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se pikat 3, 4 dhe 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 49 e 50 të ligjit nr. 84/2016, janë shprehur qartë në lidhje me kompetencën e organeve të rivlerësimit për të mbledhur çdo informacion të nevojshëm e të dobishëm, në drejtim të përcaktimit të gjendjes së fakteve dhe rrethanave, që kanë lidhje me kontrollin dhe verifikimin e deklaratave të subjektit për efekt të procesit të rivlerësimit. Kjo kompetencë ushtrohet deri në momentin që Komisioni, sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se provat kanë arritur nivelin e provueshmërisë. Në këtë moment të rëndësishëm procedural, Komisioni vendos mbylljen e hetimit administrativ dhe i kalon subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën. Në procesin e rivlerësimit, barra e provës është e zhvendosur te subjekti i rivlerësimit, pra, i përket këtij të fundit detyrimi për të provuar pretendimet e tij duke paraqitur prova e fakte të nevojshme për këtë qëllim. Në këtë zbatim të këtij detyrimi, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prova edhe në seancën dëgjimore publike në Komision, prova të cilat janë administruar nga Komisioni dhe janë vlerësuar prej tij. Vlerësimi i tyre jo në favor të subjektit të rivlerësimit, nuk mund të shërbejë si argument për të mbështetur shkakun e ankimit.

36.5 Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit *i kërkon Kolegjit të verifikojë provat e paraqitura prej tij, duke i kërkuar shtetit italian konfirmimin zyrtar dhe të disponojë me pranimin e tyre, duke i vlerësuar dhe reflektuar ndryshimet përkatëse*, trupi gjykues e gjeti të pabazuar, duke vlerësuar se përtej parimit të sanksionuar në nenin Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës se në procesin e rivlerësimit, barra e provës për të provuar pretendimet e veta i përket subjektit të rivlerësimit, në rrëzimin e pretendimit konkret të subjektit, renditet

edhe fakti se në deklaratimet e tyre, të afërmit e tij, znj. M. P. dhe z. D. Q, kanë deklaruar se i kanë përcjellë subjektin raportet për kontratën e energjisë elektrike për z. D. Q dhe z. F. P. [të pasqyruara dhe analizuar më sipër në këtë vendim], të cilët janë gjetur se nuk provojnë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në drejtim të ligjshmërisë së krijimit të të ardhurave të tyre, në kuptim të parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit dhe në seancë dëgjimore publike, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë pretendim mbi pamundësinë e tij për të gjetur dokumentacion në lidhje me të ardhurat e të afërmit të tij, por në të kundërt ka paraqitur deklaratat e tyre, në të cilat konfirmojnë dërgimin e dokumentacionit. Subjekti i rivlerësimit edhe në ankimin e paraqitur në Kolegj, nuk ka ngritur asnjë argument dhe nuk ka paraqitur asnjë provë, të cilën, jo për faj të tij, nuk kishte pasur mundësi ta paraqiste në Komision, në drejtim të sa më sipër pretenduar për konkluzion të padrejtë të Komisionit, në vlerësimin e të ardhurave të të afërmit të tij.

37. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas të cilit *konkluzionet e Komisionit për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 107,16 m², në Tiranë, nuk janë të mbështetura në prova dhe janë të paarsyetuara dhe se Komisioni në vendim ka treguar njëanshmëri dhe paragjykim në vlerësimin e provave dhe në marrjen e vendimit*, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

37.1 Komisioni, në vendim, në përfundim të kontrollit të kësaj pasurie, ka arsyetuar se *bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë me qëllim evidentimin e mundësisë për kryerjen e pagesës prej 40.000 euro, në datën 11.03.2020, paguar si çmim për blerjen e apartamentit në pronësi të subjektit. Për sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e pasurisë së llojit “apartament”, prenotuar dhe paguar në vitin 2010.*

37.2 Me anë të kontratës, datë 11.03.2010, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, apartamentin 2+1, me sipërfaqe 107,16 m², në Tiranë, për çmimin 40.000 euro. Likuidimi tërësisht të shitblerjes së pasurisë në fjalë është realizuar nga subjekti i rivlerësimit me kalimin e shumës 40.000 euro në llogarinë e shoqërisë, pranë Intesa Sanpaolo Bank, në datën 11.03.2010²⁹.

37.3 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se burimi i krijimit të kësaj pasurie janë *kursimet nga të ardhurat në vite, të deklaruara sipas ligjit.*

37.4 Në deklaratën e interesave të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *pagesë për pronotim shtëpie, mbledhur nga paratë e kursyera gjatë viteve të punës (shpenzime). Vlera: 40.000 euro. Pjesa takuese: 100%.*

37.5 Në shpjegimet e dhëna pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, lidhur me verifikimin e mundësisë së krijimit me burime të ligjshme financiare të pasurisë objekt kontrolli, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një analizë financiare për periudhën 01.01.2010 - 11.03.2010, sipas së cilës ai rezulton me balanca pozitive në vlerën 79.695 lekë, duke shpjeguar se në këtë analizë financiare [...] janë marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara nga motrat dhe vëllezërit, të cilat në fund të vitit 2009 i kam deklaruar se kisha gjendje shumën 21.000 euro ose të konvertuar me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë 2.915.010 lekë, të cilat i kam përdorur për blerjen e apartamentit. Bazuar në deklaratimet në ILDKPKI-së në vitet 2007, 2008 dhe 2009 kam deklaruar gjendjet cash të krijuara nga kursimet e të ardhurave nga pagat,

²⁹ ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.02.2019, ka informuar Komisionin se sipas kartelës së pasurisë, në emër të subjektit të rivlerësimit figuron e regjistruar pasuria me nr. {***}, vol. {**}, f. {***}, ZK {***}, “apartament”, me sipërfaqe 95,3 m², me datë regjistrimi 17.12.2018.

nga të cilat gjendja cash në fund të vitit 2009 ka qenë 1.244.664 lekë. Në Raiffeisen Bank në vitin 2009 kam pasur të vendosur depozitë me afat shumë 1.050.000 lekë, të cilat janë tërhequr në vitin 2010.

38. Në analizë të këtij shkaku ankimi, në raport me konkluzionet e Komisionit dhe rrethanat faktike të pasqyruara më sipër, trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në ankim, se Komisioni ka treguar njëanshmëri dhe paragjykim në vlerësimin e provave, të shprehura që në hetimin administrativ, duke ndryshuar zërin kadastral dhe llogaritur pronën sikur ndodhej në bllok e duke mos marrë parasysh blerjen e saj që në themele, si dhe duke ngritur hipoteza edhe për trajtim preferencial, janë përsëritje e shpjegimeve të dhëna në Komision, në kundërshtim të rezultateve të hetimit dhe, për rrjedhojë, u referohen gjetjeve paraprake të hetimit administrativ, gjetje këto të cilat Komisioni nuk i ka trajtuar dhe as arsyetuar në vendim dhe, për pasojë, as nuk ka konkluduar në disfavor të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim nuk është relevant në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli.
39. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se në analizën financiare për vlerësimin e kësaj pasurie, Komisioni duhet të merrte në konsideratë dhuratat nga motrat dhe vëllezërit, të cilat në fund të vitit 2009 janë deklaruar prej tij se i kishte gjendje në shumë totale prej 21.000 eurosh, si dhe të ardhurat e përfituara nga tërheqja në vitin 2010 të depozitës me afat në Raiffeisen Bank, në shumë 1.050.000 lekë, nga rezulton se kishte mundësi të krijonte, me burime të ligjshme, pasurinë apartament me sipërfaqe 107,16 m², në Tiranë, trupi gjykues, duke analizuar secilin prej burimeve financiare të pretenduara, të krijimit të pasurisë objekt kontrolli, vëren si vijon.

39.1 Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga dhurimet e kryera në vite nga të afërmit e subjektit të rivlerësimit, Komisioni, ndonëse në vendim, ka arsyetuar se do të duhej të konsideroheshin si të ardhura vetëm dhurimet e deklaruara se janë kryer nga motrat e subjektit, znj. A. P. dhe znj. V. K., në analizën financiare për pasurinë objekt kontrolli të pasqyruar në vendim, nuk është reflektuar ky konkluzion³⁰. Në total, dhurimet e kryera në vitet 2007, 2008 dhe 2009, nga dy motrat e subjektit të rivlerësimit, janë në vlerën 13.000 euro, shumë për të cilën, trupi gjykues vlerëson se duhet të ishte konsideruar nga Komisioni në analizën financiare për këtë pasuri, në formën e likuiditeteve në *cash*, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, pas çdo deklarimi të bërë për to në deklaratimet periodike të interesave, ka cilësuar “*të kursyera*”. Në favor të këtij vlerësimi shërbeu dhe konstatimi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte krijuar pasuri të tjera përpara datës së kryerjes së pagesës për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 107,16 m², në Tiranë. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në fund të vitit 2009 ka pasur të disponueshme shumë prej 21.000 euro si gjendje në *cash* në fund të vitit 2009, nga dhurimet e familjarëve, duke përfshirë në të edhe dhurimet e deklaruara nga znj. M. P. e z. D. Q e z. P. Q., të cilat, sipas analizës dhe arsyesimit të bërë më sipër në këtë vendim, nuk u vlerësuan nga trupi gjykues si të krijuara me burime të ligjshme financiare, për rrjedhojë nuk mund të konsiderohen në analizën financiare për verifikimin e pasurisë objekt kontrolli.

39.2 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se si burim krijimi për pasurinë apartament me sipërfaqe 107,16 m², në Tiranë, kanë shërbyer dhe të ardhurat e përfituara nga tërheqja në vitin 2010 të depozitës me afat në Raiffeisen Bank, në shumë 1.050.000 lekë, trupi

³⁰ Në paragrafin 84.1 i vendimit Komisioni ka shpjeguar: [...] krahas kursimeve të tij nga paga, subjekti pretendon se si burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer edhe të ardhurat e kursyera nga dhurimet e familjarëve të tij ndër vite, për të cilat u arrit në përfundimin se pjesa që përfaqëson vlerën më të madhe të tyre nuk justifikohen me burime financiare të ligjshme. Për më tepër, vërehet se subjekti vetëm një pjesë të këtyre dhurimeve i ka deklaruar si kursime.

gjykues vëren se Komisioni, në vendim, ka arsyetuar se [...] Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie, konstatohet se deri në datën 11.03.2010, evidentuar si datë e kryerjes së pagesës për likuidimin e çmimit për pasurinë objekt vlerësimi, nuk janë kryer tërheqje nga këto shuma të investuara në depozita. Për rrjedhojë, Komisioni arrin në përfundimin se nuk qëndrojnë pretendimet e subjektit se shumat e investuara në llogari depozitë gjatë vitit 2009 të kenë shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit në Tiranë.

Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në kundërshtim të konkluzionit të sipërcituar të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ai ka deklaruar: “Në vitin 2010 tërhequr depozita në vlerën 2.400 euro dhe interesat 38.45 euro, shumë e cila është përdorur për blerjen e apartamentit. Në vitin 2010 është bërë tërheqja e një pjese të depozitës së vitit 2009 në shumën 758.000 lekë dhe interesa në shumën 36.310,04 lekë, ndërkohë në llogari është lënë shuma prej 300.000 lekë. Kjo shumë është tërhequr për të likuiduar detyrimet e prenotimit të apartamentit.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, subjekti ka deklaruar depozituar në bankë disa para nga të ardhurat e rrogës sime, sipas numrit të llogarisë {***}, të kursyera nga viti 2008 -2009, vlera 1.050.000 lekë.

Sipas dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ nga Raiffeisen Bank, në llogarinë bankare nr. {***}, në emër të tij, në vitin 2009, subjekti i rivlerësimit ka kryer depozitimet, si vijon: (i) në datën 04.06.2009, në vlerën prej 500.000 lekësh; (ii) në datën 04.11.2009, në vlerën prej 400.000 lekësh; dhe (iii) në datën 11.11.2009, në vlerën prej 158.000 lekësh.

Tërheqja e parë e shumave nga kjo depozitë është kryer nga subjekti i rivlerësimit në datën 12.03.2010, në vlerën 404.500 lekë, ndërsa shumat e tjera janë tërhequr në data të mëvonshme.

39.2.1 Në kushtet kur, sipas të dhënave të mandatit bankar të Intesa Sanpaolo Bank, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në *cash* shumën 40.000 euro, me përshkrimin “Shlyerje detyrimi për blerje apartamenti”, në datën 11.03.2010, trupi gjykues vlerësoi se situata faktike, e përshkruar më lart, evidenton bindshëm faktin se e ardhura e siguruar nga tërheqjet e parave të depozituara në llogarinë bankare në Raiffeisen Bank nuk kanë shërbyer si një burim për financimin e pagesës së apartamentit me sipërfaqe 107, 16 m², në Tiranë, ashtu sikurse deklaroi subjekti në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, meqenëse ato rezultojnë të jenë tërhequr dhe zotëruar efektivisht prej tij pas shlyerjes së çmimit të blerjes për këtë pasuri.

Në përfundim, në kontroll të analizës së kryer në Komision, duke reflektuar konkluzionet e mësipërme, lidhur me secilin prej burimeve financiare të deklaruara për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues konkludoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pagimin e shumës prej 40.000 eurosh, si çmim i blerjes së pasurisë, në kohën e kryerjes së kësaj pagese, në datën 11.03.2010, në shumën 2.132.216 lekë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

40. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas të cilit, konkluzionet e Komisionit për gjendjen e likuiditeteve *cash* në datën 29.01.2017, nuk janë të mbështetura në prova dhe janë të paarsyetuara dhe se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit janë paragjykuar e janë transformuar faktet në mënyrë diskriminuese, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim³¹, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar disponimin e gjendjes *cash* në shumën prej 1.400.000 lekësh në datën 29.01.2017.

³¹ Paragrafi 87.3 i vendimit të Komisionit.

41. Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstatoi si vijon.

41.1 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar *gjendja faktike e të ardhurave të mia më datë 29.01.2017 është 1.400.000 lekë, të cilat janë në administrim.*

Ndërsa, bashkëshortja e tij ka deklaruar *nuk kam gjendje faktike të të ardhurave të mia personale.*

41.2 Nga analizimi i deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se në lidhje me pasurinë objekt kontrolli “gjendje e likuiditeteve në *cash*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, në rubrikën “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, si vijon.

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011: *Nga paga e marrë në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga data 01.01.2011- 31.12.2011 është kursyer shuma 600.000 lekë (shumë që i përket pasurisë së përbashkët bashkëshortore). Nga paga e bashkëshortes nga data 01.01.2011- 31.12.2011 është kursyer shuma 200.000 lekë (shumë që i përket pasurisë së përbashkët bashkëshortore).*

Dhurata e marra nga njerëzit e afërt të mi dhe bashkëshortes në shumën 1.500 euro, janë kursyer (shumë që i përket pasurisë së përbashkët bashkëshortore).

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012: *Paga e marrë në Inspektoratin e KLD-së nga data 01.01.2012 deri në 31.12.2012, është kursyer 550.000 lekë (shumë që i përket pasurisë së përbashkët bashkëshortore). Nga paga e bashkëshortes nga data 01.01.2012 deri më 31.12.2012 është kursyer shuma 100.000 lekë (shumë që i përket pasurisë së përbashkët bashkëshortore), të cilat i shtohen kursimeve të vitit 2011.*

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013: *Të ardhurat nga paga në Inspektoratin e KLD-së për vitin 2013, kursyer shuma 200.000 lekë, të cilat u shtohen kursimeve në vite. Nga paga e bashkëshortes nga data 01.01.2013- 16.09.2013 është kursyer shuma 100.000 lekë (shumë që i përket pasurisë së përbashkët bashkëshortore), të cilat u shtohen kursimeve në vite.*

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014: *Kursyer nga të ardhurat e pagës në shumën 500.000 lekë, të cilat u shtohen kursimeve në vite. Dhuratë 100 euro E. ose A. P., vëllai i bashkëshortes. Kursyer.*

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015: *Kursyer nga të ardhurat e pagës sime në shumën 500.000 lekë, të cilat u shtohen kursimeve në vite.*

Në rubrikën “Dhurata dhe trajtime preferenciale”: *Dhuratë 300 euro E. ose A. P., me rastin e lindjes së djalit L.. 300 euro kursyer, shtuar kursimeve. Dhuratë 400 dollarë. P. Q., vëllai im, me rastin e lindjes së djalit L.. 400 dollarë kursyer, shtuar kursimeve.*

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016: *Kursyer nga të ardhurat e pagës sime për vitin 2016 në shumën 500.000 lekë, të cilat u shtohen kursimeve në vite. Kursyer nga të ardhurat e pagës së bashkëshortes për vitin 2016 shuma 100.000 lekë, të cilat u shtohen kursimeve në vite. Pakësuar shuma 700.000 lekë nga të ardhurat familjare, të kursyera pas vitit 2011, të cilat i janë dhënë bashkëshortes për prenotim apartamenti personal.*

Më datë 06.05.2016 dhënë hua vëllait tim P. Q. me kontratë huapërdorje, shuma 1.700.000 lekë, pa interes, për nevojat e tij personale, shumë kjo e cila pakësohet nga të ardhurat e kursyera pas vitit 2011.

42. Në analizë të shkakut të ankimit, në raport me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave, trupi gjykues vëren se ecuria e kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit do të analizohet nga viti 2011 e në vazhdim deri në datën e deklaratimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, datë 29.01.2017, pasi kursimet e akumuluar deri në datën 11.03.2010, janë përdorur nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 107,16 m², në Tiranë, ashtu siç është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2010 dhe gjatë

hetimit administrativ në Komision dhe siç është pranuar prej tij në parashtrimet e paraqitura në Kolegj se gjendja e kursimeve në *cash* në fund të vitit 2010 është zero lekë.

Në përfundim të analizës së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se gjendja e kursimeve në *cash* të deklaruar prej tij në vite, përbëhet nga kursimet nga pagat dhe kursimet nga shumat e dhuruara nga të afërmit e tij në vite. Në vijim të konkluzionit të arritur më sipër, në këtë vendim, në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të të afërmeve të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për shumat e dhuruara atij, trupi gjykues konkludoi se subjekti i rivlerësimit dispononte kursime në likuiditete *cash* në fillim të vitit 2017 shumën 950.000 lekë nga pagat dhe vlerën 500 euro ose 67.635 lekë nga dhurata e motrës, znj. A. P. të bërë në vitin 2011; në total shumën 1.017.635 lekë nga 1.400.000 lekë të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se konkluzioni i Komisionit për gjendjen e likuiditeteve *cash* në datën 29.01.2017, është i paarsyetuar, nga verifikimi i vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se ky i fundit ka analizuar, madje edhe në mënyrë tabelare, ecurinë e gjendjes së kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit nga viti 2007 e deri në vitin 2016, referuar deklarimeve të tij dhe personit të lidhur të bëra në deklaratat periodike vjetore, si dhe referuar deklarimeve sipas procesverbaleve të mbajtura gjatë kontrolleve të kryera nga ILDKPKI-ja në vite, si dhe deklarimeve gjatë hetimit administrativ të kryer në Komision.

43. Sa më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kursimeve në *cash* të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
44. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, personi i lidhur, znj. K. Q. (P.), ka deklaruar të ardhura totale në shumën prej 80.000 eurosh të krijuara para martese. Komisioni, në vendim, ka analizuar burimin e krijimit të shumës së mësipërme, në secilin prej elementëve përbërës të saj, sipas deklaramit të personit të lidhur, duke arritur në konkluzione të cilat janë kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit në ankim, si më poshtë.
45. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas të cilit *Komisioni nuk ka pasqyruar drejt situatën faktike dhe nuk ka bërë vlerësim të drejtë të provave lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga punësimi në shoqërinë “{***}” ShPK*, trupi gjykues konstatoi si vijon. Komisioni, në vendim, ka arsyetuar se [...] nga analiza e të gjitha provave të administruara në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të dokumentuar marrëdhënien e punësimit të personit të lidhur dhe të ardhura të mundshme të përfituara në shoqërinë “{***}” ShPK. Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur kanë kryer deklaramit të pamjaftueshëm për të ardhurat e pretenduara nga punësimi në shoqërinë “{***}” ShPK.
46. Në kundërshtim të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka parashtruar se konkluzionet e Komisionit duhet të ndryshohen nga Kolegji si jo të drejta. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit u shqyrtuan në raport me faktet e rrethanat e rezultuara nga aktet e hetimit të kryer nga Komisioni dhe në përfundim, trupi gjykues vlerësoi si më poshtë.
47. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni, qëllimisht, nuk i ka dhënë rëndësinë që i jep ligji, provave shkresore të paraqitura, të cilat janë gjetur pranë subjektit privat pas këmbënguljes e përpjekjes së tij dhe provojnë marrëdhënien e punësimit të personit të lidhur në subjektin tregtar Gj. P., për periudhën 2000-2004, si dhe pagën e përfituar prej saj në vlerën 60.000 lekë në muaj, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, ka arsyetuar: *Në dritën e këtyre fakteve duket se dokumenti “kontratë individuale pune” e datës 29.09.2000 lidhur ndërmjet znj. P. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, depozituar nga subjekti si provë e re me*

dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, nuk ka ekzistuar më parë dhe se Komisioni ngre dyshime të arsyeshme se ky dokument është krijuar së fundmi dhe, si i tillë, nuk mund të marrë vlerën e provës në kuptim të nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile. Në të kundërt, ky dokument do të depozitohet si dokumentacion provues gjatë hetimit administrativ të kryer nga ILDKPKI-ja, hetimit penal të zhvilluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si edhe si dokumentacion shoqëruar i deklaratës së rivlerësimit kalimtar.

47.1 Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, nga hetimi administrativ i zhvilluar nga Komisioni, konstatohet se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, lidhur me periudhën e punësimit gjatë kohës së kryerjes së studimeve të larta, 2000-2004, nuk ka detajuar se sa ka qenë shuma e të ardhurave të përfituara nga punësimi dhe nuk ka pasqyruar të dhëna lidhur me punëdhënësin pranë të cilit ka qenë e punësuar në periudhën e pretenduar. Këto të dhëna gjenden në deklaratën periodike të interesave të vitit 2008, e cila përkon me deklarinimin e saj të parë në ILDKPKI, në të cilin ka deklaruar: *Pasuri të luajtshme, paga e fituar gjatë vitit 2000-2004, duke kryer punë part-time pas orarit të shkollës si shitëse në një dyqan. [...] 2000-2004 shitëse pa dokumente të firma “{***}” Shkodër. Shuma e të ardhurave: 35.000 lekë.*

Ky version i deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike dhe në deklaratën e rivlerësimit, nën përgjegjësitë që prodhon ky deklarinim, në të cilin marrëdhënia e punësimit përshkruhet si një marrëdhënie e krijuar pa dokumente çka nënkupton mosdokumentimin e të drejtave dhe detyrimeve të prodhuara prej saj, është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision³², duke shpjeguar se të ardhurat nga paga e personit të lidhur për vitet 2000-2004 nga puna e kryer *part-time* pranë shoqërisë “{***}” ShPK, me pagë mujore 60.000 lekë, janë total 2.820.000 lekë. Në përgjigje të kërkesave të drejtuara nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument në drejtim të provueshmërisë së ekzistencës së marrëdhënies së pretenduar të punësimit të personit të lidhur pranë shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe të ardhurave të krijuara prej saj. Edhe në vërtetimin e datës 15.01.2020, lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK, me NIPT {***}, nënshkruar nga administratori Gj. P., nuk jepen të dhëna për ekzistencën e një kontrate pune mes kësaj shoqërie dhe znj. P..

Në deklarinimet, në cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme për qëllim hetimi, dhënë në datën 26.05.2014 para prokurorit³³, znj. K. Q., sipas procesverbalit përkatës³⁴, ndër të tjera, për punësimin e saj në shoqërinë “{***}” ShPK ka deklaruar se *gjatë punës sime pranë këtij biznesi, unë nuk kam mbajtur dokumente, pasi kemi rënë dakord para se të filloja punë aty. Mbajtja e dokumenteve nuk më ka interesuar dhe se marrëveshja e punës me pronarin e biznesit ka qenë e këtillë. Ai më ka thënë se nuk të përfshi në rregulla të siguracionit me qëllim për të më paguar pagë më të lartë.*

Ekzistenca e Kontratës Individuale të Punës, nr. {***} prot., datë 29.09.2000, e lidhur mes administratorit të shoqërisë “{***}” SHPK, në cilësinë e punëdhënësit dhe znj. K. P., në cilësinë e punëmarrësit, evidentohet dhe paraqitet si dokumentacion nga subjekti i rivlerësimit, vetëm pas marrjes së rezultateve të hetimit administrativ. Kontrata e punës datë 29.09.2000, me afat katërvjeçar deri në datën 30.08.2004, për pozicionin asistent shitës-specialist i shitjes së artikujve të ndryshëm, me pagë 60.000 lekë në muaj, është nënshkruar nga znj. K. P.. Ky

³² Në përgjigjen e përcjellë më datë 03.03.2020, mbi pyetësin e drejtuar nga Komisioni.

³³ Deklarime të dhëna në funksion të procedimit penal të regjistruar ndaj bashkëshortit të saj nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprën penale “Refuzim për deklarinim, mosdeklarinim, fshehje ose deklarinim i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin për deklarinim”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal.

³⁴ Procesverbal “Për marrjen e të dhënave nga personi që tregon rrethana të dobishme për qëllim hetimi”, datë 26.05.2014, i përcjellë në Komision si pjesë e dosjes së procedimit penal nr. {***}, viti 2014”, nga Prokurori i Përgjithshëm, me shkresë nr. {***} prot., datë 19.07.2019.

fakt vjen në kundërshtim me deklaratimet e saj të mëparshme, në formularët e deklaramit të pasurisë të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, si dhe me deklaratimet e saj në organin e procedimit penal, se ka punuar *pa dokumente* dhe se kjo mënyrë e zhvillimit të marrëdhënies së punës ka qenë *në marrëveshje me pronarin e biznesit* ku ajo punonte.

Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se veprimet e Komisionit kanë qenë paragjyquese, pasi në konkluzionin se ka pasur deklarime kontradiktore të subjektit gjatë procesit, duke i lidhur ato me deklaramin e dhënë në prokurori më datë 26.05.2014, është ndalur në fjalë të caktuara pa e lidhur me përmbajtjen kryesore të akteve. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit në raport me situatën faktike të analizuar më sipër, trupi gjykues vëren se konkluzionet e Komisionit janë të drejta, pasi qëndrimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur vetëm pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me ekzistencën e një kontratë pune të lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, janë kontradiktore me deklaramet e saj në deklaratën periodike e atë të rivlerësimit sipas të cilave ka punuar *pa dokumente*. Për më tepër, qëndrimet pas rezultateve të hetimit vijnë në kundërshtim edhe deklaramet nën përgjegjësi të personit të lidhur, para organit hetimor se marrëdhënia e punës së saj në shoqërinë “{***}” ShPK ka qenë e padokumentuar. Duke qenë se ndaj subjektit të rivlerësimit ka pasur një kallëzim dhe procedim penal në vitin 2014, personi i lidhur, logjikisht, do të duhet të kishte paraqitur kontratën e punës në kuadër të deklarameve të saj gjatë hetimit penal, me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të pretenduara si të fituara nga puna e saj dhe, për rrjedhojë, mos marrjen në përgjegjësi penale të subjektit të rivlerësimit. Në saje të këtyre rrethanave, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit as në ankim nuk arriti të provojë të kundërtën e dyshimeve të arsyeshme të ngritura nga Komisioni se dokumenti kontratë pune e datës 29.09.2000 nuk ka ekzistuar më parë, por është krijuar së fundmi, për efekt të ndryshimit të gjetjeve të hetimit administrativ. Trupi gjykues vlerësoi të mbajë në konsideratë këtë përfundim, në vlerësimin tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

47.2 Trupi gjykues i konstatoi si kontradiktore edhe qëndrimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me masën e të ardhurave të pretenduara të përfituara nga marrëdhënia e punësimit të bashkëshortes në shoqërinë në fjalë, pasi: në deklaratën e interesave të vitit 2008, ajo ka deklaruar se ka përfiturar të ardhura në masën 35.000 lekë/muaj; në deklaramin e bërë në ILDKPKI në datën 17.10.2012 ka deklaruar se ka punuar në Shkodër me një pagë prej 35.000 lekë/muaj; në deklaratën e rivlerësimit nuk deklarohet paga e përfiturar, ndërsa gjatë hetimit administrativ në Komision e ardhura e pretenduar deklarohet në 60.000 lekë/muaj. Administratori i shoqërisë “{***}” SHPK, z. Gj. P., në vërtetimin e datës 15.01.2020 lëshuar për efekt të procesit të rivlerësimit, pasi ka konfirmuar marrëdhënien e punësimit me znj. K. P. ka sqaruar se *e ka deklaruar në tatime me dokumentacionin përkatës, por i është thënë se është me kohë të pjesshme dhe nuk përbën problem*. Në vlerësimin e trupit gjykues ky deklarim i punëdhënësit, për të justifikuar mospërmbushjen e detyrimit ligjor për të paguar detyrimet tatimore mbi pagën e punëmarrëses znj. P. (Q.), nuk është i besueshëm, pasi sipas parashikimeve të nenit 14, paragrafi i dytë i Kodit të Punës *punëmarrësi me kohë pune të pjesshme gëzon të njëjtat të drejta, përpjesëtimisht si punëmarrësi me kohë të plotë pune*, ndërsa, referuar informacionit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër përcjellë në Komision³⁵, nuk disponohen të dhëna për pagesën e tatimit në burim nga subjekti “{***}” ShPK, për znj. K. P..

47.3 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se detyrimi për pagimin e tatimeve, sipas legjislacionit të kohës, ka qenë i punëdhënësit, ndërsa deklaramet e personit të lidhur janë shtrembëruar qëllimisht nga Komisioni, pasi ajo është shprehur për marrëveshje për pagën e lartë me qëllim që të mos përfshihet në rregullat e siguracionit të jetës në punë, pasi Shkodra

³⁵ Me shkresën nr. {***} prot., datë 02.03.2020.

nuk ka pasur siguri dhe sigurimi i jetës ka qenë i domosdoshëm. Në analizë të këtij pretendimi, në konsideratë të jurisprudencës së konsoliduar së Kolegjit, referuar deklaramit të personit të lidhur në deklaratën periodike të vitit 2008 e në atë të rivlerësimit se ka punuar pa dokumente, si dhe deklaramit të saj nën përgjegjësi përpara organit hetimor, trupi gjykues krijoi bindjen se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka qenë në kushtet e keqbesimit, sa i përket pagesës së detyrimeve që rridhnin nga marrëdhënia e pretenduar e punës, pasi ajo vetë kishte dakordësuar shmangien nga pagimi i detyrimi tatimore nga punëdhënësi, me qëllim përfitimin e një page më të lartë. Në këtë kuadër, trupi gjykues çmoi tërësisht të pabesueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit se personi i lidhur është shprehur për marrëveshje për pagën e lartë me qëllim që të mos përfshihet në rregullat e siguracionit të jetës në punë, në kushtet kur rezultoi tërësisht e provuar se punëdhënësi nuk kishte paguar kontributet e sigurimit të detyrueshëm shoqëror e shëndetësor, detyrime të rrjedhura nga legjislacioni në fuqi për marrëdhëniet e punës³⁶ e, aq më tepër, në kushtet kur sigurimi i jetës edhe nëse do të paguhej nga punëdhënësi nuk mund të ndikonte në masën e pagës *neto* të punëmarrësit, pasi nga paga *bruto* zbriten vetëm kontributet për pagesat e sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore.

47.4 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se konkluzioni i Komisionit është diskriminues dhe absurd, në tejkallim të kompetencës që i jep ligji nr. 84/2016, pasi ka krahasuar pagat e profesioneve të ndryshme e, aq më tepër, ka bërë krahasimin e pagave publike me ato private, në një kohë kur pagat e institucioneve publike rregullohen me ligj të veçantë, ndërsa për pagat e të punësuarve në sektorin privat, ligji rregullon vetëm pagën minimale, trupi gjykues vëren, *së pari*, se pretendimi i subjektit për qëndrim diskriminues është i paargumentuar, pasi nuk rezultoi të jetë evidentuar trajtimi i ndryshëm ligjor nga ana e Komisionit në arsyetimin e kundërshtuar. *Së dyti*, arsyetimi i Komisionit se *nuk duket bindës deklarimi i bërë për pagën neto të përfituar nga personi i lidhur prej 60.000 lekësh/muaj për një punë të kryer me kohë të pjesshme, për periudhën 2000 - 2004, kur për analogji, paga neto mesatare e përfituar nga subjekti i rivlerësimit për të njëjtën periudhë, i cili në atë kohë ushtronte funksionin e gjyqtarit ka qenë rreth 48.000 lekë/muaj*, nuk ka mbajtur peshën kryesore në arritjen e konkluzionit lidhur me të ardhurat e pretenduara nga punësimi në shoqërinë “{***}” ShPK. Krahasimi i pagave, për punë në të cilat kërkohet një kualifikim dhe përgjegjësi më e lartë, është bërë nga Komisioni, për të vlerësuar sa e besueshme është kjo pagë e përfituar nga personi i lidhur, e deklaruar gjatë procesit të rivlerësimit në vlerë të ndryshme/më të lartë nga ajo e deklaruar prej saj në deklaratën e interesave të vitit 2008, si dhe në kushtet e mungesës së dokumentacionit ligjor që provonte përfitimin e saj dhe deklarimin e përfitimit në organet kompetente. Pretendimi i mësipërm i subjektit të rivlerësimit nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi.

47.5 Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni, duke ngarkuar me përgjegjësi personin e lidhur, pas 15 viteve, për veprimet e subjektit privat, cenon hapur parimin e ligjshmërisë dhe procesin e rregullt ligjor, si dhe bën një vlerësim diskriminues, pasi të drejtat e administratorit nuk janë të varura nga punëmarrësi, i cili ka punuar plot 10 vite më parë, trupi gjykues vëren se pretendimi i sipërcituar i drejtohet konstatimit të Komisionit në vendim³⁷ se *për më tepër, nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të QKB-së, pas kërkimit në fushën e caktuar me qëllim identifikimin e NIPT-it të kësaj shoqërie, u konstatua se subjekti tregtar “{***}” ShPK, me NIPT {***}, nuk është paraqitur në QKB për të plotësuar të dhënat e tij*. Në analizë të këtij pretendimi, vërehet se konstatimi i sipërcituar i Komisionit është

³⁶ Në mbështetje të legjislacionit të kohës [ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar], sigurimi i jetës nuk bënte pjesë në pagesat e kontributeve të detyrueshme të përlllogaritura mbi pagën bruto, të cilat janë detyrim i punëdhënësit.

³⁷ Paragrafi 39.9 i vendimit.

renditur në vendim, në paragrafin me nëntitull “Hetimi i kryer nga Komisioni”, në të cilin janë pasqyruar konstatimet e rezultuara nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni dhe për të cilat subjektit i ka kaluar barra e provës. Në pjesën arsyetuese të vendimit, Komisioni nuk ka arritur në konkluzione lidhur me këtë konstatim. Pretendimi i ngritur nga subjekti në ankim, rezulton t’u referohet gjetjeve fillestare të Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues gjen me vend të nënvizojë faktin se personi i lidhur është bërë subjekt deklarues i pasurisë për herë të parë në vitin 2008, për shkak të lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit dhe për pasojë deklarimi i të ardhurave nga punësimi në shoqërinë “{***}” ShPK, në masën 35.000 lekë/muaj, përkon me një periudhë relativisht të shkurtër, rreth 4 vjet, nga momenti i përfundimit të marrëdhënies së punës në shoqërinë në fjalë. Për më tepër, detyrimi për të justifikuar me dokumentacion mbështetës deklarimet në formularët përkatës nuk ka lindur për herë të parë me rastin e plotësimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, përkundrazi ka qenë një detyrim që buronte nga ligji i kohës nr. 9049/2003. Sipas parashikimeve të këtij ligji, subjekti dhe personi i lidhur kanë qenë të vetëdijshëm që deklarimet e tyre duhet të mbështeteshin në dokumentacion ligjor, në të kundërt do të kishte pasoja ligjore.

48. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë marrëdhënien e pretenduar të punësimit të personit të lidhur në shoqërinë “{***}” ShPK për periudhën 2000-2004 dhe as të ardhurat e pretenduara si të krijuara prej saj. Gjithashtu, deklarimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me sa më sipër, krejtësisht kontradiktore e në mungesë koherence të theksuar, nuk arritën të bindin trupin gjykues për vërtetësinë e tyre. Për të gjitha këto fakte, trupi gjykues, në të njëjtën linjë me konkluzionin e Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë³⁸, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të rremë në lidhje me ekzistencën e këtyre të ardhurave, për pasojë deklarim të rremë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit lidhur me deklarimin e këtyre të ardhurave, si një nga burimet e krijimit të shumës prej 80.000 euro, duke u gjendur në këtë mënyrë në situatën e parashikuar prej nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016.
49. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas të cilit, *Komisioni nuk ka pasqyruar drejt situatën faktike, nuk ka bërë vlerësim të drejtë të provave lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga punësimi te personi fizik {***}, vëllai i saj, si dhe ka pasqyruar të dhëna jo të vërteta, duke aluduar se subjekti ka paraqitur prova jo të sakta, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur kanë kryer deklarim të rremë dhe të pamjaftueshëm për të ardhurat e pretenduara si interesa huaje apo nga zhvillimi i aktivitetit tregtar, të regjistruar në emër të vëllait të personit të lidhur, me qëllim gjenerimin fiktiv të të ardhurave monetare.*
50. Në kundërshtim të sa më sipër, në ankim, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar pretendime të cilat u shqyrtuan dhe vlerësuan nga trupi gjykues, si më poshtë.
51. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *ndryshe nga sa është vlerësuar nga Komisioni, nga personi i lidhur, si në prokurori edhe në ILDKPKI, është deklaruar fakti i fillimit të aktivitetit të Personit Fizik “{***}” dhe regjistrimi i tij në organin tatimor në vitin 2005, ashtu siç vërtetohet nga certifikata me nr. serial {***}, e vitit 2005, me NIPT {***}, e paraqitur si provë gjatë hetimit në Komision, nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi se:*

(i) personi i lidhur, znj. K. P., në cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme për qëllim hetimi, në datën 26.05.2014, sipas procesverbalit përkatës, ka deklaruar para prokurorit, ndër të tjera, se [...] bashkë me vëllain kemi punuar nga viti 2004 pas mbarimit të shkollës deri në fund të muajit shkurt 2006. Kam punuar me kohë të pjesshme pasdite me vëllain tim në

³⁸ Paragrafi 95.1 i vendimit të Komisionit.

aktivitetin tregti të artikujve me pakicë, të paregjistruar, sepse me mbarimin e shkollës unë jam punësuar në shtet. Në fillim të muajit janar të vitit 2006, nga ana e tatimeve të rrethit Lezhë, na është kërkuar detyrimisht që të regjistrohet vëllai për biznesin e tij dhe gjatë muajit shkurt ka plotësuar dokumentet ligjore për këtë biznes dhe më datë 02.03.2006 është regjistruar në degën e tatim taksave Lezhë;

(ii) z. A. (E.) P., në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, në datën 03.09.2014, sipas procesverbalit përkatës, para oficerit të policisë gjyqësore, ndër të tjera, ka deklaruar se [...] në vitin 2004 hapa një studio diskografike “{***}”. [...] deri në fund të shkurtit 2006 kam qenë i paregjistruar në organet tatimore. Më pas e kam regjistruar këtë aktivitet duke deklaruar veten time si të punësuar dhe paguar taksat përkatëse në shtet si person fizik. [...] kam vazhduar punën deri në vitin 2012;

(iii) në deklaratën noteriale, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.10.2012, z. A. (E.) P. ka deklaruar se [...] në Lezhë [...] kam ushtruar aktivitetin si person fizik “tregëtim artikujsh të ndryshëm me pakicë, i regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Lezhë nr. {***}, datë 02.03.2006 dhe në degën e tatim taksave me NIPT {***}, aktivitet të cilin e kam ushtruar nga data e regjistrimit dhe deri në fund të vitit 2011.

(iv) vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë “Mbi regjistrimin e Personit Fizik {***}, me aktivitet “Tregëtim artikuj industrialë””, mban datën 02.03.2006.

Trupi gjykues vlerësoi se situata faktike dokumentare e përshkruar më lart provon tej çdo dyshimi se regjistrimi i Personit Fizik “{***}” në organet tatimore nuk mund të kishte ndodhur para vitit 2006. Edhe nga verifikimi i dokumentit “Certifikatë regjistrimi në organin tatimor”, në të cilën ka mbështetur pretendimin e tij subjekti i rivlerësimit, rezultoi se në të dhënat e faqes së jashtme certifikata ka të përshkruar nr. serial {***}, viti 2005, për biznes i vogël, lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve e Rrethit Lezhë, për E. P., me NIPT {***}. Por në faqen e brendshme, certifikata ka të përshkruara, të dhënat “Dega tatime e taksa e rrethit, NIPT {***}, lëshuar për E. P., regjistruar në gjykatë me vendim nr. {***}, datë 02.03.2006, data e regjistrimit në organin tatimor 12.04.2006, [...], për biznesin “Tregëtim artikuj të ndryshëm me pakicë”. Në këto kushte, trupi gjykues konstatoi se në ndryshim nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, data e regjistrimit të Personit Fizik “{***}” në organet tatimore është data 12.04.2006.

52. Sa i përket pretendimit se vlerësimi i Komisionit për aktmarrëveshjen e lidhur mes bashkëshortes së subjektit dhe vëllait të saj është bërë duke shtuar fjalë të cilat akti nuk i ka në përmbajtje, konkretisht fjalën NIPT e duke krahasuar numrat e aktmarrëveshjes së lidhur me nr. e NIPT, sipas QKB-së, kur ky institucion është krijuar 2 vjet pas hartimit të kësaj marrëveshjeje, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim³⁹, ka arsyetuar, megjithëse personi i lidhur ka deklaruar se huaja e dhënë vëllait ka qenë e paformalizuar, me dërgimin e prapësimeve, subjekti ka paraqitur si provë të re dokumentin “aktmarrëveshje - bashkëpunim” i datës 01.03.2005, të lidhur mes shtetasve K. P. dhe E. P., në prani të avokatit I. I., ku parashikohet edhe fakti i huadhënies së shumës prej 2.500.000 lekësh. Pa i hyrë vlerësimit të përmbajtjes së këtij dokumenti, krahas faktit se personi i lidhur ka deklaruar më parë se i ka dhënë hua vëllait të saj pa dokument, si edhe faktit se ky dokument nuk është paraqitur/depozituar më parë si dokumentacion provues gjatë hetimit administrativ të kryer nga ILDKPKI-ja, hetimit penal të zhvilluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si edhe si dokumentacion shoqërues i deklaratës së rivlerësimit kalimtar vetting, Komisioni krijoi bindjen se ka të bëjë me një dokument të krijuar/prodhuar së fundmi, pasi megjithëse pretendohet se marrëveshja midis palëve është lidhur më 01.03.2005, në të është pasqyruar NIPT i avokatit I. I., (NIPTI {***}), i cili pas verifikimeve të bëra në faqen zyrtare të QKB-së, rezulton se data e regjistrimit të këtij NIPTI është 06.06.2016. Pra, del qartë fakti se kjo

³⁹ Shih paragrafin 70.8 të vendimit të Komisionit.

marrëveshje në rastin më të mirë është përpiluar pas datës 06.06.2016, datë në të cilën avokati I. I., është pajisur me NIPT-in e referuar në aktmarrëveshje.

52.1 Nga verifikimi i dokumentit “Aktmarrëveshje bashkëpunimi për hapjen e një biznesi si person fizik”, datë 01.03.2005, e lidhur mes E. P. dhe K. P., trupi gjykues konstatoi se në preambulën e dokumentit përshkruhet: “*Sot në Lezhë, unë avokati I. I., me nr. licence {***} dhe nr. {***}, i thirrur për konsulencë ligjore nga palët bashkëpunuese të cilët janë vëlla e motër, [...]*”. Nga të dhënat e pasqyruara nga avokati, i cili ka hartuar aktin, rezultoi se vërtet nuk është pasqyruar shprehimisht fjala “NIPT”, por është pasqyruar “nr. {***}”, i cili *prima facie* duket se i korrespondon një numri identifikimi fiskal. Nga verifikimi në burimet e hapura në faqen zyrtare në internet të Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezultoi se numri fiskal i sipërcituar i përket subjektit I. I., me nr. NIPT {***}, me objekt: Avokat, punonjës social etj. Nga të dhënat e Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Person Fizik I. I.”, rezultoi data e regjistrimit 06.06.2016, me NUIS {***}, me vend ushtrimi aktiviteti në Lezhë. Sipas të dhënave të Vërtetimit të Kryerjes së Aplikimit, rezultoi se z. I. I. ka aplikuar për regjistrimin fillestar të Personit Fizik, në datën 03.06.2016. Bazuar në këtë situatë faktike, në raport me parashikimin e nenit 60, paragrafi i tretë i ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, sipas të cilit, *numri unik i identifikimit të subjektit jepet vetëm një herë, në çastin e regjistrimit fillestar dhe është i pandryshueshëm, si dhe nuk u jepet subjekteve të tjera edhe pas çregjistrimit. Subjektet e regjistruara janë të detyruara të shënojnë numrin unik të identifikimit të subjektit në çdo korrespondencë të tyre*, trupi gjykues konstatoi se numri “{***}”, i cituar nga z. I. I., në aktmarrëveshjen e datës 01.03.2005, e hartuar prej tij, është numri unik i identifikimit, lëshuar nga QKB-ja, në datën 06.06.2016. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se dokumenti “Aktmarrëveshje bashkëpunimi për hapjen e një biznesi si person fizik”, datë 01.03.2005, *në rastin më të mirë është përpiluar pas datës 06.06.2016, datë në të cilën avokati I. I., është pajisur me NIPT-in e referuar në aktmarrëveshje.*

52.2 Në arritjen e këtij përfundimi, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe faktet, si më poshtë:

a) në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në të cilën personi i lidhur ka deklaruar, ndër të tjera, se *të ardhurat nga puna dhe interesat e marra nga vëllai im vërtetohen me dokumentin e aktivitetit privat të tij, të konfirmuara edhe me deklaratën noteriale të datës 15.10.2012, dokument të ushtrimit të aktivitetit privat me NIPT {***} dhe deklaratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2017*, nuk është referuar ndonjë aktmarrëveshjeje të lidhur mes saj dhe vëllait z. E. P.. Një marrëveshje e tillë nuk është paraqitur as si dokumentacion justifikues, bashkëlidhur deklaratës;

b) personi i lidhur, znj. K. P., në deklaratimet, në cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme për qëllim hetimi, dhënë në datën 26.05.2014, para prokurorit, ka deklaruar se: *[...] me mbarimin e shkollës në vitin 2004, unë kam pasur të miat 2.500.000 lekë, të cilat ia kam dhënë vëllait tim A. P., me interes, fakt ky i konfirmuar nga vëllai im me deklaratën noteriale 15.10.2012, të cilën e kam paraqitur në ILDKPKI*. Në këtë deklaratim, personi i lidhur nuk ka deklaruar ekzistencën e dokumentit “Aktmarrëveshje bashkëpunimi për hapjen e një biznesi si person fizik”, datë 01.03.2005, të lidhur mes saj dhe z. E. P.. Nëse kjo marrëdhënie huaje ka qenë e dokumentuar nëpërmjet aktmarrëveshjes së pretenduar, në kushtet kur ndaj subjektit të rivlerësimit ka pasur një kallëzim dhe procedim penal në vitin 2014, personi i lidhur, logjikisht, do të duhej ta kishte paraqitur atë në kuadër të deklaratimeve të saj gjatë hetimit penal, me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të pretenduara si të fituara nga huaja dhe, për rrjedhojë, mos marrjen në përgjegjësi penale të subjektit të rivlerësimit;

c) z. A. (E.) P., në deklaratimet, në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, dhënë në datën 03.09.2014 para oficerit të policisë gjyqësore ka deklaruar se: *[...] motra ime K., në vitin*

2004, më ka dhënë mua, nga kursimet e saj, një shumë prej 2.500.000 lekësh. [...] Në këto kushte, kemi rënë dakord verbalisht mes njëri-tjetrit, që paratë e saj unë të vazhdoja t'i përdorja, ashtu sikur edhe kam bërë. Në këtë deklaram, z. P. pranon se mes tij dhe së motrës, dakordësia ka qenë verbale, duke mos përmendur ekzistencën e “Aktmarrëveshje bashkëpunimi për hapjen e një biznesi si person fizik”, datë 01.03.2005, të lidhur mes tij dhe znj. K. P.;

d) ekzistenca e dokumentit “Aktmarrëveshje bashkëpunimi për hapjen e një biznesi si person fizik”, datë 01.03.2005, është artikuluar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit dhe është paraqitur si provë prej tij, vetëm pas njohjes me gjetjen e rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit se *personi i lidhur nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë në formë likuiditetesh cash në shumën prej 70.000 eurosh, deri në vitin 2008.*

Bazuar në këto rrethana, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit as në ankim nuk arriti të provojë të kundërtën e dyshimeve të arsyeshme të ngritura nga Komisioni se dokumenti aktmarrëveshje bashkëpunimi nuk ka ekzistuar më parë, por është krijuar për efekt të ndryshimit të gjetjeve të hetimit administrativ. Trupi gjykues vlerësoi të mbajë në konsideratë këtë përfundim, në vlerësimin tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

53. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni shtrembëron faktet, duke aluduar se personi i lidhur ka deklaruar 30.000 euro, por një fakt i tillë nuk qëndron në asnjë provë. Marrëdhënia e punësimit të bashkëshortes me Personin Fizik “{***}” dhe paga neto e përfituar prej saj në vlerën 35.000 lekë, në shumë totale prej 1.320.000 lekë në vit, një vlerë e zakonshme për një biznes të tillë, rezulton e provuar nga aktmarrëveshja e lidhur mes tyre, si dhe është në përputhje me deklaramin e subjektit. Nëse është e nevojshme, Kolegji mund të bëjë testime në treg për të parë konkretisht se sa të ardhura sigurojnë tregtarë të tillë.*

53.1 Në lidhje me sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se është i pabazuar në prova pretendimi se Komisioni ka aluduar lidhur me deklaramin e personit të lidhur, pasi nga verifikimi i deklaratës së vitit 2008, rezultoi se bashkëshortja e tij, në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, ka deklaruar: [...] *Mars 2005-shtator 2008 punuar part-time pasdite me personin Personin Fizik “E. P.”, vëllai im, si bashkëpronarë në një videotekë (shitje disqesh dhe kasetash). [...] 2005-2008 punuar part-time pasdite si bashkëpronarë me personin fizik vëllai E. P.. Shuma e të ardhurave: 30.000 euro.*

53.2 Në vijim të analizimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me verifikimin dhe provueshmërinë e krijimit të shumës së përfituar prej punësimit të deklaruar të personit të lidhur te biznesi i të vëllait, nga aktet e administruara gjatë procesit, rezultuan faktet e mëposhtme.

a. Në deklaratën e rivlerësimit, personi i lidhur ka deklaruar se ka punuar në aktivitetin privat të vëllait të saj, pa pasqyruar të dhëna lidhur me periudhën e punësimit apo pagën e përfituar. Në deklaratën fillestare të vitit 2008, personi i lidhur ka deklaruar se në vitet 2005-2008 ka punuar *part-time* pasdite, si bashkëpronarë me personin fizik vëllain E. P. dhe se shuma e të ardhurave ka qenë 30.000 euro;

b. Nga procesverbali i mbajtur në ILDKPKI, më datë 17.10.2012, kur subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja i tij janë thirrur për të dhënë shpjegime, lidhur për deklaramet në deklaratën e interesave të vitit 2008, ata kanë deklaruar se një prej burimeve të krijimit të shumës 80.000 euro nga personi i lidhur ka qenë edhe paga mujore prej 35.000 lekësh nga punësimi i saj, pasdite, në aktivitetin e të vëllait. Personi i lidhur ka dorëzuar në ILDKPKI,

deklaratën noteriale të z. A. (E. P.), nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.10.2012, i cili deklaroi se: *Motra ime më ka ndihmuar gjatë ushtrimit të aktivitetit tim, çdo ditë pasdite, dhe për këtë unë i kam dhënë edhe një pagë 35.000 lekë/muaj;*

c. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, ka bërë deklaratime kontradiktore, duke pretenduar se:

i. Në përgjigjen e përcjellë, më datë 03.03.2020: [...] *të ardhurat nga puna part-time në biznesin e vëllait për periudhën mars 2005 - shtator 2008, shumë kjo e barabartë 45 muaj me pagë 35.000 lekë e barabartë me 1.575.000 lekë. [...] Në tërësi pagat e përfituara për periudhat nga data 01.10.2000 deri më datë 31.08.2004, dhjetor 2004 - shtator 2008 dhe periudhën me kohë të pjesshme mars 2005 - shtator 2008, gjithsej shuma 5.379.381 lekë.*

ii. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ: *Përfundimisht ajo ka pranuar që të shpërblehet për kontributin e saj në ngritjen e biznesit dhe ofrimin e shërbimit për mbarëvajtjen e tij në një shumë totale prej 1.320.000 lekë në vit, e cila nuk është një vlerë marramendëse dhe jo e zakonshme për një biznes të tillë. [...] Çdo e ardhur e përfituar nga bashkëshortja dhe interesat e llogaritura nga dhënia e shumës 2.500.000 lekë deri në momentin e martesës janë administruar nga vëllai i saj duke llogaritur në mënyrë progresive interesin 3% në muaj. Shuma e interesit të llogaritur për gjithë periudhën është 4.393.800 lekë. Paga e marrë në biznesin e vëllait në periudhën 2005- gusht 2008 është në total 1.400.000 lekë.*

Këto deklaratime kontradiktore, lidhur me të ardhurat e pretenduara nga punësimi i pretenduar në biznesin e të vëllait [të përfituara sipas deklaratimeve të saj herë si bashkëpronare me personin fizik vëllain E. P. dhe herë si e punësuar me kohë të pjesshme në biznesin e tij], të ballafaquara me faktin se deklarata noteriale e z. A. P. daton në vitin 2012 për efekt të kontrollit të pasurisë dhe interesave të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur nga ILDKPKI-ja në këtë vit, si edhe me mungesën e besueshmërisë se “Aktmarrëveshja e bashkëpunimi për hapjen e një biznesi si person fizik”, datë 01.03.2005, është një akt i krijuar në kohën e pretenduar, nuk arritën të bindin trupin gjykues mbi vërtetësinë e tyre. Trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë marrëdhënien e pretenduar të punësimit të personit të lidhur në pranë Personit Fizik “{***}” për periudhën 2005-2008 dhe as të ardhurat e pretenduara si të krijuara prej saj.

Për të gjitha këto fakte, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të rremë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, lidhur me deklarimin e të ardhurave të pretenduara si të përfituara nga punësimi pranë Personit Fizik “{***}” si një nga burimet e krijimit të kursimeve në shumën 80.000 euro, duke u gjendur në këtë mënyrë në situatën e parashikuar prej nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, nuk gjen mbështetje as pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit, me anë të të cilit kërkohet nga Kolegji të bëjë testimë në treg, për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti privat i z. {***}.

53.3 Për sa i përket pretendimit se lidhur me dokumentimin e pagesës së tatimit mbi të ardhurat nga paga apo tatimit në burim nga interesat e huas, organet tatimore konfirmojnë pamundësinë objektive të verifikimit të derdhjes së tatimit nga punëdhënësi dhe se ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, përpyekjet e subjektit për të siguruar dokumentacion ligjor provues për këto të ardhura kanë qenë maksimale e vërtetuar kjo me provat e paraqitura në Komision, trupi gjykues, megjithëse çmoi se në vijim të konkluzionit të arritur në paragrafin 53.2 më sipër, zgjidhja e këtij pretendimi nuk do të ndryshonte konkluzionin e arritur më sipër, e shqyrtoi atë në kuadër të dhënies përgjigje të çdo pretendimi të ngritur nga subjekti, duke vlerësuar si vijon. Subjekti i rivlerësimit i referohet dokumentacionit të dorëzuar prej tij, gjatë hetimit administrativ në Komision, konkretisht: (i) shkresës nr. {***} prot., datë 03.03.2020, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë drejtuar znj. K. Q., sipas së cilës: *Bazuar në të dhënat e sistemit tatimor C@TS, subjekti E. P. është regjistruar me NIPT {***}. Për sa kërkoni pagesën*

*e tatimit në burim, në sistemin C@TS nuk disponohen këto të dhëna; si dhe (ii) shkresës nr. {***} prot., datë 21.08.2020, e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Lezhë, sipas së cilës subjekti E. P., i regjistruar në QKB me nr. NIPT {***}, nuk ka detyrime të palikuiduara për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Lezhë.*

Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, në përgjigjen e saj, shprehet vetëm për tatimin në burim, ndërsa personi i lidhur dhe vëllai i saj kanë deklaruar se ka pasur një marrëdhënie pune dhe se është paguar një pagë mujore, deklarime të cilat të çojnë në konkluzionin se për znj. K. P. nga punëdhënësi duhet të paguhej tatimi mbi të ardhurat dhe jo tatimi në burim, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi në kohën e marrëdhënies së pretenduar të punësimit⁴⁰. Në këto kushte, pretendimi se organet tatimore konfirmojnë pamundësinë objektive të verifikimit të derdhjes së tatimit nga punëdhënësi, nuk qëndron, pasi organet e sipërcituara janë përgjigjur brenda kufijve të kërkesës së drejtuar nga personi i lidhur, për pasojë subjekti i rivlerësimit nuk ka ezauruar barrën e provës për të provuar jo vetëm të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga punësimi me kohë të pjesshme pranë biznesit të vëllait të saj, por edhe pagesën e detyrimeve tatimore, mbi të ardhurën e pretenduar. Në vijim të këtij arsytimi, nga verifikimi i rrethanave faktike, trupi gjykues vëren se personi i lidhur, znj. K. Q. (P.), në cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme për qëllim hetimi, në datën 26.05.2014, ka deklaruar para prokurorit se *gjatë punës time pranë biznesit të vëllait nuk kam qenë e siguar, sepse isha e punësuar në shtet dhe paguaja sigurimet sipas ligjit. Z. A. (E.) P., në deklarimet, në cilësinë e personit që ka dijani për veprën penale, dhënë në datën 03.09.2014 para oficerit të policisë gjyqësore, ka deklaruar se deri në fund të shkurtit 2006 kam qenë i peregjistruar në organet tatimore. Më pas e kam regjistruar këtë aktivitet, duke deklaruar veten time si të punësuar dhe paguar taksat përkatëse në shtet si person fizik.*

Nga tërësia e rrethanave faktike të analizuara më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se znj. P. nuk ka qenë e deklaruar/regjistruar si e punësuar pranë Personit Fizik “{***}”, për pasojë për të nuk paguheshin detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi dhe personi i lidhur ka qenë në dijani të këtij fakti, sidomos në mbështetje të pretendimeve të saj se ka qenë një bashkëpronare heshtur në marrëdhënien e biznesit të të vëllait, duke u gjendur kështu në kushtet e keqbesimit, sa i përket pagesës së detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhënia e pretenduar e punës, pranë këtij biznesi.

54. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit Komisioni ka treguar njëanshmëri dhe paragjykim në vlerësimin e provave dhe marrjen e vendimit, lidhur me dhurimin e shumës 10.000 euro nga të afërmit ndaj bashkëshortes së tij me rastin e martesës, trupi gjykues konstatoi si vijon.
55. Komisioni, në vendim⁴¹, ka arsytuar: *Nga analiza përfundimtare e të dhënave të mësipërme, dokumentacionit të administruar në dosje, si dhe deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ dhe me prapësimet e dërguara pas njohjes me rezultatet e hetimit, Komisioni krijoi bindjen se personat e tjerë të lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar dhurimin e shumës prej 10.000 euro deri në vitin 2008, në favor të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Si konkluzion, trupi*

⁴⁰ Sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili ka si objekt rregullimi marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin, si dhe të tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave [neni 1], të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, përfshinin të ardhurat nga marrëdhënia e punës së ushtruar në Republikën e Shqipërisë [neni 4, shkronja “a”] dhe për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merrshin si të ardhura të tatueshme pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës [neni 8, shkronja “a”]. Ndërsa tatimi në burim, si një nga llojet e tatimit mbi të ardhurat personale, vendoset mbi kategoritë e tjera të të ardhurave të tatueshme, si shpërblime për shërbime individuale, dhe të ardhurat nga qiratë e banesave [neni 2].

⁴¹ Paragrafët 73.5 dhe 73.6 të vendimit të Komisionit.

grykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës prej 10.000 euro deklaruar si e dhuruar nga familjarët e personit të lidhur.

56. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka parashtruar pretendime, të cilat u shqyrtuan nga trupi gjykues në raport me provat e administruara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, duke vlerësuar si vijon.
57. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *Komisioni nuk i ka kthyer përgjigje kërkesave të tij, lidhur me marrjen e deklarimeve të personave të afërt, të cilët kanë bërë dhuratat në dasmën e personit të lidhur në mjete monetare sipas traditës dhe nuk ka as një vendim të ndërmjetëm të Komisionit për t'u shprehur mbi kërkimet e bëra nga subjekti megjithëse e ka një detyrim të tillë*, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

57.1 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit personi i lidhur ka deklaruar: *[...] Para martesë prindërit, vëllai dhe motra më kanë dhuruar 10.000 euro. I njëjti deklaram rezulton të jetë bërë edhe në deklaratën e interesave të vitit 2008.*

57.2 Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.10.2012, z. A. (E.) P., ndër të tjera, deklaroi: *[...] Gjithashtu, ne si familje, me rastin e martesës, meqenëse nuk kemi bërë ceremoni dhe pajë i kemi dhënë dhuratë motrës shumë 10.000 euro. Deklaram të njëjti kanë bërë edhe znj. M. P. dhe znj. D. L., në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2017.*

57.3 Në përgjigjen e përcjellë më datë 03.03.2020, mbi pyetësonin e drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *E gjithë familja i ka dhënë bashkëshortes sime si pajë 10.000 euro me rastin e martesës.*

57.4 Në shpjegimet e dhëna pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Shuma 10.000 euro është dhuratë nga familja e bashkëshortes dhe të ftuarit në dasmën e saj, sipas traditës shqiptare (për të cilën kërkohet të pyeten me cilësinë e dëshmitarit në seancë të gjithë të ftuarit). [...] Bashkë me shpjegimet e mia kam paraqitur prova se vëllai i bashkëshortes dhe familja e tij kanë pasur aktivitet tregtar, organet tatimore vendore konfirmojnë regjistrimin dhe likuidimin e detyrimeve tatimore. Nga dokumentacioni i marrë nga Bashkia Lezhë, gjithashtu, provohen të ardhurat e znj. D. L., motra e bashkëshortes dhe bashkëshortit të saj A. L., të cilat provojnë mundësinë e tyre financiare për dhënie dhe dhuratave me rastin e martesës apo dhe më pas me rastin e lindjes së fëmijëve dhe në datëlindjet e tyre. Të ardhurat e dokumentuara të familjarëve të bashkëshortes justifikojnë burimin e dhurimit”.*

58. Nga rrethanat faktike të evidentuara si më sipër, trupi gjykues vëren se pretendimi se shuma prej 10.000 eurosh është krijuar edhe nga dhurimet e të ftuarve në dasmën e bashkëshortes, është paraqitur për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit vetëm gjatë shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, pasi ai ishte njohur me gjetjen e Komisionit se *personat e tjerë të lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar dhurimin e shumës prej 10.000 euro deri në vitin 2008, në favor të personit të lidhur*. Për më tepër, ky pretendim nuk gjen asnjë mbështetje në deklaramet e vetë dhuruesve të shumës, mbi burimet financiare dhe rrethanat nga të cilat është krijuar shuma e dhuruar prej tyre. Ky pretendim i subjektit të rivlerësimit rezulton të jetë kontradiktor me deklaramet e bashkëshortes së tij në deklaratën periodike të vitit 2008 dhe në deklaratën e rivlerësimit mbi burimet e krijimit të shumës objekt kontrolli. Trupi gjykues, përveçse e vlerësoi të paprovuar, çmoi se qasja e subjektit të rivlerësimit, i cili shfaq dukshëm mungesë koherence në deklaramet e tij edhe për sa i përket burimit të krijimit të shumës prej 10.000 eurosh dhuruar personit të lidhur në vitin

2008, duke e ndryshuar atë në varësi të nevojave të mbulimit të rezultateve të hetimit, e bën edhe të pabesueshëm pretendimin e ngritur në ankim se, si burim duhen konsideruar edhe dhurimet e të ftuarve në dasmën e bashkëshortes.

Në vijim të analizës rezultoi se subjekti i rivlerësimit, në funksion të këtij pretendimi, nuk ka paraqitur në Komision një kërkesë formale për marrjen e provës me dëshmitarë, nuk ka treguar as emrat e dëshmitarëve apo të dhëna të tjera për ta; edhe në seancën dëgjimore publike të datës 11.09.2020, referuar procesverbalit të saj, rezultoi se ai nuk ka paraqitur asnjë kërkesë procedurale për thirrje dëshmitarësh. Në këtë kuptim, pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbetet i pambështetur në prova.

59. Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka krahasuar pagën e personit tjetër të lidhur, znj. D. L., për periudhën 2001-2008, por nuk ka përfshirë edhe të ardhurat e bashkëshortit të saj në burimet e krijimit të shumës prej 10.000 eurosh, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, ka arsyetuar se *Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet dhe paanësi prapësimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me burimet financiare të prindërve të bashkëshortes dhe vëllait të saj, çmon se janë të karakterit deklarativ dhe nuk provohen me dokumentacion justifikues ligjor. Ndërsa, nga analiza e dokumentacionit të depozituar për të ardhurat nga punësimi i të motrës së bashkëshortes së tij, znj. D. L., duket se të ardhurat totale neto nga paga e personit tjetër të lidhur për vitet 2001-2007 [...] janë modeste, të cilat vlerësohen se kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të familjes së saj. Në total, të ardhurat neto të kësaj shtetaseje për vitet 2001- qershor 2008 janë në vlerën prej 1.629.260 lekësh. Për të mbuluar shumën prej 10.000 eurosh (konvertuar me kursin e kohës në shumën prej 1.231.800 lekësh), personi tjetër i lidhur do duhej t'i dhuronte personit të lidhur (bashkëshortes së subjektit) rreth 76 % të të ardhurave të saj.*

59.1 Në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në kundërshtim të arsytimit të mësipërm të Komisionit, trupi gjykues vëren se personi i lidhur në deklaratën e rivlerësimit dhe në deklaratën e interesave të vitit 2008, në burimet e krijimit të shumës së dhuruar prej 10.000 eurosh nuk ka cilësuar në personat dhurues, bashkëshortin e motrës së saj, z. A. L.. Edhe në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2017, znj. D. L., nuk ka cilësuar që në dhurimin e shumës prej 10.000 eurosh ka kontribuar edhe bashkëshorti i saj. Në kushtet kur të ardhurat e bashkëshortit të znj. D. L. janë pretenduar për herë të parë në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ për të shmangur situatën financiare negative nga analiza e kryer nga Komisioni, si dhe në mbështetje të faktit se nuk rezultoi që z. A. L., në përputhje me kriteret e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të ketë pranuar se ka kontribuar në krijimin e shumës 10.000 euro dhuruar znj. K. Q., trupi gjykues vlerësoi se Komisioni ka konstatuar me të drejtë se vetëm të ardhurat e znj. D. L. nuk mjaftojnë për të krijuar me burime të ligjshme shumën 10.000 euro.

59.2 Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e mundshme të përfituara nga prindërit e bashkëshortes së tij dhe të ardhurat e përfituara nga vëllait i saj nga aktiviteti tregtar. Në lidhje me këtë të fundit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar vetëm dokumentacion mbi regjistrimin e tij në organet tatimore, por jo informacion nga i cili mund të evidentohen të dhëna lidhur me qarkullimin dhe fitimin e realizuar prej tij, si edhe mbi pagesën e detyrimeve tatimore.

60. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit se shuma prej 10.000 eurosh dhuruar personit të lidhur nga të afërmit e saj është e krijuar nga burime të ligjshme, mbeten të pambështetura në prova. Për pasojë, trupi gjykues e gjeti të drejtë mospërfshirjen e shumës prej 10.000 eurosh, në analizën financiare të Komisionit, për

verifikimin e mundësisë së krijimit të pasurive të deklaruara veçmas nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

61. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *Komisioni ka treguar njëanshmëri dhe paragjykim në vlerësimin e provave dhe në marrjen e vendimit, lidhur me zbatimin e Kodit të Familjes, pasi pasuritë paramartesore të personit të lidhur, duhet t'i veçonte nga pasuritë e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim⁴², ka arsyetuar se [...] në kushtet kur pasuria e pretenduar si e krijuar para martesë nga personi i lidhur është deklaruar në formën e likuiditeteve cash, pra, është pasuri e pamaterializuar/trupëzuar dhe e paevidentuar më parë në institucione financiare, si edhe nisur nga analiza e kryer për burimin e deklaruar të krijimit të saj, në vlerësim edhe të provave të dyshimta të depozituara nga subjekti, trupi gjykues krijoi bindjen se personi i lidhur nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e gjendjes së likuiditeteve cash në shumën prej 80.000 euro, madje ngrihen dyshime të arsyeshme se kjo pasuri është deklaruar fiktivisht, me dijeninë e plotë të subjektit të rivlerësimit, me qëllim mbulimin e burimit financiar të vërtetë të krijimit të pasurive që do të bliheshin/krijoheshin në të ardhmen.*
62. Në kundërshtim të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka parashtruar pretendimet e tij, të cilat u vlerësuan nga trupi gjykues si më poshtë.
63. Në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit *se ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, aktmarrëveshja paramartesore, datë 02.08.2008, është një akt zyrtar dhe duhet vlerësuar si i tillë nga Kolegji, duke i dhënë rëndësinë ligjore, përtej çdo dyshimi të supozuar nga Komisioni që në hetim dhe i përmbyllur në vendimmarrje e tij, trupi gjykues vëren se me prapësimet e paraqitura në Komision në datën 08.09.2020, para zhvillimit të seancës dëgjimore publike, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentin Aktmarrëveshje Paramartesore, datë 02.08.2008, e lidhur mes z. Arjan Qafa dhe znj. K. P., të cilët deklarojnë se [...] redaktojmë këtë aktmarrëveshje për të përcaktuar dhe saktësuar të drejtat dhe detyrimet pasurore të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme përfshirë dhe të ardhurat financiare. K. P. deklaron se të ardhurat e fituara nga puna e saj, nga viti 2000 deri në muajin gusht të vitit 2008, do jenë të ndara dhe personale. Të ardhurat [...] që kapin vlerën 70.000 euro, do të jenë pronë vetjake e shtetases K. P.. Shumë kjo që do të administrohet nga unë K. P. edhe pas martesës, e veçuar nga pasuria bashkëshortore. Këto të ardhura do të qëndrojnë pranë familjes së prindërve të saj dhe do të administrohen të ndara përgjithmonë nga pasuria bashkëshortore. Shtimi apo pakësimi i tyre do të bëhet me vullnetin e vetëm të K. P.. [...] Pas martesës të gjitha të ardhurat e fituara nga të dy bashkëshortët do të jenë të përbashkëta dhe do të menaxhohen me mirëkuptimin e njëri-tjetrit, i shoqëruar nga Vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.08.2008, i noteres publike M. D., i papajisur me pullë takse, si dhe nga Vërtetim i njësisë me origjinalin i aktit të dalë nga arkiva noteriale, nr. {***} rep., datë 04.09.2020, i noteres publike M. D., sipas së cilit noterja ka nxjerrë nga arkiva dokumentin e sipërcituar, të cilin e vërteton sipas ligjit, të njëjtë me kopjen në arkivë.*

63.1 Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në raport me situatën faktike të sipërcituar, trupi gjykues vëren se, pavarësisht se në deklaratat periodike të interesave dhe në deklaratën e rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij janë kujdesur të deklarojnë se pasuritë e znj. K. Q. janë *pasuri personale* të saj, ata nuk kanë deklaruar asnjëherë ekzistencën e dokumentit Aktmarrëveshje Paramartesore, datë 02.08.2008. Gjurmë të ekzistencës së këtij dokumenti nuk gjenden as në aktin “Sqarime rreth kërkesës së ILDKPKI”, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe dorëzuar pranë organit të kontrollit në datën

⁴² Shih paragrafin 76.2 të vendimit të Komisionit.

25.11.2011⁴³, me rastin e kryerjes së kontrollit të plotë të deklaratave periodike të interesave 2004-2010. Në këtë akt, subjekti i rivlerësimit, megjithëse ka dhënë sqarime të detajuara rreth kursimeve personale të bashkëshortes së tij në shumën 80.000 euro, nuk ka përmendur ekzistencën e Aktmarrëveshjes Paramartesore, edhe pse kishte kaluar një kohë e shkurtër nga hartimi dhe vërtetimi i nënshkrimit të saj para noterit publik, nga data e pretenduar më 02.08.2008. Edhe në deklaratimet, në cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme për qëllim hetimi, dhënë në datën 26.5.2014 para prokurorit, sipas procesverbalit përkatës⁴⁴, znj. K. Q., ndër të tjera, ka deklaruar se [...] *Jam martuar në muajin korrik 2008 dhe deklaramin e parë e kam bërë në fund të muajit mars 2009, kam firmosur deklaratën e pasurisë për pjesën time. Para martesë me shtetasin Arjan Qafa ne kemi diskutuar rreth pasurisë së krijuar para martesë dhe kemi rënë dakord që pasuria e fituar para martesë do jetë e ndarë nga pasuria e fituar pas martesë, marrëveshje verbale kjo e pashkruar, por e konfirmuar, pasi unë të ardhurat e mia i menaxhoj vetë [...].* Gjatë hetimit administrativ në Komision, në faza të ndryshme të tij, subjekti i rivlerësimit, megjithëse është pyetur disa herë nga Komisioni në lidhje me kursimet në *cash* të deklaruara si pasuri personale e bashkëshortes, ekzistencën e Aktmarrëveshjes Paramartesore nuk e ka deklaruar as në përgjigje të barrës së provës, por vetëm në fazën finale të procesit, pak ditë para zhvillimit të seancës dëgjimore. Arsyet mbi mungesën e deklaratimit të ekzistencës së Aktmarrëveshjes Paramartesore, në momentet procedurale të sipërcituara, subjekti i rivlerësimit nuk e ka shpjeguar as në ankim. Në përmbledhje të sa më sipër, përveç mungesës së deklaratimit të ekzistencës së kësaj aktmarrëveshje ndër vite, duke mos e gjetur të justifikuar mungesën e vëmendjes së subjektit për deklaratimin e saj në momente të tjera të rëndësishme të lidhura me vazhdimësinë e ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar, siç janë deklaratimet e personit të lidhur në organin e akuzës, si dhe plotësimi i deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, trupi gjykues i gjen të arsyeshme dyshimet e ngritura nga Komisioni se dokumenti “Aktmarrëveshje Paramartesore” nuk ka ekzistuar më parë, por është krijuar së fundmi, në një fazë të shtyrë të procesit të rivlerësimit, në funksion të nevojës për të ndryshuar rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit.

64. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *Aktmarrëveshja Paramartesore, datë 02.08.2008, konfirmuar nga noteri publik në datën 06.08.2008 është konsideruar prej tij si një akt i thjeshtë i lëshuar nga bashkëshortët dhe jo si një kontratë paramartesore, por nga Komisioni është analizuar si e tillë në kundërshtim me deklaratimet e tij.* Lidhur me sa më sipër, nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka arsyetuar: *“Nga analiza e dokumentit aktmarrëveshje paramartesore të depozituar nga subjekti si provë e re pas dërgimit të rezultateve të hetimit, duket se ajo nuk përmban elementët e përcaktuar nga Kodi i Familjes për formën e kontratës martesore. Gjithashtu, nuk u provua që ky akt të jetë depozituar në zyrën e gjendjes civile. Komisioni vlerëson se në këtë proces merr rëndësi verifikimi i ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive, qoftë edhe i pasurive të krijuara para martesë nga personi i lidhur, të vlerësuara këto, sigurisht, në mënyrë objektive dhe proporcionale në harmoni me provat dhe shpjegimet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, në raport të tillë që të krijojnë bindjen e trupit gjykues se pasqyrojnë fakte të vërteta, nisur edhe nga funksioni specifik që kanë mbajtur subjektet e rivlerësimit. Parë në këtë këndvështrim, nuk është e qartë se çfarë kërkon të provojë subjekti i rivlerësimit me depozitim të dokumentit “aktmarrëveshje paramartesore”. Nga sa më sipër, në ndryshim nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, rezultoi se Komisioni, edhe pse në pjesën arsyetuese ka bërë një vlerësim, nëse*

⁴³ Akti “Sqarime rreth kërkesës së ILDKPKI bërë më datë 25.11.2011”, i është vënë në dispozicion Komisionit nga ILDKPKI-ja me shkresë nr. {***} prot., datë 10.03.2020.

⁴⁴ Procesverbal “Për marrjen e të dhënave nga personi që tregon rrethana të dobishme për qëllim hetimi”, datë 26.05.2014, i përcjellë në Komision si pjesë e dosjes së procedimit penal nr. {***}, viti 2014”, nga Prokurori i Përgjithshëm, me shkresë nr. {***} prot., datë 19.07.2019.

Aktmarrëveshja Paramartesore përmbush elementet e kërkuar nga Kodi i Familjes, në përfundim ka theksuar paqartësinë e subjektit në lidhje me atë se çfarë ka dashur të provojë me këtë akt. Trupi gjykues vëren se kjo paqartësi, lidhur me pasojat e aktmarrëveshjes mes tij dhe personit të lidhur dhe fuqinë juridike të saj, reflektohet edhe në pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim.

65. Në verifikim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se *në zbatim të nenit 74 të Kodit të Familjes, Komisioni nuk mund t'i kërkonte llogaridhënie subjektit të rivlerësimit, për veprime të kryera para nisjes së bashkëjetesës, e cila përkon me datën e lidhjes së martesës, pasi pasuria e personit të lidhur është deklaruar gjithmonë si pasuri e ndarë në deklaratat e pasurisë dhe sipas përcaktimeve që bën Kodi i Familjes për pasurinë bashkëshortore, ajo nuk mund të konsiderohet si e tillë, sepse vetëm bashkëshortja është titullare e të drejtave të sendeve të luajtshme të fituara prej saj para martese*, trupi gjykues vëren se me referimin në dispozitën ligjore të sipërcituar⁴⁵, subjekti i rivlerësimit ka pranuar se ai dhe bashkëshortja e tij i nënshtrohen regjimit pasuror martesor në bashkësi, parashikuar nga Kodi i Familjes në kreun II, nenet 73-107. Në mbështetje të këtij fakti, si edhe faktit të provuar nga hetimi administrativ i Komisionit se subjekti i rivlerësimit është bashkëpronar në pjesë të barabarta me bashkëshorten në pasurinë e llojit tokë “arë”, në {***}, Durrës, me burim krijimi të deklaruar të ardhurat personale të bashkëshortes, trupi gjykues vlerësoi se Komisioni ka qenë krejtësisht i legjitimuar të kontrollojë ligjshmërinë e burimeve të krijimit të të ardhurave të personit të lidhur, si një veprim i detyrueshëm hetimor, në funksion të kontrollit të burimeve të krijimit të pasurisë në pronësi të subjektit e në përmbushje të parashikimit kushtetues dhe ligjor të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Përpos kësaj, dhe çka është më e rëndësishmja, të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, të krijuara para martese e të deklaruara si kursime *cash* të disponuara veçmas prej saj, janë deklaruar periodikisht në formularin përkatës “Deklaratë e interesave private e personit të lidhur”, i cili është një formular që plotësohet dhe nënshkruhet nga personi i lidhur për pasuritë që disponohen veçmas, si dhe në deklaratën e rivlerësimit, në formularin “Deklaratë e pasurisë e personit të lidhur”. Me plotësimin dhe nënshkrimin e secilit prej formularëve të sipërcituar, znj. Q. ka autorizuar ILDKPKI-në dhe më tej dhe institucionet e rivlerësimit që të verifikojnë pasuritë, interesat private dhe detyrimet që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë e saj. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, kanë qenë të qartë se në zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2015, institucionet e rivlerësimit kanë detyrimin të kontrollojnë pasuritë e tyre e, për pasojë, nëse është rasti edhe të ngarkojnë me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit.
66. Në përfundim, në vijim të jurisprudencës së Kolegjit⁴⁶, trupi gjykues thekson se objekt kontrolli dhe vlerësimi në procesin e rivlerësimit, në zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, janë pasuritë e subjekteve të rivlerësimit, si dhe ato të personave të lidhur, pavarësisht nga fakti nëse pasuritë e tyre janë ose jo në bashkëpronësi. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se argumentet e subjektit të rivlerësimit, për këtë shkak ankimi, u gjetën të pabazuara në ligj.

⁴⁵ Neni 74 i Kodit të Familjes përcakton se: “Bashkësia përbëhet nga: (a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës; (b) të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; (c) frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; (ç) veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës. Në rast se veprimtaria tregtare para lidhjes së martesës i përkiste vetëm njërit prej bashkëshortëve, por gjatë martesës drejtohet nga të dy bashkëshortët, bashkësia përfshin vetëm fitimet dhe shtimin e prodhimit”.

⁴⁶ Shih vendimin e Kolegjit nr. 11/2022, datë 27.04.2022, paragrafët 30.8-30.9.

67. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *konkluzioni i Komisionit, lidhur me të ardhurat e personit të lidhur të deklaruar të përfituara nga interesat e huave, është i gabuar, pasi nuk mbështetet në ligj dhe duhet ndryshuar nga Kolegji, duke bërë vlerësimin e duhur të provave të paraqitura gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi si vijon.*
68. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar, si më poshtë.
*Të ardhura të mia personale, nga kontratë huaje, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2009, me interes në shumën 75.000 lekë/muaj. Në tërësi për vitin 2009 në shumën 900.000 lekë.
 Të ardhura nga kontratë huaje, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2010, me interes në shumën 75.000 lekë/muaj. Në tërësi për vitin 2010 në shumën 900.000 lekë.
 Të ardhura të mia personale, nga kontratë huaje, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.02.2011, me interes në shumën 100.000 lekë/muaj. Në tërësi për vitin 2011 në shumën 1.200.000 lekë.
 Të ardhura të mia personale, nga kontratë huaje, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.02.2012, me interes në shumën 125.000 lekë/muaj. Në tërësi për vitin 2012 në shumën 1.500.000 lekë.
 Të ardhura të mia personale, nga kontratë huaje, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2012, në shumën 10.000 euro, me interes për dy muaj. Në tërësi për dy muaj në shumën 1.000 euro.
 Të ardhura të mia personale, nga kontratë huaje, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.01.2011, me interes në shumën 100.000 lekë/muaj. Në tërësi për vitin 2013 në shumën 1.200.000 lekë.
 Kontratë huaje, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.01.2013, pa interes, në shumën 17.500 euro nga të ardhurat e mia. Kthyer po brenda afatit e konfirmuar me deklaratën noteriale të datës 09.09.2013.
 Të ardhura të mia personale, nga kontratë huaje me nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 07.02.2014, me interes në shumën 900.000 lekë/muaj për 6 muaj. Në tërësi për 6 muaj në shumën 540.000 lekë.
 Të ardhura të mia personale, nga kontratë huaje, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.03.2015, me interes në shumën 200 euro/muaj. Në tërësi për vitin 2015 në shumën 2.400 euro.
 Nuk kam gjendje faktike të të ardhurave të mia personale, veç detyrimeve që më poshtë janë pasqyruar.*
69. Në funksion të këtij deklarami, subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, ka paraqitur kontratat e huas së lidhura përpara noterit publik, mes personit të lidhur dhe huamarrësve, përkatësisht z. S. V. dhe znj. E. M. Z..
70. Sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, dhënë në përgjigje të pyetjeve të drejtuara nga Komisioni⁴⁷, shuma prej 80.000 euro, e deklaruar si kursim në *cash*, në deklaratën e interesave të vitit 2008, deklarimi për herë të parë i bashkëshortes së tij, e copëzuar në periudha të ndryshme, ka qenë objekt i kontratave të huave me interes, të lidhura nga personi i lidhur. Në kushtet kur rezultoi e provuar se për të ardhurat e deklaruar si burim krijimi i kësaj shume, subjekti i rivlerësimit gjendej në kushtet e deklarimit të rremë, pasi nuk arriti të provonte ekzistencën e marrëdhënies së punës⁴⁸ dhe as të ardhurat e përfituara prej saj, trupi gjykues arriti në përfundimin se edhe të ardhurat nga interesat e përfituara nga kontratat e sipërcituara, nuk plotësojnë kushtet për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika

⁴⁷ Në përgjigjen e përcjellë në Komision, më datë 03.03.2020.

⁴⁸ Pranë shoqërisë "{***}" ShPK, në Shkodër dhe pranë Personit Fizik "{***}", në Lezhë.

3 e Aneksit të Kushtetutës. Ky konkluzion do të jetë i përdorshëm, sërish, prej trupit gjykues, në vijim të analizës për zgjidhjen e çështjes. Trupi gjykues vëren se edhe nëse pretendimet e tjera të subjektit të rivlerësimit do të konsideroheshin të drejta, përfundimi i mësipërm i bën ato jorelevante në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit, lidhur me të ardhurat e përfituara nga kontratat e huave me interes të lidhura nga bashkëshortja. Pavarësisht kësaj, me qëllim shterimin e shkaqeve të ankimit, trupi gjykues vendosi të verifikojë pretendimet e tjera të subjektit të rivlerësimit.

71. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *detyrimet tatimore për të ardhurat e realizuara nga interesat provohet se janë paguar rregullisht dhe, për pasojë, ato duhet të konsideroheshin në analizën financiare të Komisionit, si dhe fakti i pagesës së detyrimeve nga huamarrësi ka qenë pjesë e bisedimit të palëve në kohën e hartimit të kontratave dhe janë paguar nga ai*, trupi gjykues vëren se gjatë hetimit të kryer nga ILDKPKI-ja ka rezultuar se me shkresën nr. {***} prot., datë 02.03.2018, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka informuar se për individët Arjan Qafa, K. Q., S. V. dhe E. M./Z. nuk ka të dhëna për pagesë të tatimit mbi të ardhurat nga interesat dhe nuk janë të regjistruar për deklaratën “Tatimi mbi të ardhurat individuale” (DIVA). Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës, shkresën nr. {***} prot., datë 01.06.2020, e të njëjtit institucion, drejtuar znj. K. Q., sipas së cilës, *për kontratat e huas [...] me huamarrës S. V. rezulton që individi S. V. është i regjistruar për DIVA, ka deklaruar dhe ka kryer pagesa për vitet 2011-2016, në zërin [14] Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart, në vlerat përkatëse, si dhe për kontratat e huas me huadhënës K. Q. dhe huamarrës E. Z., individi K. Q. është regjistruar për DIVA, ka deklaruar dhe ka kryer pagesa që i përket tatimit nga të ardhura bruto të tjera (sipas deklaramit individual) përkatësisht për vitin 2012 në shumën 48.816 lekë dhe për vitin 2013 në shumën 40.959 lekë.*

Bashkëlidhur kësaj shkrese, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka përcjellë deklaratat e tatimit mbi të ardhurat individuale të z. S. V., nga të cilat rezultoi se deklaratat për vitet 2011-2016 janë plotësuar për z. V. në datën 27.12.2018. I njëjti institucion ka përcjellë deklaratat e tatimit mbi të ardhurat individuale të znj. K. Q., nga të cilat rezulton se deklaratat për vitin 2013 dhe 2014 janë plotësuar për znj. Q. në datën 27.12.2018. Për plotësimin e deklaratave të të dy individëve z. V. dhe znj. Q. është loguar në sistemin C@TS i njëjti individ, - znj. M. B. Në këto rrethana, trupi gjykues vëren se në ndryshim nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, detyrimet tatimore për interesat e përfituara nga huat nuk janë paguar *rregullisht*, por janë paguar kohë më vonë nga lindja e detyrimit, deklaratat janë plotësuar nga i njëjti individ i tretë për dy individë të ndryshëm, madje edhe në të njëjtën datë, fakte këto që mbështesin arritjen e konkluzionit se pagesat janë kryer posaçërisht për efekt të procesit të rivlerësimit. Në vijim të këtij arsytimi dhe për sa kohë nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni nuk u konstatua asnjë fakt, i cili të provonte se mospagesa e tatimit në kohë, për vlerën e përfitur nga interesat e huave ishte jo për faj të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se pagesa me vonesë e tyre nga znj. Q. nuk mund të mundësojë legjitimimin e të ardhurave të krijuara.

Referuar legjislacionit tatimor të kohës, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar,⁴⁹ trupi gjykues vëren se detyrimi për pagimin në burim

⁴⁹ Neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, parashikon: “Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 15 për qind nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë: a) dividendët; b) ndarjet e fitimit; c) interesat; ç) pagesat për të drejtat e autorit dhe për pronësinë intelektuale; d) pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit; dh) pagesat për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues; e)

të tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga interesat e huave, i përkiste znj. K. Q.. Nga të dhënat e përcjella nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, rezultoi se në ndryshim nga parashikimi ligjor, pagesa e tatimit në burim është kryer nga huamarrësi z. S. V.. Lidhur me pretendimin e subjektit se pagesat e tatimit në burim për të ardhurat nga interesat e huave nga huamarrësi z. V. kanë qenë pjesë e bisedimit të palëve në kohën e hartimit të kontratave, nga verifikimi i përmbajtjes së kontratave të huave në fjalë, rezultoi se në to nuk gjendet një parashikim që të reflektojë këtë dakordësi të palëve. Në vlerësimin në harmoni të fakteve të analizuara, trupi gjykues evidentoi përpjekjen e subjektit të rivlerësimit për të zhvendosur detyrimin për pagimin e detyrimit të pala tjetër kontraktore e, për pasojë, shmangien e përgjegjësisë nga personi i lidhur, për efekt të procesit të rivlerësimit. Në vlerësimin e trupit gjykues, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk shëron paligjshmërinë e së ardhurës së verifikuar, në kuptim të nenit D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

72. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se *hidhet poshtë çdo dyshim i Komisionit se kjo pasuri është deklaruar fiktivisht, pasi formë e materializimit të të ardhurave janë kontratat e lidhura pranë një institucioni publik*, trupi gjykues vëren se marrëdhënia e huadhënies mes personit të lidhur dhe z. S. V. ka filluar me lidhjen e kontratës së huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2009, sipas së cilës znj. K. Q. i jep hua z. S. V. shumën 5.000.000 lekë, me afat 1-vjeçar [31.01.2009-30.01.2010], me interes 1.5% /muaj ose 75.000 lekë. Në këtë kontratë parashikohet, ndër të tjera, se: *Palët deklarojnë se në momentin e nënshkrimit të këtij akti është bërë dorëzimi i vlerës prej 5.000.000 lekësh nga huadhënësja te huamarrësi. Dorëzimi u bë në prani të noterës.* Kontratat vijuese të huas të lidhura mes znj. K. Q. dhe z. S. V. janë ripërtëritje e kontratës së cituar më sipër.

Marrëdhënia e huadhënies me znj. E. Z. është krijuar me lidhjen e kontratave nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.01.2013, për shumën 17.500 euro; nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.08.2012, për shumën 13.000 euro; nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2012, për shumën 10.000 euro; dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.07.2013, për shumën 20.000 euro. Në secilën prej këtyre kontratave palët kanë deklaruar se *në momentin e nënshkrimit të këtij akti është dorëzuar shuma nga huadhënësi tek huamarrësi.* Pavarësisht këtyre konstatimeve, trupi gjykues vëren se Komisioni në vendim⁵⁰, duke u shprehur se *[...] trupi gjykues ngre dyshime të arsyeshme se kemi të bëjmë me kontrata fiktive huaje, të cilat nuk kanë sjellë si pasojë asnjë efekt financiar konkret për subjektin e rivlerësimit/personin e lidhur. Në këtë kuptim, në analizën financiare nuk janë përfshinë të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga interesat e këtyre huave për sa kohë burimi i shumave të pretenduara si të dhëna hua, në çdo rast, nuk ka rezultuar i ligjshëm, sipas parashikimeve të dispozitave ligjore përkatëse, nuk ka arritur në konkluzion përfundimtar lidhur me fiktivitetin, por ka mbetur vetëm në kuadrin e dyshimeve të arsyeshme, duke i dhënë peshë mbështetëse në arsyetim konkluzionit se për të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga interesat e këtyre huave, burimi i krijimit të shumave të pretenduara si të dhëna hua, në çdo rast, nuk ka rezultuar i ligjshëm, sipas parashikimeve të dispozitave ligjore përkatëse, konkluzion ky që u gjet i drejtë dhe nga arsyetimi i bërë në këtë vendim. I njëjti arsyetim e qëndrim vlen edhe për pretendimin tjetër të subjektit se konkluzionet*

pagesat për ndërtimin, instalimin, montimin ose për punë mbikëqyrëse që lidhen me to; ë) pagesat për qiratë; f) pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve, përfshirë pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artistë ose sportistë apo ndërmjetësojnë për shfaqjet e tyre. g) të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë”.

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në pikën 2.6.4 parashikon: “Për të ardhura të realizuara nga burime jashtë Shqipërisë dhe/ose të paguara nga persona të cilët nuk mund të bëjnë mbajtjen e tatimit në burim për llogari të organeve tatimore Shqiptare, përfituesi i të ardhurave është i detyruar të deklarojë dhe të paguajë në organin tatimor përkatës tatimin në masën 15 përqind të të ardhurave të realizuara jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa”.

⁵⁰ Shih paragrafin 78.1 të vendimit të Komisionit.

se kontratat kanë pasur interesa të larta janë të gabuara dhe se argumentet ligjore të normës së interesit të këtyre huave të paraqitura, nga subjekti i rivlerësimit nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni.

73. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit, *konkluzionet e Komisionit për pasurinë tokë bujqësore në fshatin {***}, pasuri veçmas e personit të lidhur, nuk janë të mbështetura në prova dhe janë të paarsyetuara dhe se të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit janë paragjykuar e janë transformuar faktet në mënyrë diskriminuese*, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim⁵¹, në përfundim të kontrollit për pasurinë “tokë bujqësore në fshatin {***}, pasuri e deklaruar veçmas nga personi i lidhur”, ka arsytuar: *Komisioni, më sipër ka kryer analizë të detajuar për ligjshmërinë e të ardhurave që pretendohet se kanë mundësuar krijimin e pasurisë në formë likuiditetesh cash të deklaruara nga personi i lidhur në deklaratën periodike të vitit 2008 (deklarimi për herë të parë i personit të lidhur për shkak të lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit). Nga analiza e kryer, Komisioni arriti në përfundimin se personi i lidhur nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë në formë likuiditetesh cash deklaruar në vitin 2008 në vlerën prej 80.000 eurosh. Si rrjedhim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, pasi nuk provon ligjshmërinë e burimeve financiare për blerjen e kësaj pasurie (pasuri kjo e regjistruar në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij), deklaruar me burime nga të ardhurat dhe kursimet e personit tjetër të lidhur.*
74. Në kundërshtim të arsytimit dhe konkluzionit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka pretenduar se Kolegji, nëse do të analizojë të ardhurat e personit të lidhur me të, do të dalë me konkluzion të ndryshëm. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë provat e paraqitura prej tij lidhur me të ardhurat e bashkëshortes, madje në mënyrë diskriminuese ka mohuar edhe pagat e marra prej saj në institucionet publike, të cilat janë deklaruar në vite prej saj, duke i anashkaluar në heshtje, vetëm për të justifikuar vendimin.
75. Në analizë të këtij shkakun ankimi, nga analiza e akteve të administruara, rezultoi se situata faktike, lidhur me marrëdhënien e personit të lidhur me pasurinë objekt kontrolli “tokë bujqësore, në fshatin {***}”, paraqitet si vijon.
Me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.03.2015, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. K. Q., ka blerë pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3843,5 m², që ndodhet në fshatin {***}, Durrës, kundrejt çmimit 10.000 USD, vlerë e cila është likuiduar nga blerësja me kalim në llogarinë e noteres publike, në Bankën Kombëtare Tregtare, në datën 12.03.2015. Sipas të dhënave të kartelës së pasurisë⁵², pasuria “tokë arë”, me sipërfaqe 3843,5 m², me nr. pasurie {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, është regjistruar ZVRPP-në Durrës, në datën 20.03.2015, në bashkëpronësi, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij.
Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratën e pasurisë së vitit 2015, personi i lidhur ka deklaruar krijimin e kësaj pasurie, me burim krijimi të ardhurat personale të deklaruara në vite, në pjesë takuese 100%.
76. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se *Komisioni në mënyrë diskriminuese ka mohuar edhe pagat e marra prej bashkëshortes në institucionet publike, të cilat janë deklaruar në vite prej saj, duke i anashkaluar në heshtje, vetëm për të justifikuar vendimin*, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim është i pambështetur në prova, pasi në analizën financiare për çdo pasuri, përfshirë edhe pasurinë objekt kontrolli, të pasqyruar në vendim, Komisioni ka

⁵¹ Shih paragrafin 90.1 dhe 90.2 të vendimit të Komisionit.

⁵² Kartela e pasurisë së sipërcituar është përcjellë në Komision nga ZVRPP-ja Durrës, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.02.2019.

konsideruar të ardhurat nga pagat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga punësimi në periudhat 2008-2016, duke u evidentuar si zë më vete. Edhe në analizën financiare për të verifikuar mundësinë e krijimit të kursimit në *cash* prej 70.000 eurosh⁵³, të kryer deri në datën 31.12.2008, Komisioni ka konsideruar, në zërin “Të ardhurat nga pagat e personit të lidhur”, shumën 1.082.478 lekë, e cila i korrespondon vlerës totale të të ardhurave të përfituara nga pagat si mësuese në fshatin {***}, Lezhë, sipas të dhënave të vërtetimeve të pagave, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit. Gjithashtu, në ndryshim nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se Komisioni, edhe në analizën lidhur me ecurinë e gjendjes së kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit, ka referuar se në vendim se *në kursimet cash në fund të vitit 2008 janë përfshirë kursimet e deklaruara prej subjektit të rivlerësimit në shumën 794.664 lekë, si dhe shuma prej 477.252 lekësh që përfaqëson shumën që ka pasur mundësi të kursejë bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ.*

77. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Kolegji, nëse do të analizojë të ardhurat e personit të lidhur me të, do të dalë me konkluzion të ndryshëm, trupi gjykues nënvizon përfundimin e arritur më sipër në këtë vendim, sipas së cilit kursimet në *cash* të deklaruara nga personi i lidhur në shumën prej 80.000 eurosh, si dhe të ardhurat e përfituara nga interesat e dhënies si hua të kësaj shume, nuk plotësojnë kriteret e të ardhurave të ligjshme, sipas parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës e, për pasojë, nuk mund të përfshihen në zërat e analizës financiare për verifikimin e pasurisë objekt kontrolli.
78. Në këto kushte u konfirmua konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 10.000 USD ose 1.266.400 lekë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
79. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit, *konkluzionet e Komisionit për pasurinë apartament banimi në Kashar, Tiranë, pasuri veçmas e personit të lidhur, nuk janë të mbështetura në prova dhe vendimi është i paarsyetuar, i pakuptueshëm dhe diskriminues e në shkelje të të drejtave për një proces të rregullt ligjor*, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim⁵⁴, ka arsyetuar: *Nga analiza e kryer, Komisioni arriti në përfundimin se personi i lidhur nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë në formë likuiditetesh cash deklaruar në vitin 2008, në vlerën prej 80.000 euro. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë me qëllim evidentimin e mundësisë për kryerjen e pagesës prej 81.941 eurosh, deri më 13.01.2017, paguar si çmim për blerjen e apartamentit në {***}, Kashar. Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në deklaratën vetting kanë kryer deklarim të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri, pasi nuk kanë deklaruar burimin e krijimit të saj. Gjithashtu, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht kryerjen e pagesës prej 81.941 eurosh, deri më 13.01.2017, për blerjen e pasurisë së llojit “apartament” të ndodhur në {***}, Kashar.*
80. Në kundërshtim të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar se ka dokumentuar me burime financiare të ligjshme pasuritë e deklaruara nga bashkëshortja në deklaratën fillestare të pasurisë që është e njëjtë me deklaratën e rivlerësimit. Në analizën financiare të vitit 2016 rezulton e provuar se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur

⁵³ Shuma prej 80.000 eurosh e deklaruar si kursim në *cash* nga personi i lidhur në vitin 2008, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, përbëhej nga 70.000 euro kursimet nga pagat dhe interesat e shumës prej 2.500.000 lekësh të dhëna hua, si dhe nga 10.000 euro dhuratë nga familjarët me rastin e martesës.

⁵⁴ Shih paragrafët 93.1-93.3 të vendimit të Komisionit.

mundësi financiare për pronotimin e apartamentit, duke përdorur kursimet e krijuara nga kontratat e huave, të cilat janë të krijuara me burime të ligjshme dhe për të cilat është paguar tatimi mbi të ardhurat në burim.

81. Në analizë të këtij shkakut ankimi, nga analiza e akteve të administruara, në lidhje me pasurinë objekt kontrolli “apartament banimi në Kashar, Tiranë”, trupi gjykues konstatoi se pasuria e ka origjinën nga kontrata e porosisë, datë 05.01.2016, me palë sipërmarrëse shoqëria “{***}” ShPK dhe palë porositëse, znj. K. Q., me objekt shitjen e një apartamenti, me sipërfaqe totale 159,35 m², në {***}, Kashar, për çmimin 82.862 euro, i cili është paguar me këste, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës e deri në datën 13.01.2017.

Në deklaratën e interesave të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar si burim financiar për krijimin e pasurisë të ardhurat e personit të lidhur të deklaruara ndër vite, si dhe shumën prej 700.000 lekësh nga të ardhurat familjare të kursyera pas vitit 2011.

Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, personi i lidhur ka deklaruar: *Prenotim apartamenti me sip. 159,35 m², në shumën 82.862 euro. Likuiduar shuma 81.941 euro. Detyrim shuma 921 euro. Ndërkohë për plotësimin e kësaj shume janë përdorur shuma prej 700.000 lekësh nga të ardhurat familjare të kursyera pas vitit 2011.*

Nga sa më sipër, trupi gjykues vëren se me të drejtë Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar burimin e krijimit të pasurisë për pjesën më të madhe të investimit, duke u gjendur në kushtet e deklaramit të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

81.1 Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se bashkëshortja ka pasur mundësi financiare për pronotimin e apartamentit, duke përdorur kursimet e krijuara nga të ardhurat e përfituara nga kontratat e huave, të cilat janë të krijuara me burime të ligjshme dhe për të cilat është paguar tatimi mbi të ardhurat në burim, i cili është i vetmi pretendim i ngritur prej tij për sa i përket pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues nënvizon konkluzionin e arritur më sipër në këtë vendim, sipas të cilit, të ardhurat nga interesat e përfituara nga kontratat e huave të lidhura nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, me z. S. V. dhe znj. E. M. Z., nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, gjendet i drejtë qëndrimi i Komisionit se shuma e interesave të huave e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit nuk plotëson kushtet për t’u përfshirë në analizën financiare, për verifikimin e mundësisë së personit të lidhur për të krijuar pasurinë objekt kontrolli. Nga verifikimi i analizës financiare të kryer në Komision, për mundësinë e krijimit me të ardhura të ligjshme të shumës prej 81.941 eurosh ose 11.052.839 lekësh për blerjen e pasurisë objekt kontrolli, u konfirmua konkluzioni se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 8.455.993 lekë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

81.2 Për sa i përket pretendimeve të tjera të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues i gjeti ato jorelevante për kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit lidhur me pasurinë objekt kontrolli.

82. Trupi gjykues mori në shqyrtim, gjithashtu, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me anë të të cilave ai ka kundërshtuar rezultatet e analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2003 -2016. Në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, nga analiza ekonomike e kryer, është konkluduar që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen/krijimin e pasurive, investimet e realizuara, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitet 2010, 2014, 2015 dhe

2016, të cilat paraqiten me balancë negative të fondeve (ku përfshihet edhe analiza e kryer për vitet në të cilat është analizuar më vete krijimi i asetëve në momentin e kryerjes së pagesave), dhe konkretisht: (i) për vitin 2010, balanca negative e fondeve (-) 3.149.461 lekë; (ii) për vitin 2014, balanca negative e fondeve (-) 316.940 lekë; (iii) për vitin 2015, balanca negative e fondeve (-) 1.217.383 lekë; dhe (iv) për vitin 2016, balanca negative e fondeve (-) 8.093.418 lekë.

83. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni duke pretenduar se *situata financiare e paraqitur nga ky i fundit nuk i përgjigjet realitetit, pasi nuk janë përllogaritur saktë të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe ato të personit të lidhur, të cilat janë deklaruar e vërtetuar me prova shpresore; nuk janë përllogaritur saktë shpenzimet e jetesës, pasi ato janë përballuar nga produktet bujqësore e blegtorale të nxjerra nga toka bujqësore në {***}, Kurbin; si dhe nuk janë përllogaritur drejt dhuratat e dhëna nga të afërmit e tij emigrantë.*
84. Në analizë të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se pretendimet e tij, lidhur me të ardhurat e përfituara nga pagat nga personi i lidhur, në periudhën 2000-2008, pranë shoqërisë “{***}” SHPK dhe Personit Fizik “{***}”, janë trajtuar në detaje më sipër në këtë vendim, nga ka rezultuar se ato nuk plotësojnë kushtet për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme e, për pasojë, është i drejtë qëndrimi i Komisionit për mospërfshirjen e tyre në zërin e të ardhurave në analizën financiare. Për sa i përket të ardhurave të përfituara nga pagat nga subjekti i rivlerësimit, nga kontrolli i të dhënave të pasqyruara në analizën financiare të kryer nga Komisioni, rezultoi se ato janë pasqyruar saktë në përputhje me të dhënat e referuara në vërtetimet e institucioneve pranë të cilave ka qenë i punësuar subjekti i rivlerësimit në vite, paraqitur prej tij si dokumentacion mbështetës i deklaratës së rivlerësimit. Të njëjtin qëndrim, trupi gjykues mbajti edhe për të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit në formën e dhuratave nga të afërmit e tij, të cilat janë trajtuar gjerësisht më sipër në këtë vendim, nga rezultoi se vetëm dhurimet e znj. V. K dhe znj. A. P., janë dhurime të krijuara me burime të ligjshme, për pasojë vetëm këto të ardhura do të bëhen pjesë e përllogaritjeve në zërin përkatës së analizës financiare.
85. Sa i takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se shpenzimet e jetesës janë përballuar nga produktet bujqësore e blegtorale të përfituara nga toka bujqësore në fshatin {***}, trupi gjykues vëren se ky është një pretendim i paraqitur për herë të parë në ankim dhe nuk është paraqitur para Komisionit si një fakt për t’u verifikuar prej tij, duke u konsideruar si një pretendim i rënë në dekadencë, sipas parashikimit të nenit 459, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile⁵⁵. Trupi gjykues vlerësoi se mungesa e dukshme e koherencës e shfaqur nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet e tij edhe për sa i përket shpenzimeve të jetesës, duke ndryshuar mënyrën e mbulimit të tyre në varësi të rezultatit të vendimit të Komisionit, e bën të pabesueshëm edhe në këtë kuptim pretendimin e ngritur në ankim se këto shpenzime janë mbuluar nga produktet blegtorale. Për më tepër, që nga verifikimi i analizës financiare të paraqitur në Kolegj nga vetë subjekti i rivlerësimit, shpenzimet e jetesës janë përllogaritur prej tij sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në INSTAT dhe jo më të ulta.
86. Trupi gjykues verifikoi shpenzimet e jetesës të përllogaritura nga Komisioni për vitin 2010, në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se, për këtë vit, këto shpenzime janë përllogaritur dy herë, kur duhet të ishin llogaritur vetëm sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në INSTAT, në shumën 409.860 lekë. Nga verifikimi rezultoi se Komisioni, në bazë të deklaratimit të subjektit në deklaratën e vitit 2010 se paga e bashkëshortes në shumën 490.000

⁵⁵ Nenit 459, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile, parashikon se: “Në ankim nuk mund të parashtrihen kërkime të reja që nuk janë parashtruar në gjykimin në shkallë të parë”.

lekë është shpenzuar gjatë vitit nga nevojat familjare, ka përlllogaritur këtë shumë si shpenzime jetese duke ia shtuar shpenzimeve standarde të jetesës për vitin 2010. Duke e gjetur pjesërisht të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmoi se, për këtë vit, shpenzimet e jetesës duhet të ishin llogaritur në shumën 490.000 lekë, sa janë deklaruar prej subjektit të rivlerësimit. Edhe për vitin 2015, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur nga Komisioni për një familje me pesë persona, ndërkohë që duhet të ishin përlllogaritur në shumën 953.173 lekë, pasi në këtë vit familja e tij përbëhej nga katër persona deri në muajin tetor, kur ka lindur fëmija i tretë. Trupi gjykues, në verifikim të këtij pretendimi, e gjeti të drejtë atë, për pasojë analiza financiare e vitit 2015 është korrigjuar dhe shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur në vlerën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.

87. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për periudhën 2003-2016, mbi përfundimet e arritura si më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, gjenden në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen/krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara: për vitin 2010 në shumën 1.107.301 lekë; për vitin 2014 në shumën 316.941 lekë; për vitin 2015 në shumën 1.049.176 lekë; dhe për vitin 2016 në shumën 8.093.418 lekë. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjenden në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

D. Vlerësimi lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të figurës

88. Në vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, Komisioni, në vendim⁵⁶, ka arritur në konkluzionin se *nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të jetë në kushtet e pikës 2 apo 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, vlerëson se ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, porse konstatimet e gjetura gjatë hetimit mund të vlerësohen në tërësi të çështjes brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.* Më tej, në vlerësimin në tërësi të rezultateve të hetimit administrativ⁵⁷, Komisioni ka çmuar se *veprimet e subjektit të rivlerësimit, të vlerësuara në tërësinë e tyre, cenojnë rëndë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
89. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar këtë përfundim të Komisionit, duke parashtruar pretendimet, të cilat u analizuan nga trupi gjykues, si vijon.
90. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *veprimet e Komisionit, gjatë hetimit administrativ lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, kanë qenë diskriminuese, të nxitura me qëllim arritjen e vendimmarrjes, duke mos analizuar drejt provat e paraqitura nga DSIK-ja të cilat kanë qenë kontradiktore*, trupi gjykues, në verifikim të rrethanave faktike, vëren se Komisioni, në vendim, ka referuar se DSIK-ja ka dërguar në datën 02.11.2017 raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Arjan Qafa, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për këtë subjekt rivlerësimi. Ky raport i referuar nga Komisioni nuk është pjesë e dokumentacionit të përcjellë nga Komisioni në Kolegj. Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi se me shkresën nr. {***} prot., datë 17.04.2020, është përcjellë nga DSIK-ja në Komision, raporti për kontrollin e figurës nr. {***} prot., datë 09.03.2020, i deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. {***}, datë 14.04.2020, me konstatimin për *papërshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit*. DSIK-ja ka sqaruar se ky raport, me konstatimin për papërshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Arjan Qafa, përcillet në Komision në bazë të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016,

⁵⁶ Paragrafi 97.7 i vendimit të Komisionit.

⁵⁷ Paragrafi 101 i vendimit të Komisionit.

me qëllim integrimin e informacioneve të ardhura nga autoritetet verifikuese, të ardhura pas afatit ligjor të përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për kontrollin e figurës, për këtë subjekt rivlerësimi. Gjithashtu, DSIK-ja ka referuar se ky raport përcillet në përgjigje të kërkesës së Komisionit nr. {***} prot., datë 16.10.2019, me lëndë “Kërkesë për përditësimin dhe deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””. Në shkresën e referuar si më sipër, Komisioni i ka kërkuar DSIK-së përditësimin e raportit nr. {***} prot., datë 02.11.2017, për vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me informacione shtesë që disponohen prej datës 02.11.2017 e deri më datën e administrimit të shkresës së Komisionit.

91. Në analizë të pretendimit të subjektit në raport me rrethanat faktike të pasqyruara si më sipër, trupi gjykues vlerësoi se DSIK-ja në rishikimin e raportit dhe Komisioni në administrimin e këtij raporti të dytë për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit kanë vepruar brenda kompetencave kushtetuese e ligjore, pasi autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës është Komisioni që vepron në bashkëpunim me DSIK-në, bazuar në parashikimin e nenit 36, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe arsyetimin e bërë nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017⁵⁸. Grupi i Punës pranë DSIK-së ka përgjegjësi ligjore të luajë rol aktiv në kontrollin e figurës e të vlerësojë të gjithë informacionin që i përcillet nga organet verifikuese të përfshira në procesin e rivlerësimit, në funksion të rolit ndihmës për organet e rivlerësimit, në drejtim të marrjes së një vendimi përfundimtar në procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit. Nga ana tjetër, rishikimi i raporteve fillestare të DSIK-së, pasi janë marrë informacione plotësuese nga institucionet verifikuese, është tashmë një praktikë e rregullt që i shërben verifikimit të plotë dhe të detajuar të kontrollit të figurës. Por pavarësisht kësaj, nga përmbajtja e vendimit, konstatohet se Komisioni i ka mbështetur konkluzionet për kontrollin e figurës në verifikimin që ka kryer vetë, bazuar në të dhënat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, mbi rezultatet e të cilave i ka kaluar edhe barrën e provës subjektit të rivlerësimit. Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se *Komisioni ju bën me dije s, konkluzionet e raportit të kontrollit të figurës do të vlerësohen në raport me çështjet profesionale të pasqyruara në këto rezultate hetimi në rubrikën “Gjetje të tjera”*. Në përfundim, në vendim, Komisioni ka arsyetuar dhe konkluduar mbi gjetjet për këtë kriter. Konstatimi i Grupit të Punës së DSIK-së nuk ka qenë vendimtar në konkluzionet e Komisionit për vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, pasi Komisioni ka vlerësuar se informacionet, të dhënat dhe dyshimet e ngritura nuk ishin të mjaftueshme për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e detyrës e, si të tilla, nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 2, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, por do të vlerësoheshin në tërësi të çështjes lidhur me rivlerësimin e subjektit, z. Arjan Qafa, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.
92. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *raporti i DSIK-së, nr. {***} prot., datë 02.11.2017, i cili ka konstatuar përshtatshmërinë e tij për vazhdimin e detyrës, në unison me shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme, sipas së cilës nuk ka indicie që subjekti të ketë cenim*

⁵⁸ Në vendimin nr. 2/2017, Gjykata Kushtetuese, shprehet se: “Gjykata vlerëson se institucionet kushtetuese të rivlerësimit kanë autoritetin për të ruajtur një kontroll të plotë mbi procesin e verifikimit të figurës, si dhe për të pasur akses tek të gjitha materialet përkatëse. [...] Sipas nenit 14 të ligjit (nr. 84/2016) relatori në çdo rast duhet të ndërmarrë të gjitha procedurat për të siguruar provat e nevojshme për procesin e vendimmarrjes së trupës gjykuese. [...] Në përfundim, gjykata vlerëson se dispozitat e ligjit garantojnë aksesin në të gjithë informacionin dhe dokumentet e disponuara nga grupi i punës, dhe garantojnë kontrollin efektiv mbi veprimtarinë e grupeve të punës nga Komisioni. Organet e tjera, të cilat janë të përfshira në procesin e rivlerësimit, kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale që kanë për qëllim të ndihmojnë institucionet kushtetuese në përmbushjen e mandatit të tyre. Në të gjitha rastet, autoriteti vendimmarrës mbetet tek organet e rivlerësimit (Komisioni dhe Kolegji) të krijuara për këtë qëllim në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme”.

të figurës, qëllimisht nuk i është bashkëngjitur dosjes së rivlerësimit nga Komisioni, në vijim të formave të presionit politik që përfaqëson trupa gjyquese, e cila ka vepruar në konflikt interesi, trupi gjyqes vëren se Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 29.07.2020, ka vendosur të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit e në vijim e ka njoftuar atë për njohjen me rezultatet e hetimit administrativ dhe dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit është njohur me këtë dokumentacion, pasi në deklaratën e firmosur prej tij më datë 03.08.2020, ka pranuar se u njoh dhe mori të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e tij me CD, nuk ka vërejtje në lidhje me materialet e tërhequra, si dhe dokumentacioni është konform me dokumentacionin e dosjeve që i është vënë në dispozicion.

Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit, se: DSIK-ja, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Arjan Qafa, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ai ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raportin mbi kontrollin e figurës, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë, i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në Deklaratën për Kontrollin e Figurës dhe; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Arjan Qafa. Pas dërgimit të informacioneve të reja shtesë nga institucionet ligjzbatuese, Komisioni i kërkoi DSIK-së të përditësojë raportin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Arjan Qafa dhe, mbas përditësimit raporti të paraqitet i deklasifikuar. DSIK-ja, na dërgon raportin e përditësuar për subjektin e rivlerësimit, z. Arjan Qafa. Referuar këtij raporti, autoritetet verifikuese disponojnë të dhëna se gjatë viteve 2002, 2004, 2007, 2010 dhe 2018 ngrihen dyshime se gjyqtari Qafa të jetë përfshirë në veprime korruptive, në procese gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.

*Nga sa më sipër, rezulton se Komisioni i ka bërë të ditur subjektit të rivlerësimit përmbajtjen e raportit të DSIK-së nr. {***} prot., datë 02.11.2017, duke cituar dhe gjetjet e tij, në bazë të të cilave ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ, nuk rezulton të ketë ngritur pretendime të njëjta apo të ngjashme me ato në ankim se raporti i sipërcituar nuk ka qenë pjesë e dosjes së rivlerësimit. Pretendime të tilla nuk rezulton të jenë ngritur nga subjekti i rivlerësimit, as në seancën dëgjimore publike të datës 11.09.2020. Bazuar në situatën faktike si më sipër, trupi gjyqes vlerësoi se duke qenë se raporti i parë i hartuar nga DSIK-ja për subjektin e rivlerësimit ka qenë pozitiv, por më pas është rishikuar duke arritur në një konkluzion të ndryshëm, bazuar në informacionet e ardhura nga organet ligjzbatuese, me të drejtë Komisioni nuk e ka vlerësuar këtë raport si relevant për procesin e rivlerësimit, pasi i ka dhënë vlerë provuese raportit të fundit të deklasifikuar pjesërisht nga DSIK-ja, në të cilin subjekti i rivlerësimit është konstatuar si i papërshtatshëm për ushtrimin e detyrës, duke ia vënë këtë të fundit, të deklasifikuar, në dispozicion subjektit të rivlerësimit.*

*Bazuar në këtë analizë, trupi gjyqes vlerësoi se Komisioni ka mundur garancitë e duhura për t'i siguruar subjektit të rivlerësimit njohjen me përmbajtjen e raportit të parë të DSIK-së, nr. {***} prot., datë 02.11.2017, i cili ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës.*

Gjithashtu, trupi gjykues nuk gjeti asnjë fakt e provë që mund të ofronte qoftë edhe indicie për veprime të Komisionit gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit, të cilat të mbështesnin pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit, raporti i sipërcituar nuk i është bashkëngjitur qëllimisht dosjes së rivlerësimit nga Komisioni, në vijim të formave të presionit politik që përfaqëson trupa gjykuese, e cila ka vepruar në konflikt interesi, sidomos në kushtet kur Komisioni ka çmuar se⁵⁹ *nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të jetë në kushtet e pikës 2 apo 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, vlerëson se ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, porse konstatimet e gjetura gjatë hetimit mund të vlerësohen në tërësi të çështjes lidhur me rivlerësimin e subjektit, z. Arjan Qafa, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

93. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni, në kundërshtim me kriteret ligjore të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 49 e vijues të ligjit nr. 84/2016, ka dhënë një vendim të padrejtë, të pabazuar, të njëanshëm, në kundërshtim me provat, i cili duhet të ndryshohet, sepse arsyetimi në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës vjen në kundërshtim të plotë me disponimin e vendimit, pasi vetëm për subjektin që ka kontakte të papërshtatshme zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, trupi gjykues vëren se, në lidhje me kontrollin e kriterit të figurës, Komisioni, nuk e ka ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit⁶⁰, por në vlerësimin në tërësi të rezultateve të hetimit, Komisioni ka çmuar se: *Rëndësia e integritetit të figurës së gjyqtarit apo prokurorit duhet të qëndrojë në themel të procesit të rivlerësimit. Në këto kushte, konkluzionet e arritura gjatë hetimit të pastërtisë së figurës për z. Arjan Qafa, të ndërthurura me hetimin dhe vlerësimin e rasteve gjatë hetimit të të ardhurave/pasurive dhe vlerësimit profesional, rëndojnë pozitën e tij si gjyqtar. Këto veprime, të vlerësuara në tërësinë e tyre, cenojnë rëndë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
94. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit në raport me konkluzionin e mësipërm të Komisionit, trupi gjykues vlerësoi se në interpretim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që cenimi i besimit të publikut të ketë ndodhur, të jetë i arsyeshëm e i konsiderueshëm apo i perceptueshëm si i tillë, duhet që të ekzistojnë shkelje që në vetvete nuk përbëjnë shkaqe për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit, të parashikuara nga pikat 1, 2, 3 e 4, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë kontekst, përfundimi i arritur nga Komisioni është i paqartë, pasi në të nuk janë renditur se cilat janë konkretisht *konkluzionet e arritura gjatë hetimit të pastërtisë së figurës për subjektin e rivlerësimit* e sidomos nuk është arsyetuar e argumentuar nëse konstatimi i DSIK-së, se *autoritetet verifikuese disponojnë të dhëna se gjatë viteve 2002, 2004, 2007, 2010 dhe 2018 ngrihen dyshime se gjyqtari Qafa të jetë përfshirë në veprime korruptive, në procese gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër*, rezultoi i provuar/bazuar mjaftueshëm, për të konkluduar bindshëm mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprimtari korruptive. Komisioni, konkluzionin mbi cenimin e besimit të publikut, referon se e ka mbështetur në ndërthurjen e gjetjeve të raportit të DSIK-së, me vlerësimin e rasteve të rezultuara gjatë hetimit të vlerësimit profesional, por në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, Komisioni, në vendim, ka arsyetuar se *në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në një mungesë të aftësive profesionale dhe subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016⁶¹.*

⁵⁹ Paragrafi 97.7 i vendimit të Komisionit.

⁶⁰ Paragrafi 97 i vendimit të Komisionit.

⁶¹ Paragrafi 100 dhe 100.1 i vendimit të Komisionit.

Në mbështetje edhe të jurisprudencës së Kolegjit, trupi gjykues vlerësoi se neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke e parashikuar cenimin e besimit të publikut në nivelin e shkeljes disiplinore, e cila passjell shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, kërkon që cenimi i besimit të publikut të jetë i konsiderueshëm apo i perceptueshëm si i tillë, për shkaqe e shkelje konkrete, të cilat duhet të arsyetohen qartësisht e plotësisht. Vlerësimi i cenimit të besimit të publikut të drejtësia, duke u mbështetur në dyshime të paprovuara, nuk është në përputhje me frymën e ligjit nr. 84/2016, i cili në pikën 5 të nenit 4 të tij parashikon se: *“5. Komisioni dhe Kolegji i Apelit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor”*.

95. Për sa më sipër, vlerësohet se dyshimet mbi integritetin e figurës së subjektit të rivlerësimit të ngritura nga organet ligjzbatuese, në kushtet kur nuk kanë arritur të provohen nga Komisioni, nuk mund të kualifikohen prej tij, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
96. Në vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit edhe në gjykimin në Kolegj, nuk arriti të provojë të kundërtën e dyshimeve të arsyeshme të ngritura nga Komisioni se aktet e paraqitura prej tij pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, të cilat janë: kontrata e pretenduar e punësimit të personi të lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK; Aktmarrëveshje bashkëpunimi për hapjen e një biznesi si person fizik, e pretenduar se është lidhur mes znj. K. P. me vëllain e saj z. E. P., në datën 01.03.2005; si dhe Aktmarrëveshja Paramartesore, e pretenduar si e lidhur me subjektin të rivlerësimit dhe znj. K. P. në datën 02.08.2008, janë akte që nuk kanë ekzistuar më parë, por janë krijuar së fundmi, në një fazë të shtyrë të procesit të rivlerësimit. Nga analiza e bërë më sipër në këtë vendim, trupi gjykues arriti në përfundimin se këto veprime të subjektit të rivlerësimit kanë ardhur e janë kryer për shkak të vështirësisë së tij për t’u përballur e provuar të kundërtën e konstatimeve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni dhe janë një përpyetjeje e tij për të prodhuar një situatë faktike shumë larg së vërtetës, e cila do të favorizonte subjektin në përfundim të procedurës së rivlerësimit.
Gjithashtu, rezultoi i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë në kohë veprimet e duhura ligjore për të rregulluar situatën faktike-juridike, lidhur me pasurinë “tokë bujqësore”, me sipërfaqe 1639 m², në Fushë-Arrëz.
Me veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka reflektuar një qëndrim që bie ndesh me vlerat që duhet të përçojë integriteti i gjyqtarit e që, për pasojë, krijon kushtet e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë dhe kualifikohet sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
97. Megjithëse, disa prej shkaqeve të ankimit, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit e të analizuar më sipër nga trupi gjykues i Kolegjit, rezultuan të bazuara, ato u vlerësuan prej tij si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.
98. Në përfundim, bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Arjan Qafa gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga neni 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, për pasojë, vendimi nr. 298, datë 17.09.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 298, datë 17.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arjan Qafa.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 26.04.2023.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana Shtylla

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam dakord me vendimin nr. 19, datë 26.04.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim Kolegji), që i përket subjektit të rivlerësimit Arjan Qafa, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 298, datë 17.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), por kam mendim paralel me shumicën e trupit gjykues, për sa i përket qëndrimit të mbajtur dhe konkluzionit të arritur, lidhur me aplikimin e nenit 61, pika 5, si bazë ligjore për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit. Në bindjen time, vendimi i shkarkimit për subjektin e rivlerësimit duhej të bazohej në nenin 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, pasi rezultoi e provuar se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit të sipërcituar.
2. Komisioni, në paragrafin 102 të vendimit, është shprehur, ndër të tjera, se [...] *konkluzionet e arritura gjatë hetimit të pastërtisë së figurës për z. Arjan Qafa, të ndërthurura me hetimin dhe vlerësimin e rasteve gjatë hetimit të të ardhurave/pasurive dhe vlerësimit profesional, rëndojnë pozitën e tij si gjyqtar. Këto veprime, të vlerësuara në tërësinë e tyre, cenojnë rëndë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
3. Për vlerësimin e tri kriterëve, Komisioni është shprehur:
 - a) Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, të rremë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, parashikuar në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.*
 - b) Për kriterin e kontrollit të figurës: *Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të jetë në kushtet e pikës 2 apo 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, vlerëson se ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, porse konstatimet e gjetura gjatë hetimit mund të vlerësohen në tërësi të çështjes lidhur me rivlerësimin e subjektit, z. Arjan Qafa, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
 - c) Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.*
4. Kolegji, në paragrafin nr. 99 është shprehur se *në përfundim, bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arjan Qafa, gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga neni 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, për pasojë, vendimi nr. 298, datë 17.09.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.*
5. Nga vendimi i Komisionit, konstatohet se nga kontrolli i rivlerësimit ushtruar për tri kriteret rezulton që subjekti i rivlerësimit të jetë kualifikuar për dy kriterë: kontrollin e figurës (pavarësisht vlerësimit në tërësi të çështjes për konstatimet e gjetura gjatë hetimit) dhe vlerësimin e aftësive profesionale dhe të jetë shkarkuar vetëm për kriterin e pasurisë, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni, në vlerësimin tërësor, ka dhënë si pasojë cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
6. Jam dakord me arsyetimin e trupit gjykues të Kolegjit, shprehur në paragrafin 95 të vendimit, si dhe me konkluzionin e arritur në paragrafin 96 të këtij vendimi, ku konkludohet se *për sa më sipër, vlerësohet se dyshimet mbi integritetin e figurës së subjektit të rivlerësimit, të ngritura nga organet ligjzbatuese, në kushtet kur nuk kanë arritur të provohen nga Komisioni, nuk mund të kualifikohen prej tij, sipas nenit 61,*

7. *pika 5 e ligjit nr. 84/2016*, ku në ndryshim nga Komisioni, nuk u çmua që për këtë kriter të bëhet kualifikimi, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe konstatimet e gjetura gjatë hetimit të vlerësoheshin në tërësi të çështjes.
8. Në rastin e subjektit të rivlerësimit Arjan Qafa mendoj që nuk duhej aplikuar vlerësimi tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2⁶² e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë subjekti ka rezultuar se ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e figurës dhe të aftësive profesionale.
9. Sa i përket kriterit të pasurisë, mendoj se është i tepruar e rëndues kualifikimi nga shumica, sipas nenit 61, pika 5, i akteve dhe veprimeve të renditura në paragrafin 97 të vendimit të Kolegjit⁶³, të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur të tij, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia, për sa kohë që, si nga Komisioni, ashtu edhe nga Kolegji, nuk u konsiderua fuqia provuese e këtyre akteve, një pjesë e të cilave nuk i përkisnin subjektit, por personave të lidhur.
10. Gjithashtu, rezultoi e provuar nga procesi i hetimit administrativ të zhvilluar në Komision se subjektit të rivlerësimit në rezultatet hetimore nuk i është përcjellë barra e provës për cenim të besimit të publikut dhe nuk ka qartësi nga Komisioni për mënyrën se si e ka përfshirë këtë konkluzion në vendim. Për pasojë, subjekti nuk e ka përfshirë këtë si shkak ankimi në mbrojtjen e realizuar prej tij.
11. Vlerësoj se në rastin konkret, situata faktike që lidhet me kriterin e pasurisë, pas konstatimit të një sërë shkeljesh të parashikuara nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, është e mjaftueshme për të vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61, pika 3 të këtij ligji, ashtu sikurse është konkluduar nga Komisioni dhe Kolegji.
12. Penalizmi i subjektit të rivlerësimit me shkarkim nga detyra, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë duhet të aplikohet në mënyrë shumë të kujdesshme e proporcionale nga organet e rivlerësimit, pa bërë një interpretim të zgjeruar të tij, sepse kjo do të çonte në një vlerësim subjektiv të rastit, bazuar mbi sjellje të subjektit, sjellje të cilat mund të ishin vlerësuar në kuadër të sjelljes e etikës së tij, në raport me ushtrimin e funksionit dhe dhënien e drejtësisë.
13. Në përfundim, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, për sa kohë që, as nga Komisioni për kriterin e figurës, por as nga Kolegji për kriterin e pasurisë, nuk u arrit që të provohej ekzistenca e shkeljeve të tilla të parikuperueshme që të

⁶² Neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”.

⁶³ Paragrafi 97 i vendimit: “97. Në vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit edhe në gjykimin në Kolegj nuk arriti të provojë të kundërtën e dyshimeve të arsyeshme të ngritura nga Komisioni se aktet e paraqitura prej tij pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, të cilat janë: kontrata e pretenduar e punësimit të personi të lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK; aktmarrëveshje bashkëpunimi për hapjen e një biznesi si person fizik, e pretenduar se është lidhur mes znj. K. P. me vëllain e saj z. E. P., në datën 01.03.2005; si dhe aktmarrëveshja paramartesore, e pretenduar si e lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe znj. K. P. në datën 02.08.2008, janë akte që nuk kanë ekzistuar më parë, por janë krijuar së fundmi, në një fazë të shtyrë të procesit të rivlerësimit. Nga analiza e bërë më sipër në këtë vendim, trupi gjykues arriti në përfundimin se këto veprime të subjektit të rivlerësimit kanë ardhur e janë kryer për shkak të vështirësisë së tij për t’u përballur e provuar të kundërtën e konstatimeve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni dhe janë një përpjekje e tij për të prodhuar një situatë faktike shumë larg së vërtetës, e cila do të favorizonte subjektin në përfundim të procedurës së rivlerësimit. Gjithashtu, rezultoi i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë në kohë veprimet e duhura ligjore, për të rregulluar situatën faktike-juridike, lidhur me pasurinë “tokë bujqësore”, me sipërfaqe 1639 m², në Fushë-Arrëz”.

mos përfshiheshin në rastet e tjera të masave disiplinore të parashikuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, konkretisht në pikën 3 të tij. Për rrjedhojë, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, cenimi i besimit të publikut, si parashikim ligjor i pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të qëndrojë si një shkak më vete shkarkimi dhe të aplikohet në rastet kur subjekti i rivlerësimit është konfirmuar për dy kriteret e tjera të rivlerësimit.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi